

MENAXHIMI I POLITIKAVE FISKALE DHE NDIKIMI I TYRE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË NJË VENDI

(me veshtrim Kosova 2008-2012)

Malush Krasniqi

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, Menaxhment,
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Asoc.Dr. Indrit Baholli

Numri i fjalëve: 52133

Tiranë, Qershor 2016

Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit
Programi Doktorat në Shkenca Ekonomike
Profili Menaxhment

DOKTORATURË

MENAXHIMI I POLITIKAVE FISKALE DHE NDIKIMI I TYRE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË NJË VENDI (me vështrim-Kosova 2008-2012)

Udhëheqës shkencor:
Prof.Asoc.Dr. Indrit BAHOLLI

Përgatiti kandidati për PhD
Mr.Sc. Malush KRASNIQI

Tiranë , 2016

Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit
Programi Doktorat në Shkenca Ekonomike
Profili Menaxhment

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT
TIRANË**

PUNIM DOKTORAL

**Tema: MENAXHIMI I POLITIKAVE FISKALE DHE NDIKIMI I TYRE NË
ZHVILLIMIN EKONOMIK TË NJË VENDI
(me vështrim-Kosova)**

**Udhëheqës shkencor:
Prof.Asoc.Dr. Indrit BAHOLLI**

**Përgatiti kandidati për PhD
Mr.Sc. Malush KRASNIQI**

Tiranë , 2016

© DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj me pergjegjesi morale dhe intelektuale se ky punim i kesaj teze doktorale është komplet puna ime origjinale.

Ky material nuk është prezantuar më parë në asnjë institucion universitar tjetër apo diçka të ngjashëm . Mënyra e analizimit të të dhënave, përshkrimit , mbledhjes së të dhënave është komplet origjinale dhe objektive .

Falënderim

Ky studim është rezultat i një periudhe të gjatë pune, i shumë orëve të studimit, konsultimit, kërkimit në burime të ndryshme, i shkrimit dhe i rishkrimit, i konsultave dhe debateve të ndryshme profesionale .

Unë do të dëshiroja të falënderoja të gjithë ata që më kanë dhënë mbështetje dhe kanë dhënë kontribut të çmuar për përfundimin e këtij punimi.

Një falenderim i veçantë shkon për:

Familjen time, për ndihmën, inkuraimin, durimin dhe sakrificat e bëra, për të më mbështetur në këtë iniciativë.

Prof.Dr.z.Ardian Civic, Presidentin e UET , i cili në vazhdimësi nuk ka kusyer sugjerimet dhe orientimin e duhur në kohë.

Prof.Dr.z.Indrit Baholli, udhëheqësin tim, për këshillimin, konsultat e pakursyera dhe gatishmërinë e vazhdueshme për të më ndihmuar në kompletimin e këtij studimi.

Universitetin European të Tiranës, Fakultetin e Ekonomisë, veçanërisht Departamentin e Menaxhimit, që më nxitën idenë për të drejtuar kërkimet e mia në fushën e “menaxhimit të politikave fiskale dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të një vendi”, si dhe më krijuan mundësinë për realizimin e këtij punimi doktoral.

Kolegët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit European të Tiranës, si dhe kolegët e punës në Administratën Tatimore të Kosovës –Regjioni i Prizrenit dhe drejtorinë në Prishtinë që më përkrahën dhe më inkurajuan fort për përmbushjen e kësaj detyre.

Kolegë dhe panelist të ndryshëm, punonjës të institucioneve të ndryshme të pushtetit qendror dhe lokal, që kontribuan duke bashkëpunuar në plotësimin e pyetësorëve, në ofrimin e informacioneve të ndryshme, në ofrimin për pjesëmarrje në workshope etj.

Malush Krasniqi

Tiranë , 2016

PËRMBAJTJA

Kapitulli I

Hyrje.....	11
1.1 Parathënie.....	11
1.2 Pershkrim i shkurtër i metodologjisë kryesore të kërkimit.....	12
1.2 Pyetja kërkimore dhe Hipoteza bazë.....	12
1.3 Burimet kryesore rreth punës në temë	14

Kapitulli II

Rishikimi i literaturës –për menaxhimin e politikave fiskale,qëllimet, masat, dhe instrumentet e përdorura.....	15
2.1 Menaxhimi politikave fiskale.....	15
2.2 Qëllimet e politikës fiskale.....	17
2.3 Masat e politikës fiskale.....	20
2.4 Ndikimi i instrumenteve fiskalë në punësim dhe në nivelin e çmimeve.....	23
2.5 Ndikimi i politikës fiskale në redistribuimin e të ardhurave dhe të pasurisë.....	24
2.6 Efektet e tjera të aplikimit të instrumenteve të politikës fiskale.....	25
2.7 Politika Fiskale dhe Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.....	26
2.8 Parimet e politikave buxhetore.....	27
2.9 Të hyrat Buxhetore.....	29

Kapitulli III

Kuptimi dhe esenca e shpenzimeve publike.....	32
3.1 Të hyrat (dhe shpenzimet)nga burimet kryesore në Kosovë.....	32
3.2 Shkaqet e rritjes së shpenzimeve publike.....	33
3.3 Financat publike dhe ideologjia	36
3.4 Politikat dhe reforma tatimore.....	35
3.5 Politikat dhe reformat tatimore në Kosovë.....	40
3.6 Ndikimi i tatimit në kushtet e aktivitetit ekonomik	44
3.7 Ndikimi tatimit në stabilizimin ekonomik.....	45

3.8 Ndikimi i tatimit në zhvillimin ekonomik.....	46
3.9 Sistemi tatimor dhe Të hyrat tatimore 2008-2013.....	47
3.10 TVSH-ja(Tatimi mbi vleren e shtuar).....	56
3.11 Politikat fiskale-Objektivat ,instrumentet dhe efektet.....	58
3.12 Objektivat e politikës fiskale.....	59
3.13 Instrumentet dhe efektet e politikës fiskale.....	60
3.14 Veprimi i politikës fiskale në shtimin ekonomik	60
3.15 Veprimi i politikës fiskale në punësim dhe në nivelin e çmimeve.....	61
3.16 Veprimi i politikës fiskale në shpërndarjen e të ardhurës dhe të pasurisë.....	62
3.17 Efektet tjera të aplikimit të instrumenteve të politikës fiskale.....	63
3.18 Politika fiskale në tranzicion.....	63
3.19 Ndikimi i politikës fiskale në vendet e tranzicionit.....	66
3.20 Tranzicioni në ballkan dhe stabiliteti i tij ekonomik.....	69
3.21 Tranzicioni në Kosovë.....	69

Kapitulli IV

Menaxhimi i politikave fiskale dhe zhvillimi ekonomik.....	72
4.1 Metodologjia e kërkimit.....	72
4.2 Rezultati i pyetsorit (Paraqitja Grafike).....	73
4.3 Sfidat e tranzicionit.....	83
4.4 Rëndësia e teorive të ndërmarrjes në praktiken e strukture së politikës afariste.....	83
4.5 Objektivat dhe politikat makroekonomike.....	86
4.6 Financat dhe strategjia korporative.....	88
4.7 Mjedisi financiar i biznesit (marrëdhëniet financiare me qeverinë).....	89
4.8 Marrëdhëniet me tregun financiar dhe tregun.....	91

Kapitulli V

Menaxhimi i projekteve.....	94
5.1 Rëndësia e tyre në menaxhimin e politikave zhvillimore.....	94
5.2 Zbatimi i strategjisë.....	95
5.3 Financimi i projekteve publike	96
5.4 Menaxhimi i projektit kundrejt menaxhimit të programit të përgjithshëm.....	97

5.5 Menaxhimi i projektit në sektorin publik përtej konfuzionit.....	98
5.6 Kush janë menaxherët e projektit të sektorit publik.....	99
5.7 Llojet e menaxherëve të projektit në sektorin publik	99
5.8 Aftësitë,atributet dhe kërkesat e menaxherëve në sektorin publik.....	101
5.9 Menaxherët dhe Menaxhimi	102
5.10 Konceptet e menaxhimit dhe kufijtë kombëtar.....	105
5.11 Vendimmarrja dhe përballimi i ndryshimeve.....	105
5.12 Etika Menaxheriale.....	107
5.13 Faktorët situacional që influencojnë mbi etikën menaxheriale.....	109
5.14 Krijimi i mjedisit për menaxhimin etik të biznesit.....	111
5.15 Dilemat etike në karrierën menaxheriale.....	113

Kapitulli VI

Globalizimi.....	115
6.1 Pershtatja e tregut të Kosovës ndaj globalizimit.....	115
6.2 Sfidat kryesore të globalizimit	116
6.3 Implikimet shoqërore që i shkakton globalizimi	118
6.4 Ndryshimet politike si pasojë e globalizimit.....	119
6.5 Ekonomitë në tranzicion si pasojë e globalizimit	120
6.6 Si ta fillojmë zhvillimin e qëndrueshem ekonomik në Kosovë.....	122
6.7 Globalizimi dhe rreziku nga mallrat e falsifikuara.....	123
6.8 Krisja e re midis “pro”dhe “anti” globalizimit.....	125
6.9 Globalizim apo ndërkombëtarizim ?.....	136
6.10 Anti dhe alterglobalizmi	137
6.11 Historia dhe përbërja e alterglobalistëve.....	138
6.12 Kosova në prizmin alterglobal	130
6.13 Globalizimi financiar.....	133
6.14 Kriza financiare në Europë –apeli i ekonomistëve.....	135
6.15 Çka ndodhi në Kosovë – a ka strategji antikrizë ?.....	136
6.16 Globalizimi i dijes dhe informacionit	137
6.17 Integrimet kryesore ekonomike rajonale Evropiane.....	139
6.18 Qëllimi i angazhimit të firmave në (integrame ekonomike) biznesin ndërkombëtar.....	144

Kapitulli VII

7.1 Konkluzioni	147
7.2 Kontributi në dije	149
7.3 Kufizimet e punimit	150
7.4 Rekomandimet.....	150
Shtojca.....	151
Forma e intervistes dhe pyetsorit.....	158
Referencat Bibliografia.....	164

Abstrakt

I

Kosova është një vend i cili po kalon një tranzicion të ashpër për shkak të diferencave të mëdha krahasuar me vendet e Bashkimit Europian por edhe me vendet e rajonit.

Andaj një menaxhim i mirë me një kujdes të lartë dhe me një analizë profesionale është mëse i domosdoshëm për të mos ngecur mbrapa me orientimet e zhvillimit ekonomik.

Menaxhimi i politikave fiskale në shumë vende të Ballkanit Perëndimor ka orientim drejt reformave e modeluar sipas tri përparësive kryesore: 1) thjeshtësimi i sistemit fiskal, 2) krijimi i transparencës dhe procedurave të qarta dhe 3) siguria se legjislacioni është duke u zbatuar në mënyrë të drejtë.

Politikat publike menaxhohen nga qeveria (shteti) i cili është edhe investitori më i madhë dhe orientues i drejtperdrejt i zhvillimit ekonomik.

II

Pyetja kërkimore „si të menaxhojmë të hyrat publike“.

Qëllimi apo argumenti kryesor në këtë punim doktoral është se si të jemi koherent në menaxhimin e të hyrave dhe orientimin e një zhvillimit ekonomik drejt qëndrueshmërisë së një tregu të lirë, si dhe tërheqjen e investitoreve të jashtëm duke ju krijuar siguri ligjore, lehtësira tatimore .

III

Metodologjia e përdorur në këtë punim doktoral është; 1) Krahasimi i ideve nga literatura e autorëve të ndryshëm të lamisë së menaxhimit, praktikave të vendeve të cilat kanë kaluar neper këto shkallë të tranzicionit, 2) Zhvillimi i pyetjeve dhe intervistave duke përfshirë shtresat e ndryshme të shoqërisë, organizimi i tryezave për diskutime në këtë lami të menaxhimit, shfrytëzimi i arkivave shterore siq janë; të dhënat nga Administrata Tatimore, Dogana Banka Qendrore si dhe Ministria e Financave etj.

ABSTRACT

I

Kosovo is a country which is undergoing a tough transition because of major differences compared to European Union countries but also with countries of the region. Therefore, a good management with a high caution and with a professional analysis is indispensable for not lagging behind economic development orientations.

Fiscal policy management in many countries of the Western Balkans oriented reforms modeled on three main priorities: 1) simplify the tax system, 2) establishing transparency and clear procedures and 3) ensuring that legislation is being implemented right. Public policies are managed by the government (state) which is also the biggest investor and the direct orientation of economic development.

II

Research question " How to manage public revenues? ".

Aim or main argument in this work doctoral, is that as we are consistent revenue management and orientation of an economic development towards sustainability of a free market, as well as attract foreign investors by creating legal certainty, tax facilities .

III

The methodology applied in this doctoral paper is; 1) Comparison of ideas from the literature of various authors field of management, practices of which have undergone this degree of transition, 2) Development of questionnaires and interviews by including different layers of the society, the organization of seminars for discussion in the field of management, exploitation such as state archives; Data from the Tax Administration, Customs Central Bank and Ministry of Finance etc.

KAPITULLI I

TEMA:
MENAXHIMI I POLITIKAVE FISKALE DHE NDIKIMI I TYRE NË
ZHVILLIMIN EKONOMIK TË NJË VENDI
(me vështrim-Kosova)

Hyrje

1.1 Parathënie

Orientimi për përzgjedhjen e temës së: "menaxhimit të politikave fiskale në zhvillimin ekonomik të Kosovës" ka ardhur si motiv i përditshmërisë sonë dhe ndikimi i saj direkt dhe indirekt në shoqërinë tonë dhe në rrethin ku jetojmë.

Andaj duke pasur parasysh politikat fiskale rrethanat ekonomike si dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut në vendin tonë kam bërë përzgjedhjen e kësaj teme me qëllim që sadopak të jap kontributin tim në shtjellim të kësaj teme.

Zhvillimi ekonomik i një vendi apo shoqërie nisur nga përvoja e vendeve ekonomikisht të zhvilluara dhe atyre në zhvillim ka treguar se për ta zhvilluar ekonominë e tregut duhet të përpilohen dhe të zbatohen politika fiskale të favorshme për biznesin me qëllim të tërheqjes së investimeve dhe të krijimit të sigurisë së investimeve.

Rëndësia e politikave fiskale ndikon në orientimin dhe zhvillimin ekonomik të një vendi, stimulon zhvillimin e biznesit vendor si dhe bën tërheqjen e investitorëve të ndryshëm nga jashtë, por kur jemi te zhvillimi ekonomik rëndësi ka edhe zbatimi apo aplikimi e këtyre politikave në praktikë duke i eliminuar byrokracitë e ndryshme e të panevojshme, duke përdorur shkallë më të ulëta tatimore dhe duke krijuar siguri për investuesit, duke krijuar lehtësira në rregullimin e dokumentacionit të nevojshëm për biznesin etj.

Ndërrimi i sistemeve nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi me treg të lirë apo faza e tranzicionet nëpër shumë vende të Evropës dhe të Botës kanë treguar se i ka vështirësitë e veta me të cilat pothuaj përballet çdo shoqëri në tranzicion, por në ato vende ku shteti apo qeveria ka reaguar më shpejt me krijimin e politikave fiskale, politikave zhvillimore stimuluese të shëndosha faza tranzitore ka qenë më e lehtë dhe kontrolli ka qenë më efikas dhe ka dhënë rezultatet e pritura në vetëdijësimin e popullsisë për t'i shlyer obligimet e ndryshme ndaj shtetit, në zhvillimin e ekonomisë së vogël dhe të mesme, në punësimin e popullsisë uljen e shkallës së

varfërisë së skajshme, ndërsa aty ku janë vonuar këto politika problemet kanë vazhduar si dhe varfëria është rritur.

Prandaj zhvillimi i ekonomisë globale, apo globalizimi, hapja e tregjeve, konkurrenca e fortë në treg si dhe shumë faktorë tjerë kërkojnë një menaxhim strategjik dhe operacional të kujdesshëm ku si faktorë shumë me rëndësi është faktori kohë pra gjeturia në kohë.

Aktualisht në shumicën e vendeve të përparuara të Rajonit dhe Evropës, menaxhimi i politikave fiskale në Sektorin Publik dhe privat ka një rol dhe rëndësi të veçantë për popullatën dhe shtetin përgjithësisht. Gati shumica e vendeve dhe e shteteve të ndryshme botërore nuk kanë mundësi të radhiten në vendet e zhvilluara dhe të civilizuar pa një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik të sektorit publik dhe privat si dhe menaxhimin efikas të buxhetit të shtetit. Menaxhimi i politikave fiskale përbën kurdoherë një sfidë e veçanërisht këto sfida shumëfishohen kur bëhet fjalë për menaxhimin e sektorit publik, sektor ky i cili varet nga projektet e suksesshme për të mundësuar ndryshimet e nevojshme.

Në punimin doktoral me titull ” **Menaxhimi i Politikave Fiskale dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të një vendi (Kosovë)**” kam pasur për qëllim që nisur nga praktikat aktuale dhe analiza e tyre të prezantoj zgjidhje të cilat avancojnë praktikat më të mira të menaxhimit të politikave fiskale nëpërmjet identifikimit dhe menaxhimit bashkëkohorë të këtij sektori shumë të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik apo të orientimit të zhvillimit ekonomik të një vendi.

Jam përpjekur që në mënyrë përmbledhëse të pasqyroj dhe arsyetoj rëndësinë e menaxhimit në këtë sektor, të arsyetoj mirë shkaqet pse kjo temë është kaq e rëndësishme dhe relevante për Republikën e Kosovës.

Punimi përmban koncepte teorike, grafikone, ilustrime, tabela dhe figura të ndryshme mjaft praktike që paraqesin problemet e këtij sektori dhe zgjidhjet e tyre në të ardhmen.

Kosova ende po kalon një fazë tranzicioni shumë të shpejtë dhe se e ardhmja premton shumë për avancimin e menaxhimit të politikave fiskale të cilat janë të një rëndësie të veçantë, dhe se shumë shpejt këto vlera për menaxhimin e drejtë të projekteve atraktive përmes politikave fiskale do ta kenë trajtimin e duhur në shoqërinë moderne dhe të përparuar.

Studimi është i natyrës eksploruese dhe kualitative. Ai tenton të investigojë praktikat e menaxhimit të një vendi më pak të zhvilluar siç është Kosova. Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i praktikave të menaxhimit dhe qeverisjes të një vendi më pak të zhvilluar.

Gjithashtu qëllimi ishte që të eksploroheh problemet dhe vështirësitë që bizneset hasin, ndeshin gjatë procesit të zhvillimit të vet dhe të bërjes biznes.

Kryesorja është për të identifikuar shkaqet e dështimit të biznesve në mënyrë që të mundësohet ndihmesa përmes projekteve zhvillimore duke u krijuar lehtësira tatimore dhe stimulative në fazën e parë të zhvillimit e cila sipas mendimit tim duhet të jetë 1+1 vjeçare.

1.2 Pershkrim i shkurter i metodologjisë kryesor të kërkimit

Metodologjia e përdorur në këtë punim të diplomës së doktoraturës është krahasimi i ideve të ndryshme prej literaturës së përdorur, pyetsorët ,intervistat, arkivat e ndryshme, praktikat e vendeve, shteteve të ndryshme në kohën e tranzicionit dhe të zhvillimit ekonomik , se si kanë menaxhuar me politikat fiskale, çfarë orientimi kanë përdorur për zhvillimin ekonomik të vendit? etj. Qëllimi i studimit është që të eksploroheh praktikat e menaxhimit të politikave fiskale per vitet 2008-2013, kështu që natyra e pyetjeve që ngrihen janë :*sa jeni të kënaqur me menaxhmin e politikat fiskale?*- Shumë, mesatarisht, pak dhe aspak.

Për të ndertuar pyetsoret kamë shfrytzuar literaturë te ndryshme nderkombetare .

Të dhënat e grumbulluara nga intervistat në këtë metodë analizohen duke përdorur teknikën e analizës së përmbajtjes. Analiza e përmbajtjes konsiderohet si një ekzaminim i kujdesshëm, i detajuar dhe sistematik në përpjekjen për të identifikuar modelet, temat, mjetet. Kështu ky studim ka adaptuar teknikën e analizës së përmbajtjes për të analizuar të dhënat e rastit të studimit.

1.3 Pyetjet kerkimore dhe Hipoteza bazë

Pyetjet bazë te ketij studimi janë:

1.Si ti ndryshojmë politikat fiskale me qellim te rritjes se zhvillimit ekonomik ?

2.Çfarë orientimi duhet t'u japim politikave fiskale, me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja dhe njekohesisht rritjes se punësimit, duke rritur vetëdijen qytetare për respektim të ligjit?

Hipoteza bazë:

1. Ndryshimi i politikave fiskale nga ato aktuale që ka Kosova dhe pershtatja me politikat Europiane mendoj që do të ketë efekt pozitivë në zhvillimin e ekonomisë së lirë, në punësim e njekohësisht edhe në rritjen e të hyrave, sepse Kosova ka popullsinë shumë të re dhe ka një impact direkt nga vendet e bashkimit evropian për shkak se shumë Kosovarë punojnë në vendet e Bashkimit Evropian .

2. Ndikim i politikave fiskale të cilat i ndertonë qeveria e një vendi (Kosova në rastin timë) ndikon drejt përse drejti në orientimin dhe zhvillimin e ekonomisë . Zhvillimet ekonomike të vendeve për rrethë Kosovës të cilat aspirojnë bashkimi evropian dhe vetë vendeve të BE-s kërkon ndryshimin apo pershtatjen e ligjeve të ndryshme me ato të bashkimit evropian , por duke ndertuar politika fiskale në favor të zhvillimit të biznesit vendore.

Prandaj kjo hipotezë bazohet në të hyra kombëtare (të hyrave publike si ATK, DOGANË, BIZNESE TË VOGLA TË MESME DHE TË MËDHA, dhe të tjera) .

Pas analizimit të hollsishtë të raporteve të Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganës së Kosovës si dy institucione ku realizohen mbi 90 % e të hyrave të tersishme si dhe pas analizimit të raporteve të Bankës qendrore të Kosovës duke krahasuar raportin e importeve në krahasim me exportet vijmë në konkluzion se qëndron hipoteza e ngritur, politikat fiskale në Kosovë duhet ndryshuar.

1.4 Burimet kryesore rreth punës në temë:

a) parësore b) dytësore dhe c) puna në terren.

Burime parësore dhe puna në teren (burimet e nxjerra nga vet doktoranti gjatë punës në teren) si , pyetësorë , intervista , shfrytëzim i arkivave të ndryshme etj.

Burime dytësore, literatura e autorëve të ndryshëm apo edhe materiale të përdorura dhe analizuar nga studiues të mëparshëm.

KAPITULLI II

RISHIKIMI I LITERATURES –PËR MENAXHIMIN E POLITIKAVE FISKALE,QELLIMET, MASAT,DHE INSTRUMENTET E PERDORURA

2.1 Menaxhimi i politikave fiskale

Roli dhe funksioni i shtetit nën udhëheqjen e politikës fiskale ekonomike është i pa kontestueshëm, në realizimin e stabilitetit të tregut dhe të çmimeve, në punësim, në ruajtjen e ekuilibrit të bilancit të pagesave si dhe në realizimin e shkallës së caktuar të rritjes dhe të zhvillimit ekonomik. Në kuadrin e politikës ekonomike, politika fiskale është njëra prej komponenteve më me rëndësi.

Me anë të politikës përcaktohen parimet në bazë të të cilave duhet të udhëhiqet ndonjë aksion, si dhe masat dhe mjetet për arritjen e qëllimeve të caktuara. Politika ekonomike shqyrton proceset ekonomike si dhe instrumentet, masat dhe vendimet e qeverisë për realizimin e qëllimeve të saj.

Organet shtetërore qendrore apo lokale janë bartëse të politikës ekonomike që ndikojnë në zgjedhjen dhe orientimin si dhe realizimin e saj.

Këto organe shtetërore apo komunale përcaktojnë forma të ndryshme të vetëdijshme në rregullimin dhe drejtimin e proceseve ekonomike.

Gjatë procesit të caktimit të politikës ekonomike në rend të parë duhet caktuar qëllimet e saj.

Si qëllime kryesore të politikës ekonomike mund t'i radhisim:

- punësimi i plotë,
- stabiliteti i çmimeve,
- rregullimi i bilancit të pagesave,
- ekspansioni i prodhimit – rritja ekonomike,
- alokacioni – shpërndarja e faktorëve të prodhimit (duke përfshirë nxitjen e konkurrencës së brendshme, koordinimin e tyre , rritjen e mobilizimit të fuqisë punëtore dhe të kapitalit në vend, si dhe nxitjen e ndarjes ndërkombëtare të punës),- plotësimin e nevojave publike (administrata, mbrojtja, arsimi, kultura, shkenca, shëndetësia etj).

Sa më i madh të jetë numri i qëllimeve, realizimi i tyre i plotë është më i vështirë. Në bazë të raporteve ndërmjet veti qëllimet i ndajmë në: qëllime të pavarura, komplementare dhe konfliktuese.

Shumë pak qëllime të politikës ekonomike janë të pavarura ndërmjet veti, ashtu që realizimi i një qëllimi të mos ndikojë në realizimin e tjetrit.

Qëllimet komplementare të politikës ekonomike janë kur realizimi i një qëllimi ndikon në realizimin e qëllimit tjetër.

Qëllimet në konflikt të politikës ekonomike janë nëse realizimi i një qëllimi e vështirëson ose e pengon realizimin e qëllimit tjetër.

Për realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike shfrytëzohen mjetet e caktuara respektivisht instrumentet me ndihmën e të cilave realizohen qëllimet.

Instrumentet e politikës ekonomike zakonisht klasifikohen në këto grupe:

- Instrumentet e financave publike (politika fiskale),
- Instrumentet e politikës kreditore-monetare,
- Instrumentet e sistemit dhe të politikës së çmimeve,
- Instrumentet e tregtisë së jashtme dhe të sistemit devizor,
- Instrumentet e sistemit dhe të politikës së të ardhurave dhe
- Instrumentet e kontrollit të drejtpërdrejtë.

Harmonizimi i qëllimeve në mes të këtyre instrumenteve është një proces me rëndësi për realizimin dhe formulimin e politikës ekonomike.

Me politikën fiskale zakonisht nënkuptohet shfrytëzimi i instrumenteve të financave publike d.m.th. të të hyrave publike dhe të dalave (shpenzimeve) publike për realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike. Andaj politika fiskale është instrument shumë i rëndësishëm i politikës ekonomike.

Politika fiskale ndikon në realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike (në punësim, stabilitet të çmimeve, në saldon e bilancit të pagesave dhe në rritjen e normës ekonomike) me vet faktin e mbledhjes së të hyrave publike dhe realizimin e shpenzimeve (të dalave) publike, me ç'rast krijojnë efektet në ecurinë e agregatëve ekonomikë dhe në sjelljen e subjekteve ekonomike.

Mekanizmi i veprimit të politikës fiskale ka të bëjë me efektet afatgjate të saj, siç është ndikimi i saj në zhvillimin dhe rritjen e shpejtë ekonomike. Funkcioni i shtetit gjithnjë e më shumë po bëhet si ndërmjetësues në zhvillimin ekonomik, i cili duhet të kujdeset për krijimin e kushteve të përgjithshme, për ruajtjen e shpejtuar të rritjes dhe të zhvillimit ekonomik. Në vend që të caktojë prioritetet e zhvillimit të ndonjë sektori, veprimtarie apo dege, shteti sot merret me sendërtimin e infrastrukturës themelore, me udhëheqjen e politikës industriale, politikën e zhvillimit regional

si dhe me përparimin e shkencës dhe të arsimit si faktor me rëndësi të zhvillimit që sjellin rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë së vendit në tregun ndërkombëtar të integruar (globalizmi). Shkalla e zhvillimit të ekonomisë së shtetit caktohet me sasinë dhe cilësinë (kualitetin) e resurseve njerëzore dhe materiale dhe me shkallën e arritur të zhvillimit tekniko-teknologjik. Politika fiskale, pra ndikon në shkallën e shpejtuar të rritjes ekonomike aq sa me instrumentet e të hyrave publike dhe të shpenzimeve publike mund të ndikohet në faktorët e lartë.¹

2.2 Qëllimet e politikës fiskale

Krahas mbledhjes së të hyrave publike me të cilat financohen shpenzimet e forumeve juridikopublike (qëllimi fiskal), me instrumentet e financave publike bëhen përpjekje gjithnjë e më shumë dhe gjithnjë e më shpesh që të realizohen edhe qëllime tjera. Kështu, instrumentet fiskale shfrytëzohen për: ndarjen racionale të faktorëve të prodhimit, për zhvillimin më harmonik regjional, për realizimin e punësimit të plotë, për mbajtjen e stabilitetit të çmimeve, për unifikimin e kushteve të ekonomizimit, për arritjen e ekuilibrit në shkëmbimin e tregtisë së jashtme, për rritjen e përqindjes së rritjes ekonomike, për ndarjen më të barabartë të të ardhurave dhe të pasurisë, për plotësimin optimal të nevojave shoqërore, për përmirësimin e kushteve të jetës dhe të punës së njerëzve etj. Këto qëllime jofiskale, që realizohen ose që mund të realizohen me instrumentet e financave publike, mund të klasifikohen në:

- qëllimet alokative,
- qëllimet redistributive,
- qëllimet e stabilizimit.

Me nocionin e qëllimeve redistributive, që dëshirohet të realizohen me aplikimin e instrumenteve të financave publike, nënkuptohet korrigjimi i ndarjes, si i të ardhurave ashtu edhe i pasurisë e që është bërë nën ndikimin e mekanizmit të tregut. Problemi i rindarjes së të ardhurave dhe të pasurisë nuk zgjidhet me aplikimin e disa metodave shkencore as të kriterëve që mund të trajtohen si kriter shkencor. Kriteret e rindarjes së të ardhurave dhe të pasurisë janë të natyrës politike që me kohë ndryshojnë dhe që varen nga rregullimi politik, nga marrëdhëniet politike në vend si dhe nga një varg elementesh tjera prej të cilave varet pikëpamja e shumicës, e grupeve të ndryshme të interesit dhe e qarqeve sunduese në lidhje me faktin se a është e nevojshme,

¹ Prof.Dr. Sabahudin Komoni,Financat Publike .
Universiteti i prishtinës –Fakulteti Ekonomik ,faqe16-18.Prishtinë 2008.

dhe në çfarë mase është e nevojshme të korrigjohet ndarja e të ardhurave dhe të bëhet rindarja e pasurisë. Rindarja e të ardhurave dhe të pasurisë mund të bëhet në atë mënyrë që të lehtësohet shfrytëzimi i shërbimeve të institucioneve shëndetësore, edukative, arsimore, kulturore e të tjera, që të zvogëlohet ngarkimi tatimor i personave me fuqi më të ulët ekonomike, që të rriten ndihmat e ndryshme sociale për personat me të ardhura më të ulëta, që të nxitet ndërtimi i banesave si dhe blerja e pasurive të caktuara të patundshme dhe të sendeve të tundshme me masat e politikës tatimore etj.

Ndër qëllimet e stabilizimit, që dëshirohen të arrihen me instrumente fiskale, numërojmë ato që janë të orientuara në drejtim të ruajtjes: **(a)** të punësimit të plotë, përkatësisht të zvogëlimin të përqindjes së papunësisë dhe **(b)** të nivelit ekzistues të çmimeve. Në të vërtetë, me variantet e caktuara të llojeve dhe të lartësisë së shpenzimeve publike duhet të ndikohet në kërkesën e gjithmbarshme.

Kështu p. sh. në kohën e papunësisë duhet rritur shpenzimet publike (në mënyrë që kështu të rritet punësimi), kurse në kohën e inflacionit këto shpenzime duhet të zvogëlohen në mënyrë që të ndikohet në zvogëlimin e përqindjes së tij. Me instrumente fiskale mund të veprohet, ashtu që me dhënien e lehtësimeve të ndryshme (premise, subvencioneve dhe beneficioneve të tjera, p. sh. me rastin e tatimit) nxitet aktiviteti i sektorit privat që në këtë mënyrë të sigurohet punësimi i një numri më të madh të personave në atë sektor (p. sh. në të ashtuquajturën ekonomi e vogël.). Gjithashtu, me veprimin e instrumenteve fiskale në ofertë dhe në kërkesë mund të ndikohet me sukses në nivelin e çmimeve.

Krahas grupimit të qëllimeve të politikës fiskale në qëllime alokative, redistributive dhe qëllime të stabilizimit, këto qëllime mund të klasifikohen edhe në atë mënyrë që mund të flitet për politikën fiskale si për:

- politikën e plotësimit të nevojave personale, të përbashkëta e të përgjithshme, si dhe për politikën e përmirësimit të kushteve jetësore e të kushteve të tjera;
- politikën e rindarjes së të ardhurave e të pasurisë;
- politikën e stabilizimit e cila është e orientuar në ruajtjen, përkatësisht realizimin e punësimit të plotë, stabilitetit të nivelit të çmimeve dhe ekuilibrit të bilancit të pagesave të vendit;
- politikën e rritjes ekonomike,
- politikën e cila është e orientuar në rritjen e veprimtarisë investuese, përmirësimin e strukturës së fuqisë punëtore dhe të rritjes së numrit të të punësuarëve dhe në nxitjen e përparimit teknik, dhe politikën strukturore, përkatësisht politikën e ruajtjes së strukturës ekzistuese ekonomike,

përkatësisht të përshtatjes së strukturës ekonomike (të vendosjes së të ashtuquajturit ekuilibër të sektorëve), përkatësisht të ndërtimit të strukturës së atillë ekonomike e cila mund të vlerësohet si adekuate për një shtet në kohën e caktuar dhe në kuadër të politikës strukturore dhe të politikës regjionale - politikës e cila: **(a)** duhet të nxisë zhvillimin ekonomik të viseve jo mjaft të zhvilluara dhe **(b)** të stimulojë procesin e krijimit të aglomerimeve të mëdha.

Qëllimet e përmendura të politikës fiskale mund të realizohen me aplikimin e instrumenteve të mbledhjes së të hyrave publike dhe të instrumenteve të shpenzimeve publike, përkatësisht me aplikimin e instrumenteve të para dhe të dyta. Me rastin e aplikimit të këtyre instrumenteve paraqitet problemi i koordinimit të tyre. Kështu p. sh. aplikimi i disa prej instrumenteve fiskale, (që kanë qenë të motivuara në radhë të parë nga qëllimet e politikës alokative, gjithashtu kanë edhe efekt redistributiv dhe anasjelltas. Gjithashtu edhe masat e politikës së stabilizimit mund të kenë efekte të caktuara që janë përmendur në mesin e qëllimeve redistributive dhe alokative të masave të politikës fiskale.

Me rastin e studimit të ndikimit të instrumenteve fiskale dhe të masave të politikës fiskale duhet pasur kujdes se qëllimi që dëshirohet të arrihet me aplikimin e disa instrumenteve të financave publike nuk do të thotë se duhet të realizohet patjetër në praktikë. Në të vërtetë, për shkak të evazionit tatimor (përpos evazionit të organizuar me ligj), për shkak të bartjes së paqëllimshme të tatimeve, padrejtësive të ndryshme, çmimeve dhe vlerësimeve të gabueshme si dhe për shkak të dështimeve me rastin e plotësimit të nevojave të caktuara shoqërore etj. mund të ndodhë mospërputhja e qëllimeve dhe e efekteve të aplikimit të instrumenteve fiskale. Ndonjëherë qëllimet që dëshirohen të arrihen me aplikimin e këtyre instrumenteve mund të jenë diametralisht të kundërta me efektet që këto instrumente i kanë shkaktuar në praktikë.

Që të evitohen çrregullimet e caktuara në ekonomi, që me masat e politikës fiskale të ndikohet në proceset dhe në dukuritë e caktuara të padëshiruara, është e nevojshme që të identifikohet sa me parë dukuria dhe madhësia e saj dhe të përcaktohen ato masa me të cilat do të ndikohet në këtë dukuri. Me këtë rast shtrohen disa çështje, si p. sh. cili është ai që do të përcaktojë (diagnostifikojë) se ka ndodhur ndonjë ecuri e padëshirueshme, e dëmshme në ekonomi, dhe cilat janë dimensionet e saj, cilat masa duhet të ndërmerren që të eliminohen ato dukuri të dëmshme? .²

² Prof.Dr.Bozhidar Jelçiq „Fakulteti Juridik-Universiteti i Kosovës në Prishtinë
Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare-botues enti i teksteve dhe mjeteve
Prishtinë 1985.përkthyes –Mr.Sabri Kadriu.faqe 650 - 653

2.3 Masat e politikës fiskale

Në kohën e çrregullimeve të ekuilibrit në mes të ofertës dhe kërkesës së gjithmbarshme, shteti duhet ta zvogëlojë patjetër kërkesën e vet, kurse në kohën e zvogëlimit të kërkesës, shteti duhet të rrisë patjetër shpenzimet e veta në mënyrë që të ndikojë në rritjen e kërkesës së gjithmbarshme. Me një fjalë shteti duhet ta percjellë me kujdes ofertën dhe kërkesën në mënyrë që ta ruajë ekuilibrin, andaj kjo quhet politikë fiskale anticiklike.

Ndryshimet në llojin dhe në lartësinë e të hyrave dhe të shpenzimeve publike zakonisht bëhen me aplikimin e :

(1) stabilizatorit automatik (të inkorporuar),

(2) formulës së elasticitetit dhe

(3) masave diskrete.

(1) Me nocionin stabilizator automatik (i inkorporuar), nënkuptohen ato të hyra publike dhe shpenzime publike të cilat reagojnë automatikisht, pa ndikimin e drejtpërdrejtë të shtetit, në ndryshimet në sferën private dhe në këtë mënyrë i zbusin efektet e ndryshimeve të ofertës dhe të kërkesës së gjithmbarshme. Vendi më i rëndësishëm në mesin e stabilizatorëve automatik i takon tatimit në të ardhura, me rastin e aplikimit të të cilit përdoren përqindjet progresive. Në të vërtetë, gjatë hovit ekonomik bëhet rritja e të ardhurave të subjekteve ekonomike dhe rritja e kërkesës. Për shkak të përqindjeve progresive të aplikuara me rastin e tatimit të të hyrave rritet ngarkimi tatimor i obliguesve tatimorë më shpejt sesa është rritja e të ardhurave në dispozicion, e kjo ndikon pozitivisht në stabilizimin në ekonomi. Në kohën e depresionit në ekonomi aplikimi i tatimit progresiv në të ardhurat ndikon në rritjen më të shpejtë të përqindjes së shpenzimeve publike dhe të të hyrave publike. Këtu është e nevojshme të theksohet në mënyrë të veçantë se për efektet stabilizuese të stabilizatorëve automatikë (të inkorporuar) mund të flitet vetëm atëherë kur teprica e të hyrave publike, që është bërë në kohën e hovit ekonomik, përjashtohet nga qarkullimi, përkatesisht në qoftë se mungesa e të hyrave që ndodh në kohën e depresionit në ekonomi plotësohet me mjetet e huas, financimi deficitar.

Në shpenzimet publike rolin e stabilizatorit automatik e kanë dhëniet e ndryshme sociale në radhë të parë kompensimet në të holla për të papunët në kohën e recesionit, shteti paguan nga buxheti nga fondet e ndryshme etj.

Shuma më të mëdha në emër të ndihmës sociale, e kjo ndikon pozitivisht në rritjen e kërkesës private (e me këtë edhe në rritjen e prodhimit), kurse në kohën e prosperitetit ekonomik bëhet zvogëlimi i dhënieve sociale, përkatesisht paraqiten tepricat në këtë sektor të shpenzimeve publike, e kjo do të ndikojë në kufizimin e kërkesës, e me këtë do të ndikojë në drejtim të stabilizimit në ekonomi.

Që të sigurohet mundësia më e madhe e shfrytëzimit të stabilizatorit automatik, në buxhet duhet t'u sigurohet një vend më i dukshëm atyre të hyrave dhe shpenzimeve që do të kenë efekt automatik stabilizues. Mirëpo, duhet të vërejmë se shfrytëzimi i stabilizatorit automatik nuk mund zëvendësojë (plotësisht) masat e tjera të politikës aktive konjukturore anticiklike të shtetit. Në kushtet bashkëkohëse krahas stabilizatorëve automatikë aplikohen edhe masat e tjera të politikës fiskale që të pengohen, përkatesisht të kufizohen çrregullimet në ekonomi.

(2)Me nocionin e formulës së elasticitetit nënkuptohen masat që janë të orientuara kah pengimi, përkatesisht kah eliminimi i pasojave të çrregullimeve në ekonomi. Sipas konceptit të aplikimit të formulës së elasticitetit duhet të sigurohet automatizmi i caktuar në eliminimin e pasojave të ecurive të papërshtatshme në ekonomi. Në të vërtetë, me dispozita përcaktohen masa të caktuara të cilat duhet të ndërmerren në domenin e politikës tatimore dhe të politikës së të hyrave publike në përgjithësi në përqindjen e punësisë, në nivelin e çmimeve, në rritjen e të ardhurave kombëtare, ose në disa madhësi të tjera agregate të caktuara më parë. Kështu p.sh, në rast të rritjes së nivelit të çmimeve për 10% automatikisht do të rritet ngarkimi tatimor për përqindje të caktuar, përkatesisht do të zvogëlohen shpenzimet publike.

(3)Masat diskrete të politikës fiskale kanë vendin më të rëndësishëm ndër masat e politikës fiskale, ndër masat bashkëkohëse të politikës së stabilizimit. Ky emërtim përdoret për ato masa që organet kompetente shtetërore, sipas vlerësimit të vet, i ndërmarrin për realizimin e stabilizimit ekonomik *ad hoc*, do të thotë, me ndërmarrjen e masave të caktuara që nuk janë të përcaktuara që më parë.

Rëndom, për ndërmarrjen e masave diskrete të politikës fiskale janë të autorizuar organet ekzekutive, qeveria ose ministrinë (ministrat) kompetentë. Në qoftë se këto masa janë në kompetencën e parlamentit (kuvendit), nevojitet një kohë më e gjatë (që të reagohet ndaj dukurive të caktuara për shkak të procedurës relativisht komplekse, të gjatë, të punës së forumit përfaqësues dhe të organeve të tij).

Mirëpo, edhe atëherë kur masat diskrete të politikës fiskale janë në kompetencën e organeve ekzekutive, është përcaktuar se qeveria më vonë duhet të kërkojë leje nga parlamenti.

Masat diskrete të politikës fiskale, në krahasim me aplikimin e stabilizatorit automatik dhe të formulës së elasticitetit, kanë mungesa të caktuara: periudhën relativisht më të gjatë prej shfaqjes së mungesave të caktuara në ekonomi deri në veprimet për evitimin e tyre. Mirëpo, për masat diskrete mund të thuhet se janë, përkatësisht se mund të jenë, më të përshtatshme sesa masat e tjera të politikës fiskale me supozimin e ekzistimit të kuadrove të arsimuara në mënyrë adekuate që do t'u shërbejnë në mënyrën më të përshtatshme që është e mundshme.³

³ Prof.Dr.Bozhidar Jelçiq ,Fakulteti Juridik-Universiteti i Kosovës në Prishtinë
Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare-botues enti i teksteve dhe mjeteve
Prishtinë 1985.përkthyes –Mr.Sabri Kadriu.faqe 653-656.

2.4 Ndikimi i instrumenteve fiskale në punësim dhe në nivelin e çmimeve

Shteti dhe forumet e tjera juridikopublike disponojnë një pjesë të rëndësishme të të ardhurave kombëtare. Ata paraqiten në treg dhe e blejnë drejtpërdrejt mallin dhe e paguajnë kompensimin për shërbimet e bëra njësoj sikurse e bëjnë këtë, në të njëjtin treg, edhe subjektet private. Nga të hyrat publike paguhen pensionet dhe invalidinat, kompensimet në kohën e papunësisë, shtesat e fëmijëve, kompensimet për kohën e pushimeve të lehonave, llojet e ndryshme të ndihmës sociale e dhëniet e tjera, që shkaktojnë rritjen e fuqisë ekonomike dhe blerëse të atyre që kanë marrë pensionet, kompensimet dhe dhëniet e tjera transfere.

Që të pasqyrohet niveli ekzistues i çmimeve, që të pengohet prishja e marrëdhënieve midis ofertës dhe kërkesës, që të pengohet prishja e ekuilibrit midis fondeve të mallit dhe të parasë, përkatësisht që të ndikohet në ruajtjen e nivelit ekzistues të çmimeve, duhet të zvogëlohet kërkesa e gjithmbarshme në treg në atë mënyrë që ajo të jetë e harmonizuar me ofertën e gjithmbarshme, duhet të eliminohen shkaqet që e kanë prishur ekuilibrin ekzistues midis ofertës dhe kërkesës, përkatësisht duhet të pengohet prishja e ekuilibrit. Krahas masave të politikës fiskale ekspansioniste, që janë të orientuara në drejtim të tejkalimit të recesionit dhe të masave të politikës fiskale restriktive dhe kontraktive, që kanë për detyrë ta frenojnë kërkesën e rritur, duhet përmendur edhe masat e politikës fiskale neutrale (konjukturore neutrale) të shtetit, që janë të orientuara nga ruajtja ose stabilizimi i punësimit të plotë, pranë nivelit ekzistues të çmimeve, përkatësisht ofertës dhe kërkesës së gjithmbarshme ekzistuese. Në qoftë se sistemi fiskal dhe masat e politikës tatimore sigurojnë ruajtjen e punësimit të plotë pranë nivelit ekzistues të çmimeve, përkatësisht pranë ekuilibrit ekzistues në ekonomi, atëherë ato kanë efekt neutral dhe këtu është fjala për masat neutrale konjukturore të politikës fiskale. Shpenzimet publike duhet të jenë të përcaktuara në atë mënyrë që kërkesa globale të mbetet e pandryshuar.⁴

⁴ Prof.Dr.Bozhidar Jelçiq ,Fakulteti Juridik-Universiteti i Kosovës në Prishtinë
Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare-botues enti i teksteve dhe mjeteve

2.5 Ndikimi i politikës fiskale në redistribuimin e të ardhurave dhe të pasurisë.

Me aplikimin e instrumenteve të politikës fiskale mund të ndikohet në rindarjen e të ardhurave dhe të pasurisë, mund të realizohen disa marrëdhënie të dëshirueshme në fuqinë ekonomike të qytetarëve. Ndryshimet në lartësinë e të ardhurave mund të zvogëlohen dhe kështu të vendosen disa ndryshime që në pikëpamje shoqërore mund të pranohen me tatimin e, **(a)** të ardhurave me aplikimin e përqindjeve progresive tatimore, **(b)** me lirime e lehtësime të ndryshme në tatimet direkte dhe **(c)** me tatimin e diferencuar të disa pjesëve të të ardhurave, kështu që ai që ka fuqi ekonomike më të madhe mban edhe barrën më të madhe. Rindarja e të ardhurave mund të bëhet edhe me anë të shpenzimeve publike. Kështu, me dhënien e bursave fëmijëve të prindërve, fuqia ekonomike e të cilëve është më e vogël, me dhënien e ndihmave të ndryshme si (shtesat e fëmijeve, plotësimi i një pjese të shpenzimeve banesore, kompensimi më i vogël për shfrytëzimin e çerdheve dhe të kopshteve të fëmijëve, etj.) mund të ndikohet në zvogëlimin e ndryshimeve në lartësinë e të ardhurave dhe në afrimin e tyre me disa marrëdhënie të caktuara. Me rastin e vlerësimit të ndikimit të masave të politikës fiskale në rindarjen e të ardhurave duhet pasur kujdes edhe për ndikimin e tatimeve indirekte. Efekti regresiv i tatimeve indirekte është aq më i madh, sa më i madh të jetë numri i produkteve dhe i shërbimeve të përfshira me këtë tatim, sa më i madh të jetë ngarkimi tatimor dhe sa më pak të jetë i përfaqësuar selektiviteti në tatimin e produkteve dhe të shërbimeve në qarkullim.⁵

⁵ Prof.Dr.Bozhidar Jelçiq ,Fakulteti Juridik-Universiteti i Kosovës në Prishtinë
Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare-botues enti i teksteve dhe mjeteve
Prishtinë 1985.përkthyes –Mr.Sabri Kadriu.faqe 660 .

2.6 Efektet e tjera të aplikimit të instrumenteve të politikës fiskale

Krahas shfrytëzimit të instrumenteve të politikës fiskale për realizimin e stabilizimit ekonomik (ndikimi në papunësi dhe në nivelin e çmimeve), krahas ndikimit të tyre në rritjen ekonomike, në rindarjen e të ardhurave dhe të pasurisë, instrumentet fiskale përdoren, përkatësisht mund të përdoren edhe për realizimin e qëllimeve tjera. Shteti, me aktivitetin e vet financiar, e mundëson dhe e lehtëson realizimin e qëllimeve të ndryshme të politikës së vet, si p. sh. të politikës së edukimit dhe të arsimit, të politikës shkencore, demografike, kulturore, shëndetësore, banesore, të politikës së komunikacionit, etj. Shteti paraqitet edhe si punëdhënës i madh (nëpunësit shtetërorë, ushtarët, punëtorët në ndërmarrjet ekonomike shtetërore). Shteti kujdeset për përmirësimin e kushteve të jetës dhe të punës së njerëzve. Me masat e politikës fiskale (politika doganore) shteti përpiqet ta rrisë eksportin dhe ta zvogëlojë importin dhe kështu ta zvogëlojë, përkatësisht ta eliminojë deficitin në bilancin e pagesave të vendit dhe ta përmirësojë pozitën e valutës së vendit. Me masat, e politikës fiskale mund të ndikohet me sukses në zhvillimin regjional, në shpejtimin e zhvillimit të pjesëve ekonomike jo mjaft të zhvilluara të vendit, në ndryshimin e strukturës ekonomike jo të përshtatshme, në evitimin e disharmonisë në zhvillimin ekonomik. Këto masa gjithashtu mund të shfrytëzohen si mbrojtje kundër përqëndrimit gjithnjë e më të madh të popullsisë në qytete të mëdha. Përvojat e shumë vendeve shumë të zhvilluara industrialisht dhe vendeve në zhvillim tregojnë se të gjitha këto i shfrytëzojnë me më shumë ose më pak sukses instrumentet e të hyrave publike dhe të shpenzimeve publike që t'i anulojnë ose t'i zvogëlojnë vështirësitë me të cilat janë ballafaquar ekonomitë e tyre dhe që të realizojnë detyra të shumëllojshme nga kompetenca e tyre.⁶

⁶Prof.Dr.Bozhidar Jelçiq „Fakulteti Juridik-Universiteti i Kosovës në Prishtinë
Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare-botues enti i teksteve dhe mjeteve
Prishtinë 1985.përkthyes –Mr.Sabri Kadriu. faqe- 661 - 662.

2.7 Politika Fiskale dhe Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (2008-2012)

Buxheti paraqet planin e të hyrave dhe shpenzimeve gjatë vitit. Buxheti i një vendi paraqet instrumentin kryesor përmes të cilit planifikohet mbledhja e të hyrave nga ekonomia në mënyrë efektive si dhe përdorimi i tyre në mënyrë të përgjegjshme. Raportin ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve nuk mund ta shikojmë ndaras, nga se bëhet fjalë për raportin në mes të parave të mbledhura dhe përdorimit të atyre parave sipas prioritetit të vëna brenda buxhetit nga qeveria e vendit.

Përmes buxhetit shteti realizon qëllimet ekonomike, politike, financiare dhe sociale në vend. Hartimi i buxhetit mundëson krijimin e një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve politike, të shprehura në strategjitë sektoriale të vendit, dhe prioritetëve në shpenzime me qëllim të shpërndarjes efektive të burimeve që i disponon vendi. Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritate të vendosura për një periudhë afatmesme, për të gjitha programet e shpenzimeve është parakusht për menaxhim efektiv si dhe efikas në realizimin e shpenzimeve publike dhe destinimin e mjeteve. Kjo qasje ndihmon shumë në forcimin e disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen në menyrë reale brenda parametrave makroekonomikë dhe fiskalë.

Një buxhet në nivel qendror, për cilëndo periudhë (afatmesme, afatgjate, apo edhe vjetore) përfshin të gjitha programet e zhvillimit të vendit duke u fokusuar në programet prioritare, të cilat vijnë si rezultat i një procesi të përcaktimit të politikave të zhvillimit me instrumente fiskale dhe buxhetore. I gjithë ky proces drejtohet nga identifikimi i nevojave dhe përcaktimi i prioritetëve sipas këndvështrimit të nevojave të qytetarëve.

Duhet theksuar se në Kosovë ka pasur përmirësime të vazhdueshme të mekanizmave dhe instrumenteve sistemorë dhe politikë gjatë sajimit, diskutimit dhe aprovimit të planit buxhetor. Studimit të buxhetit duhet qasur në mënyrë komplekse nga dy segmentet kryesore të tij, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.

Në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa funksionon Departamenti i Buxhetit, i cili është përgjegjës për:

1. Hartimin e Propozimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës,
2. Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, si dhe
3. Ushtrimin e të gjitha përgjegjësiave tjera të cilat i janë caktuar Departamentit të Buxhetit nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

2.8 Parimet e politikave buxhetore

Buxheti përfaqëson një plan financiar që përmbledhë të ardhurat dhe shpenzimet qeveritare të parashikuara për vitin e ardhshëm dhe ka tre funksione kryesore:

1. Të tregojë objektivat kryesore të qeverisë gjatë vitit buxhetor,
2. Të shërbejë si instrument që lejon shtetin të ketë një influencë mbi situatën ekonomike në vend dhe
3. Të shërbejë si një sistem që kontrollon mbledhjen dhe shpërndarjen e burimeve buxhetore.

Ndërsa MEF-it në strategjinë e vet jep arsyet se pse themelohet buxheti e që këto arsye janë:

Që të merret parasysh qartë fakti që vendimet e qeverisë sot, kanë komplikime për vitet e ardhshme.

Që të mundësohet stabiliteti dhe qëndrueshmëria fiskale .

Që të vendosen ndarjet buxhetore për shpenzime gjatë vitit me para të gatshme, nga qasja e mëhershme e zotimeve shumëvjeçare.

Që të përmirësohet transparenca dhe të ndihmohet vendimmarrja, posaçërisht përkitazi me subvencionet për ndërmarrjet publike (NP).

Që të përmirësohet si cilësia, ashtu edhe sasia e shpenzimeve publike në arsim, në shëndetësi dhe infrastrukturë.

Që të vendosen shpenzimet qeveritare në një nivel të qëndrueshëm për të respektuar shtrëngesat buxhetore.

Politikat në lidhje me buxhetin në termet ekonomike dhe në jetën e përditshme, njihen me emrin Politika fiskale të cilat hartohen dhe zbatohen nga shteti, nëpërmjet aktivitetit të saj që pasqyrohet në planin financiar që quhet buxhet i shtetit.

Buxheti i parashikuar në fund të vitit buxhetor, mund të jetë në këto mënyra dhe të njihet me këta emra:

a . Kur të ardhurat e parashikuara janë të barabarta me shpenzimet e parashikuara buxheti quhet **buxhet i balancuar**.

b. Kur të ardhurat janë më të mëdha se shpenzimet, buxheti është me tepriçë ose quhet **suficit**, ndërsa

c. kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat, buxheti është me **deficit**.

Kur shpenzimet që janë më të mëdha se të ardhurat qeveria i mbulon duke marrë hua ose duke emetuar para, ndërsa në Kosovë nuk ka mundësi të emitojë para, por vetëm mund të marrë ndonjë hua edhe pse pengesë ishte, statusi i Kosovës sa i përket huave ndërkombëtare . Nga viti 2004 MEF grumbullon të hyra për buxhetin e Kosovës përmes Administratës Tatimore të Kosovës(ATK) dhe Shërbimit Doganor. ATK është përgjegjëse që përmes taksave të mbledhura të planifikojë dhe të sigurojë të hyra buxhetore. Ndërsa, Departamenti i buxhetit pranë MEF-it bën planifikimet buxhetore sipas kërkesave të Ministrive përkatëse të qeverisë së Kosovës dhe njëkohësisht cakton prioritetet duke marrë parasysh se nevojat e Ministrive dhe agjencioneve shpenzuese janë të mëdha. Ndërsa, përfundimisht buxheti aprovet nga Kuvendi i Kosovës për vitin fiskal në vijim. Fondet buxhetore të cilat ndahen për agjencionet shpenzuese parashihen të shpenzohen gjatë vitit. Pas gjashtëmujorit bëhet rishikimi i buxhetit deri në fund të vitit me ç'rast mund të kërkohen ndryshime të planit nga buxheti fillestar në fillim të vitit. Shpesh ndodh që të bëhen ridentinime të vijave buxhetore apo edhe të kërkohen mjete shtesë nëse paraqitet nevoja. Në rastet kur mjetet e planifikuara nuk shpenzohen gjatë vitit fiskal, gjë që më së shpeshti ndodh, ato mjete kthehen në fondet rezerve të BK (Buxhetit të Kosovës) dhe trajtohen si suficit. Ndërsa organizatës buxhetore në vitin tjetër i mungohen mjetet duke u konsideruar se ajo ka më pak nevoja se sa ka kërkuar gjatë vitit buxhetor paraprak .

Menaxhimi efektiv i buxhetit si dhe shpenzimeve buxhetore në përgjithësi fillon me përcaktimin e qartë të përgjegjësi në kuadër të qeverisë. Për këtë qëllim secili vend duhet të nxjerrë infrastrukturën ligjore. Bartëse kryesore e infrastrukturës ligjore buxhetore është Ministria e Financave. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës miratohet nga Kuvendi i Kosovës dhe fillon të përdoret në momentin e nënshkrimit të tij nga Presidenti i Republikës.

Buxheti i Kosovës financon të gjitha segmentet apo organizatat buxhetore edhe pse disa prej tyre, nuk kanë qasje dhe menaxhohen nga ndërkombëtarët apo njihen si të drejta të rezervuara.

Pothuajse, në të gjitha vendet e botës buxheti përbëhet nga tri pjesë: të ardhurat, shpenzimet, dhe pjesa e buxhetit që financohet.

Në pjesët që do të financohen paraqitet pjesë e pambuluar, si dhe mënyrat si ajo do të financohen, që për shembull në rastin e familjes - individit mund të jetë kredi në banka, huamarrja nga të afërmit, etj. Po ashtu në këtë pjesë të buxhetit, jepen gjithashtu huamarrja dhe pagesa e borxheve, nëse nevojat kanë qenë më të mëdha edhe më parë edhe ndërkohë paguhet pjesa e detyrimit, për të. Nëse nuk ka mungesa, atëherë, llogaria e interesuar për hyrjet dhe daljet e parave. financimit tregon të gjitha tepricat, dhe mënyrën se si ato përdoren, mund të jenë depozita sigurimi, investime në shtëpi ose aktivitete të ndryshme, etj. Shteti funksionon pothuajse sikurse individ apo si familja.

Për këtë arsye qeveria planifikon:

1. **Të ardhurat**, që tregon sa para do të mbledhë gjatë vitit dhe si do t'i mbledhë ato,

2. **Shpenzimet**, që tregon sa para do të shpenzohet dhe për çfarë.

Pra, me sa shihet është çështje e një plani, ose një përlogaritje e të ardhurave, të hyrave dhe shpenzimeve që duhet të aprovohet nga Kuvendi. Ndërsa në Kosovë, pos Kuvendit duhet që aprovimin final ta japë Presidenti i Republikës i cili pavarësisht vendimit të Kuvendit të Kosovës mund të mos e nënshkruajë, apo edhe të kundërtën nëse nuk miratohet në Kuvend, ai e shfrytëzon të drejtën të nënshkruajë.

Buxheti zakonisht aprovohet në muajin Dhjetor , domethënë përpara fillimit të vitit buxhetor të cilit ai i korrespondon.

Parashikimi 12 muaj për të cilën shteti, planifikon të ardhurat dhe shpenzimet quhet vit Buxhetor. Në Kosovë, viti buxhetor fillon më 1 Janar dhe zgjat deri më 31 Dhjetor, pra në Kosovë dhe në shumë vende tjera përputhet me vitin kalendarik.

Në Republikën e Shqipërisë, viti buxhetor zgjat nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor, domethënë ai përputhet plotësisht me vitin kalendarik.

2.9 Të hyrat buxhetore

Studimit të buxhetit duhet qasur në mënyrë komplekse nga dy segmentet kryesore të tij, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Nëse i bëjmë një diskutim periudhës së deritashme, që nga periudha e pasluftës së fundit në Kosovë, nga viti 1999, të hyrat buxhetore në fillim kryesisht bazoheshin në donacione, grante dhe ndihma të dhuruara nga jashtë. Në këto rrethana nuk kishte ndonjë planifikim të buxhetit dhe një gjë e tillë ishte gati e pamundur. Për shumë vite me buxhetin e Kosovës ka administruar UNMIK-u. Si organizatë ndërkombëtare UNMIK-u e ka luajtur rolin e qeverisë së Kosovës. Përmes stafit dhe ekspertëve të vet, UNMIK-u synonte të sjellë përvojat më të mira të vendeve të zhvilluara dhe të ndërtojë një sistem funksional dhe efikas të buxhetit. Ndryshime pozitive kanë ndodhur në vitin 2004,

ku të hyrat buxhetore të Kosovës janë bazuar në të hyrat vendore, kur proceset buxhetore fillojnë të udhëhiqen nga Ministria për Ekonomi dhe Financa (MEF), sipas praktikave të vendeve me ekonomi të zhvilluar. Për Kosovë të ardhurat doganore vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në totalin e të ardhurave, në raport me vendet e tjera krahasuese: Në fund të vitit 2008, të hyrat doganore në raport me të hyrat buxhetore për disa nga vendet e rajonit janë si më poshtë: Kosovë rreth 15,0%, Shqipëria 9,0%, Maqedoni 10.2%, Rumania 3.5%, Bullgaria 2.0%, etj. Pjesëmarrja e të hyrave buxhetore në GDP e vendit është rritur në vazhdimësi nga viti 2002. Aktualisht ajo sillet rreth 28,5%. Në vitin 2007 dhe 2008 kjo përqindje është më e vogël (rreth 27,0%).

Nga të dhënat e tabelës në vijim shihet se tatimet indirekte (TVSH-ja, akcizat dhe taksat doganore) në të tri vitet e analizuar formojnë pjesën dërmuese të hyrave tatimore në Kosovë, krahasuar me të hyrat nga tatimet direkte. Të hyrat komunale tatimore dhe jotatimore komunale përbëjnë rreth 13,0% të hyrave të tërësishme buxhetore. Ndryshimet në raportet midis tatimeve në nivel qendror dhe komunal sipas viteve të analizuar janë të parëndësishme (të përafërta).

Tabela 1: Struktura e të hyrave të përgjithshme të Qeverisë së Kosovës 2006-2008

	2006	2007	2008
Gjithsej të hyrat:	100.0	100.0	100.0
Tatimet	87.2	79.6	84.4
Tatimet direkte	16.8	14.8	17.1
Tatimet indirekte	70.4	64.9	67.3
TVSh	36.3	34.9	38.0
Akciza	22.7	21.3	21.4
Taksa doganore	11.5	9.0	9.8
Tjera	0.4	0.7	0.3
Rikthimet e tatimeve	-0.5	-1.0	-2.2
Të hyrat komunale dhe jo tatimore	12.8	12.0	14.3
Grantet	0.0	0.0	1.3
Të hyrat e njehershme		8.3	

Burimi: Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Pasqyrat financiare 2006-2008

Tabela 2: Pasqyra e pranimeve në para të gatshme për Qeverinë e Kosovës nga Administrata Tatimore dhe Dogana për vitet 2008-2013

Të Hyrat	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tatimi(ATK)	194,361	201,975	218,879	267,505	280,768	302,794
Dogana	604,979	635,195	700,657	827,683	844,860	837,261
Totali	799,340	837,170	919,536	1.095,188	1,125,628	1,140,055

Vlerat janë të shprehura në milion dhe miliard , sipas raportit të marrë në BQK (Banka Qendrore e Kosovës).

TVSH-ja është tatimi më i rëndësishëm sa i përket kontributit, pastaj vijnë akcizat. Është me rëndësi të theksohet se TVSH-ja dhe akciza kryesisht grumbullohen në kufi. Sa i përket shpenzimeve, raporti shpenzime - GDP është rritur nga 19.3 për qind sa ka qenë në vitin 2007, në 26.8 për qind në vitin 2008. Në vitin 2006 dhe 2007 ka pasur suficit buxhetor.

Gjatë viteve të kaluara Buxheti i Kosovës është karakterizuar kryesisht me suficit. Pamundësia e qeverisë për të marrë borxh publik (të brendshëm dhe të jashtëm) për shkak të mungesës së ligjit mbi huamarrjen publike dhe mosdefinimit të statusit politik deri në shkurt të vitit 2008, ka kushtëzuar një sjellje më konservative të qeverisë në aspektin e politikave fiskale. Kështu, mjetet në dispozicion për të financuar ndonjë deficit buxhetor eventual përbëhen vetëm nga tepricat e akumuluar nga vitet e mëparshme. Sidoqoftë, anëtarësimi i Kosovës në FMN, Bankën Botërore si dhe anëtarësimi që pritet të ndodhë në institucionet dhe organizatat tjera financiare dhe të bashkëpunimit në fusha të ndryshme ndërkombëtare, do t'i hapin Kosovës qasje në burime tjera të financimit, për nevojat eventuale buxhetore.⁷

⁷ Myrvete Badivuku-Pantina, Skender Ahmeti, Mixhait Reci, Drita Kaqandolli-Gjonbalaj, Budget Expenditure Structure in Kosovo, The International Conference on Administration and Business, Faculty of Business and Administration, University of Bucharest, 4-5 June, 2010, Romania. AQBK, Raporti vjetor 2008, Prishtinë.

KAPITULLI III

KUPTIMI DHE ESENCA E SHPENZIMEVE PUBLIKE

3.1 Të hyrat (dhe shpenzimet) nga burimet kryesore ne Kosovë

Shpenzimet publike (apo të dalat publike) janë të lidhura me ekzistimin e shtetit dhe me funksionet e tij. Me rritjen e rolit të shtetit rriten edhe shpenzimet e tij.

Në literaturën financiare mund të hasim në definicione të ndryshme të cilat përpiqen që të shpjegojnë kuptimin ose esencën e shpenzimeve publike. Por që në të gjitha rastet definicionet (përkufizimet), të cilat i kanë dhënë autorët e ndryshëm, i përshkojnë këto dy karakteristika: **a)**shpenzimet publike shërbejnë për plotësimin e nevojave kolektive dhe për interesa publike dhe **b)**se shpenzimet publike bëhen në para.

Në literaturë, përveç termit shpenzime publike përdoret edhe termi shpenzime shtetërore. Për arsye se roli i shtetit është shumë i madh në sferën e shpenzimeve të mjeteve financiare për kryerjen e funksioneve të tij, prandaj quhen shpenzime shtetërore me të cilat theksohet roli i shtetit në shpenzimet publike.

Shpenzimet publike janë ngushtë të lidhura me të hyrat publike, sepse pa të hyra nuk mund të ketë shpenzime, andaj të hyrat publike janë burim i financimit të projekteve (nevojave) shtetërore.

Me anë të shpenzimeve publike plotësohen këto nevoja :


1.nevojat e përgjithshme publike (nevojat e administratës shtetërore, organeve përfaqësuesve shtetërorë, mbajtja e ambasadave dhe e përfaqësive në botën e jashtme, dhënia e subvencioneve financimi i armatës, si dhe nevojat e tjera të cilat financohen prej buxhetit të shtetit, pra në nevojat e përgjithshme hyjnë shpenzimet materiale dhe personale të bashkësive shoqërore politike, të organeve qendrore dhe komunale etj.

2.nevojat e përbashkëta ose kolektive përfshijnë (përshijnë nevojat e arsimit, kulturës, shkencës, sigurimit social, pensional dhe invalidor, shëndetësisë, hyrjes në punë,banimit si dhe nevojat tjera të përbashkëta);

3.nevojat e natyrës ekonomike të shtetit (intervenimi i shtetit në ekonomi, në marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, investimi në infrastrukturë etj).⁸

⁸ Prof.Dr. Sabahudin Komoni,Financat Publike .Universiteti i prishtinës –Fakulteti Ekonomik ,faqe19-20.Prishtinë 2008.

Në pyetjen time të bërë rreth mendimit të njerëzve në Kosovë të të gjitha shtresave se çfarë mendimi kanë rreth shpenzimeve publike kemi këtë përgjigje (shih grafikun nr 1).



Grafiku nr 1

3.2 Shkaqet e rritjes së shpenzimeve publike

(sipas Gaston Zhese)

Gaston Zhese shkaqet e rritjes së shpenzimeve publike i ka ndarë në dy grupe:

1)Shkaqet në dukje (formale) dhe në

2)Shkaqet reale.

1. Shkaqet në dukje (formale)-Gaston Zhese i numëron ato shkaqe të cilat nuk rrisin obligimin tatimor, porse ato mbeten në përpjestim të njëjtë si edhe para rritjes. Këto shkaqe janë:

- a) zvogëlimi i fuqisë blerëse të parave,
- b) ndryshimet teknike në përpilimin e buxhetit dhe
- c) ndryshimi i madhësisë së territorit të shtetit.

a) zvogëlimi i fuqisë blerëse të parave. Në bazë të historisë së parave shumë valuta e humbin vlerën e vet në një periudhë të gjatë. Zvogëlimi i vlerës së parasë si dhe stabiliteti i tyre varet prej shumë shkaqeve, të natyrës ekonomike dhe financiare si dhe prej prodhimit dhe produktivitetit të punës, ndërrimit të bazës metalike, çrregullimit të marrëdhënieve nominale të shpenzimeve publike etj

Rënia e fuqisë blerëse e parasë, sidomos shprehet në situata jonormale, siç janë krizat ekonomike, luftërat, fatkeqësitë elementare, tërmetet e ndryshme etj.

b) Ndryshimet teknike në përpilimin e buxhetit. Parimi i plotë i buxhetit kërkon që të gjitha shpenzimet të hyjnë në buxhet pa u bërë kompensimi reciprok me të hyrat.

Kjo mënyrë e përpilimit të buxhetit quhet buxheti bruto.

Ndërsa mënyra e përpilimit të buxhetit neto është kur bëhet kompensimi i të hyrave dhe shpenzimeve. Kjo dukuri ndodh kur shteti kalon nga sistemi neto i buxhetit në sistemin bruto të buxhetit. Këtu kemi rritje të rrejshme të shpenzimeve publike pra nuk është rritja reale e shpenzimeve publike.

c) Ndryshimi i madhësisë së territorit të shtetit. Rritja e territorit të shtetit dhe popullsisë është shkak formal (në dukje) i rritjes së shpenzimeve publike, meqë zgjerimi territorial i shtetit tërheq automatikisht rritjen e numrit të popullsisë të aparatit shtetëror siç janë: gjykatat, policia, shërbimet e ndryshme, sigurimet etj.

Kjo shkakton në mënyrë automatike ngarkesën tatimore dhe barra bie mbi tatimpaguesit e rinj nuk e bën ngarkesën tatimore të tatimpaguesit të vjetër, andaj është shkak formal në dukje (i rrejshëm) e jo real.

2. Shkaqet reale. -Gaston Zhese shkaqet reale të rritjes së shpenzimeve publike i ndan në shkaqe

- a) të natyrës ekonomike,
- b) të natyrës politike dhe
- c) të natyrës financiare.

Këto shkaqe tërheqin me vete rritjen e obligimit tatimor të detyruesit tatimor.

a) Shkaqet e natyrës ekonomike – Në shkaqet e natyrës ekonomike të rritjes së shpenzimeve publike Zhese i dallon dy nëngrupe të ndryshme të shkaqeve:

- Nëngrupi i parë i shkaqeve të natyrës ekonomike është nëngrupi i lidhur me zhvillimin ekonomik. Revolucionin industrial në shekullin XIX dhe XX i cili ka shkaktuar rritjen e pasurisë nacionale dhe shpenzimeve publike, sepse është dashur të zgjerohen funksionet e shtetit në sfera të ndryshme si në kulturë, shendetësi , etj.

- Nëngrupi i dytë i shkaqeve të natyrës ekonomike në rritjen e shpenzimeve publike ka të bëjë me konkurrencën në tregjet e jashtme.

Intervenimi i shtetit në tregjet e jashtme përmes premive të eksportit, çmimeve dampinge, me dhënien e premive p.sh. Në ndërtimin e flotës detare, me një fjalë kemi një perzierje të shtetit në të gjitha sferat ekonomike. Por të gjitha këto kanë efekt në rritjen e gjithmbarshme të shpenzimeve publike .

b)Shkaqet e natyrës politike- Këto shkaqe Zhese i ka ndarë në dy grupe :

* të brendshme dhe

* të jashtme.

- **Shkaqet e brendshme politike-** mund të jenë forma të qeverisë (monarkia, kushtetuese dhe republika). Rrregullimi demokratik ndikon në rritjen e shpenzimeve publike, për arsye se rritet ndikimi i masave më të gjëra në politikën e shkollimit dhe të mjekimit pa pagesë dhe në kontributet sociale.

- **Shkaqet e politikës së natyrës së jashtme-** kryesisht janë situatë politike të ashpërsuara në botë, e cila çon kah forcimi i armatimit, rritja e bazave ushtarake, zgjatja e shërbimit ushtarak etj, pra janë masa shtrënguese të shtetit.

c)Shkaqet e natyreës financiare-Dallojmë dy forma të shkaqeve të rritjes së shpenzimeve publike: pagimi (kthimi) i huas publike dhe udhëheqja e dobët me mjetet financiare publike gjatë suficitit buxhetor .

Në kushtet bashkëkohore shtetet gjithnjë e më shumë po lidhin huan publike, andaj pagimi (kthimi) i tij në formë të anuiteteve paraqet ngarkesë të madhe për financat publike dhe është shkak i përhershëm i rritjes së shpenzimeve publike.

Paraqitja e suficitit buxhetor shkakton patjetër rritjen e shpenzimeve dhe rritjen e shpenzimeve të tepruara. Kjo ndikon drejtpërdrejt në rritjen e përgjithshme të shpenzimeve publike, duke u bazuar në logjikën se sa më lehtë që vijmë deri te mjetet, aq më lehtë dhe më me papërgjegjësi i shpenzojmë ato.

Nga shkaqet e rritjes së shpejtë të shpenzimeve publike nëpër literatura të ndryshme përmenden këta faktorë:

- ndarja e punës shumë më e theksuar,
- rritja e numrit të popullsisë,
- rritja e dendësisë së banimit dhe procesi i urbanizimit (ngritja e lagjeve dhe qyteteve të reja si dhe atyre ekzistuese si pasojë e industrializimit),
- rritja e të ardhurave për krye të banorit si kërkesë për plotësimin e nevojave sociale etj.
- katastrofat e mëdha (ekonomike, natyrore ose lufta),
- intervenimi i shtetit në ekonomi ka tërhequr vëmendjen e shpenzimeve publike .
- pjesëmarrja e shpenzimeve ushtarake në shpenzimet publike.
- përparimi teknologjik që kërkon shumë më tepër shpenzime për kërkime shkencore të cilat nuk mund të financohen në baza komerciale,
- Vjetërsia e popullsisë, sidomos në shtetet e zhvilluara.⁹

3.3 Financat publike dhe ideologjia

Ekonomistët e financës publike analizojnë jo vetëm efektet e veprimeve të qeverisë në lidhje me mënyrën e të tatuarit dhe të shpenzimeve, por edhe mënyrën se si duhet të shihen këto veprime. Pikëpamjet mbi mënyrën e funksionimit të qeverisë në sferën ekonomike. Filozofët politikë kanë veçuar dy teori kryesore:

1. Pikëpamja organike mbi qeverinë dhe
2. Pikëpamja mekaniçiste mbi qeverinë.

1. Pikëpamja organike mbi qeverinë- Shoqëria perceptohet si një organizëm natyror. Secili individ është pjesë e këtij organizimi dhe qeveria mund të mendohet si zemra e tij. Mësuesi kinez i etikës, Yang Chang-chi, Mao Tse-tung thotë se: "ashtu sikurse trupi i njeriut është një tërësi organike, ashtu edhe një vend është një tërësi organike. Nuk është si një makinë që mund t'i heqësh një pjesë dhe pastaj ta bashkosh përsëri." (cituar në Jonson 1983,).

Individi ka rëndësi vetëm si pjesë e komunitetit dhe e mira e individit përcaktohet në lidhje me të mirën e tërësisë. Rrjedhimisht komuniteti vendoset mbi individin.

⁹ Prof.Dr. Sabahudin Komoni, Financat Publike .Universiteti i prishtinës –Fakulteti Ekonomik ,faqe 23-26.Prishtinë 2008.

Objektivat e shoqërisë vendosen nga shteti, përmes politikave fiskale (rregullative) të shtetit i cili e drejton shoqërinë drejt realizimit të atyre objektivave të përcaktuara (sipas Platon-it). Mirëpo këtë mendim rreth shoqërisë nuk e kishte edhe Adolf Hitler (1971-1925), ai i shihte qëllimet e shtetit si arritje e pastërtisë raciale: "shteti është një mjet drejt një qëllimi. Qëllimi i tij qëndron në mbrojtjen dhe avancimin e një komuniteti me krijesa fizikisht dhe psikologjikisht homogjene."

Kurse sipas Leninit (1968/1917), shteti i proletariatit kishte si qëllim "të udhëhiqte të gjithë popullin drejt socializmit, të qenit mësues, udhëheqës dhe drejtues i të gjithë popullit trim dhe punëtor".

Nga këto teori dhe teoritë e tjera mësojmë se objektivat shoqërore mund të ndryshojnë nga vendi në vend, prandaj lind pyetja kritike, e cila ka të bëjë me përzgjedhjen e tyre.

Përkrahësit e pikëpamjes organike zakonisht argumentojnë se objektiva të caktuara natyrshëm ndiqen nga organizmi shoqëror.

Ndjekja e sovranitetit në disa zona gjeografike është një shembull i një objektivit të tillë të natyrshëm. (Autori merr shembull fushatën naziste për dominim në Evropë)

Megjithatë, pavarësisht nga fakti se filozofët kanë luftuar me shekuj për të shpjeguar se çfarë do të thotë e natyrshme, përgjigja nuk është e qartë.

2. Pikëpamja mekaniciste mbi qeverinë

Sipas kësaj pikëpamje, qeveria nuk është pjesë organike e shoqërisë. Për më tepër është një mjet i krijuar nga individët për të arritur më mirë objektivat e tyre individuale. Ashtu sikurse sugjeroi politikani amerikan Henry Clay në vitin 1829, "Qeveria është një kujdestar dhe zyrtarët e saj tutorë, dhe si kujdestari, ashtu edhe tutorët krijohen për të mirën e njerëzve." Në qendër është individi dhe jo grupi.

Duke pranuar se qeveria ekziston për të mirën e njerëzve, ekziston akoma problemi i përcaktimit se çfarë është e mirë dhe si duhet të veprojë qeveria për ta promovuar atë.

Në të vërtetë ekziston një marrëveshje universale që e mira për individët është kur qeveria i mbron ata nga dhuna. Për të vepruar kështu qeveria duhet të ketë një monopol me fuqi detyruese. Ndryshe do të ekzistojë anarkia, siç vuri re filozofi i shekullit 17 Thomas Hobbes (1963/1951,) "Jeta e një njeriu bëhet e vetmuar, e varfër, e pisët, e shëmtuar dhe e shkurtër." Ngjarjet e fundit

në Somali, ku nuk ekziston asnjë qeveri kombëtare dhe dhuna është përhapur kudo, konfirmojnë vëzhgimin e Hobbesit.

Në mënyrë të ngjashme, Adam Smithi argumenton në veprën: “Pasuria e Kombeve se, qeveria duhet të mbrojë “shoqërinë nga dhuna dhe nga pushtimi i shoqërive tjera të pavarura”, dhe të mbrojë “sa më shumë që të jetë e mundur çdo anëtar të shoqërisë nga padrejtësia, ose shtypja e çdo anëtari tjetër i shoqërisë.”

Kështu Adam Smithi argumentoi se qeveria duhet të ketë përgjegjësinë për “krijimin dhe mirëmbajtjen e punëve të caktuara publike dhe institucioneve të caktuara publike, të cilat nuk mund të jenë kurrë në të mirën e një individi ose të një numri të vogël individësh për t’i ngritur dhe mirëmbajtur. këtu mendohet për rrugë, kanalizime, ura, etj, pra në infrastrukturë të ndryshme.

Këtu në këtë pikë, ndahen opinionet brenda pikëpamjes mekaniciste. Liberalët të cilët besojnë në një qeveri shumë të kufizuar, janë kundër çdo roli të mëtejshëm ekonomik të qeverisë. Sipas Adam Smithit, “Çdo njeri, për sa kohë që ai nuk i shkel ligjet e shoqërisë, lihet plotësisht i lirë për të ndjekur interesin e vet, rrugën e vet.

Liberalët janë jashtëzakonisht skeptikë rreth aftësisë së qeverisë për të përmirësuar mirëqenien sociale.

Siç ka thënë edhe Thomas Jefferson:

Disa herë thuhet se njeriu nuk mund t’i besojë qeverisë së tij. Atëherë a mund t’i besojë ai qeverisë së të tjerëve?- Apo, a kemi gjetur engjuj në formën e mbretërve për ta qeverisur atë? Le t’ia lëmë historisë që t’i përgjigjet kësaj pyetje.

Nga ana tjetër, ata që mund të quhen demokratë socialë, besojnë se ndërhyrja e qeverisë është e rëndësishme për të mirën e individëve.

Ndërhyrjet mund t’i marrim në forma të ndryshme, siç janë: rregulloret për sigurinë në vendin e punës, ligjet që ndalojnë diskriminimin racial dhe seksual në banesa, ose pagesat e mirëqenies për të varfërit.

Kur demokratët socialë përballen me kundërshtimin se ndërhyrje të tilla cenojnë lirinë e individit, ata janë të gatshëm të përgjigjen se, liri do të thotë më tepër se sa mungesa e të detyruarit fizik. Një individ i varfër mund të jetë i lirë t’i shpenzojë të ardhurat e tij sipas dëshirës, por qëllimi i kësaj lirie është mjaft i kufizuar.

Sigurisht që ndërmjet liberalëve dhe demokratëve socialë ekziston një pikëpamje lidhur me madhësinë e duhur të ndërhyrjes së qeverisë.

Duke u bazuar në mendimet e autorit si dhe në praktikat e ndryshme të vendeve të ndryshme vërejmë se politika dhe reformat taimore nuk janë të mirëpritura gjithmonë nga të gjithë njerëzit, madje edhe ekspertët të cilët janë për reforma tatimore shpesh nuk pajtohen mes veti. Zyrtarët qeveritar për shembull ushtrojnë gjithmonë presion të fortë sa herë që bëhen ndryshime në politikat tatimore dhe reforma tatimore të kufizohet zbritshmëria e tatimeve shtetërore mbi të ardhurat, kurse opozita ngul këmbë që ato politika të zbriten sa më shumë që është e mundur. Të njëjtat teori mund të shpjegojnë vështirësitë, që ndeshen në përpjekjet për të përmirësuar sistemin tatimor.

Një anëtar i House Ways and Means Committee, Andrew Jacobs, e ka përshkruar në këtë mënyrë : “Nëse ju nuk i paguani tatimet tuaja, ju shkon në burg . Nëse ju arrini të shmangni tatimet ju shkon në Kongresin e SHBA-së dhe pastaj, të shihni se çfarë mund të bëjnë ata për ju. Disa argumente kanë treguar se përpjekjet për të bërë ndryshime të gjëra në sistemin tatimor janë treguar më të suksesshme se sa ato që kanë modifikuar dispozita specifike.

Duke i parë këto teori si dhe shumë teori të mendimtarëve të ndryshëm mund të konkludojmë se çdo reformë tatimore duhet të llogaritet mirë e mirë përparësitë dhe të metat ,vështirësitë të cilat i bartë ne vete çdo reformë tatimore dhe duhet të kërkohet vendosmëri dhe konsensus.

3.4 Politikat dhe reforma tatimore

Diskutimet mbi tatimet kanë nxjerrë në pah një numër tiparesh, që është vështirë të argumentohen mbi baza eficiente, ose barazie.

Një arsye është se, në shumë raste, madje dhe ekspertët më të mëdhenj apo më të njohur nuk bien dakord për drejtimin të cilin duhet të marrë një reformë e caktuar tatimore, pavarësisht se konsensusi midis ekspertëve për tatimim në mënyrë të ndryshme të tipeve të ndryshme të të ardhurave kapitale është i padëshirueshëm, ka mosmarrëveshje rreth asaj se si duhet të rregullohet reforma, sepse për një person, atë të cilën ai e shikon si reformë me qëllim të ecjes para për një person tjetër kjo reformë është perceptohet si një kthim mbrapa .

Një vështirësi tjetër është se përpjekjet për të ndryshuar kushtet specifike ndeshin në kundërshtim politik nga ata të cilët preken apo dëmtohen nga këto ndryshime. Zyrtarët qeveritarë për shembull, ushtrojnë presion të fortë politik, sa herë që bëhen propozime për të kufizuar zbritshmëritë e tatimeve shtetërore mbi të ardhurat. Disa teori apo ide që sugjerojnë një grup janë me interes, por për shoqërinë janë jo optimale. Të njëjtat teori mund të shpjegojnë vështirësitë që ndeshen në përpjekjet për ta përmirësuar sistemin tatimor. Një anëtar i House Ways and

Means Committee, Andrew Jacobs, e ka përshkruar në këtë mënyrë: “Nëse ju nuk paguani tatimet tuaja, ju shkoni në burg . Nëse arrini të shmangni tatimet ju shkoni në Kongresin e SHBA-së dhe pastaj mund të shihni çfarë mund të bëjnë ata për ju” .

Presionet nuk janë pengesat e vetme për reformë, në shumë raste kur ndryshohet një nen tatimor i cili prek vetëm një pjesë të tatimpaguesve (psh., për patundshmëri) njerëzit e zakonshëm e modifikojnë sjelljen e tyre, në bazë të atij neni dhe janë gati të humbin shumë nëse arrijnë ta ndryshojnë atë nen . Disa ekspertë kanë argumentuar (nisur nga përvojat e vendeve të ndryshme sidomos, vendeve në tranzicion), se për të bërë ndryshime të gjëra në sistemin tatimor janë më të sukseshme sepse janë më gjithëpërfshirëse, se sa kur janë vetëm në një lëmi të caktuar.


Por ku mund ta rendisim Kosovën nga ky këndvështrim i shpjeguar më lartë e i cili ju referohet kryesisht SHBA-ve.¹⁰

3.5 Politikat dhe reformat tatimore në Kosovë

Në Kosovë duhet të ndryshohen komplet sistemi tatimor dhe sistemi doganor dhe të jetë gjithëpërfshirës duke marrë për bazë së pari shtrirjen e bazës tatimore dhe gjithëpërfshirjen në sistemin tatimor, duke marrë për bazë edhe përgjigjet nga pyetësi i zhvilluar në teren për ATK-në (Administartën Tatimore të Kosovës) dhe Doganat e Kosovës (shih grafikun nr 2).


Ndryshimi është i domosdoshëm për vetë faktin që Kosova pretendon të hyjë në BE (Bashkimin Evropian), andaj edhe duhet një përshtatje me ligjet e Evropës .

¹⁰ Harvey S. Rosen “Finacat Publike”botues McGraw-Hill Irvin,pjesërisht.
dep.Ekonomiksit Universiteti Priceton
(nëpër tekst ka nderhyrje me qëllim pershtatje lidhur me temen nga autori)
Përkthyer nga shtypshkronja Albin Tiranë 2003. faqe 4,7,444.



Grafiku nr. 2

Duke e ditur që në Kosovë të hyrat në % më të mëdha realizohen nga Administrata Tatimore dhe nga Dogana e Kosovës, ku këto dy agjensione si agjensione të pavarura realizojnë rreth 95 % të të hyrave buxhetore, por pjesa më e madhe e këtyre të hyrave realizohet nga dogana me rreth 70 % , në vitin 2008 janë inkasuar nga dogana 604,979.337 milion euro, në vitin 2009 – 635,195.625 milion , në vitin 2010 -700,657.030 milion , në vitin 2011 - 827,683.273 milion, në vitin 2012 – 844,860.950 milion, në vitin 2013 - 837,261.121 milion , ku shihet edhe nga grafiku i të hyrave në doganë.




Grafiku nr. 3

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Total	604,979,337	635,195,625	700,657,030	827,683,273	844,860,950	837,261,121

Tabela nr.3

Andaj ky parametër ku të hyrat më të mëdha realizohen nga dogana është një tregues jo i mirë për vet faktin që Kosova synon integrimin në Bashkim Evropian .

Andaj dhe në pytësin tim e kam parë të nevojshme ta shtroj pyetjen rreth korigjimit të politikave fiskale dhe përgjigjet e marra janë këto (shif grafikun nr 4):



Grafiku nr. 4

Duke ditur se të hyrat në Kosovë kanë rritje prej vitit në vit si nga tatimet (Administrata tatimore e Kosovës), po ashtu edhe nga Dogana dhe për habinë më të madhe ekonomika e vendit ka rënie. Pse ndodh kjo? Sepse siç e dimë në Kosovë lufta e vitit 1998-1999 shaktërroi gjithçka, dhe menjëherë pas luftës nuk kishte as rend, as ligj e as rregull, por më pas u zhvillua me një hov shumë të madh ekonomia informale (e zezë, ilegale), ekonomia informale si qëllim të vetin ka ikjen nga obligimet tatimore, dhe tani kjo që ne mund të themi se kemi rritje të hyrave nga viti në vit, dhe shpesh edhe të krekosemi në televizion, unë mund të konstatoj se çdo rritje në rastet kur nuk kemi ndonjë zhvillim ekonomik të dukshëm është si rezultat i zvogëlimit të ekonomisë informale.

Dihet tanimë se pothuajse të gjitha vendet e botës, si ato të zhvilluara dhe ato në zhvillim përballen me ekonominë informale, por në vendet në tranzicion kjo gjë është më e përhapur. Ekonomia informale vjen si pasojë e disa faktorëve, po përmendim disa nga këta faktorë: lufta, trazirat sociale, kriza, bllokada ekonomike, izolimi i një vendi ndaj botës dhe tregut botëror etj.

3.6 Ndikimi i tatimit në kushtet e aktivitetit ekonomik

Ndikimi i tatimit në aktivitetin ekonomik të subjekteve ekonomike mund të shikohet në dy aspekte:

a) në aspektin e ndikimit të tatimit në kushtet e afarizmit në drejtim të nxitjes së zhvillimit të përsheptuar ekonomik dhe

b) në aspektin e korrigjimit të fitimit (krijimit) të të ardhurave.

a) Shumica e vendeve në botë sot e shfrytëzojnë tatimin, respektivisht politikën fiskale, me qëllim të realizimit të programeve të caktuara të zhvillimit ekonomik dhe të rezultateve afariste.

Masat tatimore për qëllim të rezultateve afariste sot i përdorin vendet në zhvillim të cilat përpiqen që sa më shpejt të zhvillohen në pikëpamje ekonomike .

Zakonisht njëra nga metodat e tilla më të shpeshta është nxitja e zhvillimit në rend të parë e degëve propulzive ekonomike (degë të cilat shteti i cakton si degë që e nxisin e shtyjnë përpara si fuqi motorike zhvillimin ekonomik). Këto degë propulzive ekonomike lirohen prej ngarkesave të caktuara tatimore me çfarë iu zvogëlohet baza tatimore me qëllim që të zhvillohen më shpejt.

Subjektet apo bizneset që caktohen në grupin e degëve propulzive për shkak të lirimeve tatimore u mbetet pjesë më e madhe e profitit e të cilat parimisht ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Po me këtë qëllim përdoret edhe metoda tatimore e diferencuar, subjektet të cilat i takojnë grupit të bizneseve propulzive u caktohet normë më e ulët tatimore, normë e cila i jep mundësi apo e bën më të aftë për ndarje të mjeteve, për aktivitet investiv, pra e rritë investimin dhe i mundëson të përdor paisje të reja të një teknologjie të avancuar me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës dhe përsheptimit të zhvillimit ekonomik .

b) Ndikimi i tatimit në aspektin e korrigjimit të fitimit (krijimit) të të ardhurave ka të bëjë me marrjen (përfshirjen) nëpërmjet tatimit të ekstra profitit të të ardhurave, e që është rezultat i ndikimit të faktorëve të jashtëm (renta e tregut , renta e tokës, renta e xeheroreve, renta teknike etj.). Subjektet ekonomike deri te ekstra profiti apo ekstra fitimi vijnë për shkak të kushteve të volitshme në treg, të kushteve të volitshme energjetike (p.sh. Shqipëria në kohën kur ka ra reshje të shumta të shiut mund të ketë ekstra profit nga prodhimi i rrymës nga hidrocentralet) dhe të intervenimit shtetëror në kushtet e tregut (p.sh., në Kosovë Posta ka paguar tatim në ekstra profit për shkak të monopolit që kishte). Ekzistojnë dy metoda për tatimin e ekstra profitit nga aspekti i korrigjimit të fitimit.

-Sipas metodës së parë (ex ante) korrigjimi shoqëror i marrëdhënieve ekonomike në mes të subjekteve ekonomike me anë të tatimit duhet të dihet përpara, duke e caktuar obligimin tatimor

përpara në mjetet e punës ose vetëm në pasurinë e patundshme. Mirëpo kjo metodë është kritikuar për shkak se caktimi i tatimit, bëhet para se të dihet rezultati afarist i subjektit apo biznesit ekonomik.

-Sipas metodës së dytë (ex post) korrigjimi shoqëror i marrëdhënieve ekonomike në mes të subjekteve ekonomike me anë të fitimit duhet të bëhet në momentin kur dihet rezultati afarist i subjektit ekonomik dhe atëherë të caktohet obligimi tatimor i cili duhet të ketë efekte të caktuara në kushtet dhe rezultatet e afarizmit. Metoda e dytë i ka dy variante, sipas variantit të parë korrigjimi shoqëror me anë të tatimit në kushtet e afarizmit të subjekteve ekonomike duhet të bëhet më shfrytëzimin e normës progresive tatimore. Kjo do të thotë se norma progresive duhet të përfshijë ekstra profitin apo ekstra të ardhurat në dobi të shoqërisë dhe në atë mënyrë të ndikojë në unifikimin e kushtëzuar të afarizmit në mes të subjekteve ekonomike, me qëllim të konkurrencës reale. Por edhe ky variant është kritikuar nga njohësit e ekonomisë për arsye se mund të përfshijë edhe pjesën e cila nuk është ekstra profit. Prandaj varianti i dytë (i metodës ex post) për t'ju shmangur joprecizitetit të variantit të parë, bazën tatimore e ndanë në dy pjesë, njëra është pjesa e profitit të rregullt me bazën tatimore tjetër (psh, 1.000000 euro tatimohen me 10% tatim, kurse pjesa e extra profitit pas tatimit të rregullt tatohet me normën 30%), ndërsa pjesa tjetër me bazën tjetër e cila zakonisht është më e lartë, që do të thotë se e bën ndarjen e ekstra profitit prej profitit i cili është realizuar nën ndikimin apo konkurrencën e subjekteve tjera ekonomike.

3.7 Ndikimi i tatimit në stabilizimin ekonomik

Ndikimi i tatimit në stabilizimin ekonomik është me rëndësi në vende të ndryshme dhe së bashku me elementet tjerë të stabilizimit ekonomik mund të jetë një instrument shumë efikas në këtë drejtim. Dihet se stabilizimi ekonomik dhe vendosja e ekuilibrit ekonomik nuk bëhet vetëm nën ndikimin e tatimeve dhe të politikës tatimore. Por ekzistojnë edhe faktorë tjerë të cilët ndikojnë në stabilitetin ekonomik (si faktorë me shumë rëndësi është faktori i sigurisë ligjore), prandaj faktorët tatimorë vetëm e ndihmojnë vendosjen e stabilitetit ekonomik. Tatimet duhet të përdoren si instrument për stabilizimin ekonomik së bashku me instrumentet e tjera të stabilizimit, për këtë qëllim duhet shfrytëzuar tatimet e drejtpërdrejta dhe tatimet e tërthorta, varësisht nga burimet të cilat mund të shkaktojnë joekuilibrin ekonomik në rastet kur nuk përputhen oferta dhe kërkesa (në rastet kur nuk pajtohen oferta dhe kërkesa, atëherë për atë ekonomi nacionale themi se është në joekuilibër).

Nëse në një ekonomi kombëtare kërkesa është më e madhe se sa oferta ($K > O$), atëherë me anë të tatimit duhet zvogëluar kërkesën. Kjo arrihet me anë të **politikës tatimore restriktive**. Ndikimi restriktiv i tatimit do të thotë zvogëlim i konsumit, respektivisht zvogëlim i vëllimit të fuqisë blerëse me anë të tatimit, ky efekt mund të arrihet me anë të rritjes së përgjithshme të normave tatimore, aplikimin e llojeve të reja tatimore dhe heqjen e lehtësirave të ndryshme tatimore.

Në rastin e kundërt, kur në ekonominë e një vendi oferta është më e madhe se sa kërkesa ($O > K$) atëherë me anë të tatimeve duhet të nxitet (rritet) kërkesa. Kjo arrihet me anë të **politikës tatimore ekspansive**. Ndikimi ekspansivë do të thotë rritja e kërkesës, ky efekt mund të arrihet me anë të zvogëlimit të normave tatimore, duke rritur lehtësitë tatimore, duke ulur bazën tatimore etj. Ndikimi i tatimit në ekonomi në tërësi dhe sipas strukturës së saj duhet të jetë i harmonizuar me politikën kreditore – monetare në të njëjtin drejtim, që do të thotë nëse dëshirohet politika tatimore restriktive për shkak të kërkesës së lartë, atëherë edhe politika kreditore- monetare duhet të jetë restriktive, sepse nëse kemi politika tatimore restriktive, kurse në anën tjetër zbatojmë politika tatimore ekspansive atëherë e rrisim kërkesën edhe më shumë dhe politika tatimore ekspansive nuk ka efekt, apo e kundërta e saj.

Prandaj, duhet të ekzistojë bashkëpunim dhe koordinim i ngushtë në mes të politikës tatimore dhe asaj kreditore – monetare me qëllim të harmonizimit të veprimeve me qëllim të stabilizimit ekonomik.

3.8 Ndikimi i tatimit në zhvillimin ekonomik

Ndikimi i tatimit në zhvillimin ekonomik është një efekt me rëndësi në kushtet e sotme, kur shteti gjithnjë e më shumë po i merr disa funksione ekonomike. Prandaj, politika tatimore përdoret si faktorë për nxitje të zhvillimit ekonomik së bashku me faktorët tjerë të politikës ekonomike. Politikën tatimore për qëllime të zhvillimit ekonomik e aplikojnë shtetet jo mjaft të zhvilluara të cilat bëjnë përpjekje për një zhvillim të përsheptuar ekonomik (siç është rasti i Kosovës, deri dikund), por edhe shtetet e zhvilluara e përdorin tatimin në raste të caktuara me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik, vendet e zhvilluara ofrojnë lehtësia tatimore duke ju siguruar edhe periudha të pushimit tatimorë bizneseve apo korporatave të mëdha të cilat punësojnë një numër mjaft të madh të punëtorëve.

Ndikimi i tatimit në zhvillim ekonomik bëhet në mënyra të ndryshme. Më të rëndësishmet janë:

- Lirimi prej obligimeve tatimore për të ardhurat që përdoren për investime, falja e tatimit në investime të reja, lirimi prej tatimit i organizatave të reja industriale në një degë

industriale apo në një rajon të caktuar, krijimi i zonave të lira tatimore me qëllim të stimulimit të zhvillimit të përsheptuar të industrisë.

- Zvogëlimi ose lirimi nga pagimi i tatimit në qarkullim respektivisht TVSH-ja (Tatimi i Vlerës së Shtuar, si tatim indirekt, i cili për nga vëllimi është më me rëndësi), në rastet e ndërtimit të objekteve investive, për blerjen e pajisjeve (mjeteve) të punës, për lëndën e parë e cila tutje duhet të futet në prodhim , etj., me qëllim të krijimit të kushteve të punës të përshtatshme për zhvillim ekonomik të shpejtuar.
- Me anë të tatimit ndikohet gjithashtu edhe në zhvillimin e infrastrukturës (komunikacioni, energjetika, banesat, shkollat, objektet kulturore, spitalet etj.), e cila është si parakusht për zhvillimin e shpejtuar ekonomik.

Prandaj tatimi si instrument financiar ka ndikim të shumëfishtë në zhvillimin ekonomik të përsheptuar të një vendi, natyrisht duke vepruar së bashku me instrumentet e tjera të politikës fiskale dhe jofiskale.

3.9 Sistemi tatimor dhe të hyrat tatimore 2008-2013

Me sistemin tatimor kuptojmë të gjitha format e tatimit të cilat i aplikon një vend, e që janë të lidhura me një tërësi me ndihmën e të cilave mund të realizohen qëllimet e politikës fiskale dhe ekonomike. Nëse i krahasojmë sistemet tatimore të shteteve të ndryshme, vërejmë se ekzistojnë dallime në format tatimore të një lloji tatimi apo të një lloji tjetër, kjo varet nga sistemi tatimor që ndërton ai vend.

Kjo ndodh për arsye se sistemi tatimor është rezultat i një muri faktorësh të cilët ndikojnë dhe patjetër duhet marrë, e këta faktorë janë :Struktura e ekonomisë, kushtet historike, rregullimi politik, të ardhurat bruto për banorë, situata në bilancin e pagesave të jashtme (në rastet e kthimit të kredive) etj. Prandaj, sistemet tatimore dhe shkallët tatimore ndryshojnë nga vendi në vend, varësisht prej zhvillimit ekonomik të vendit dhe të standardit të jetës së banorëve të vendit, prej zhvillimit industrial të vendit, pastaj tatimi apo ndërtimi i sistemit tatimor dallon në vendet e zhvilluara krahasuar me vendet në zhvillim, për arsyen e thjeshtë se vendet në zhvillim aplikojnë lehtësira tatimore me qëllim të tërheqjes së investimeve të jashtme.

Tatimi në sistemin e sotëm bashkëkohor bëhet me aplikimin e një numri të madh të llojeve tatimore. Madje mund të themi se nuk ekziston asnjë shtet i cili ka vetëm një lloj të tatimit.

Megjithatë, në teori dhe në praktikë janë të njohura dy forma të sistemit tatimor ; *monizmi* dhe *pluralizmi tatimor*.

Monizmi tatimor është sistem tatimor të cilin e kanë përfaqësuar *fiziokratët* për herë të parë në Francë në shekullin XVI. Esenca e monizmit tatimor është se bujqësia (toka) është burim i vetëm tatimor në të cilën veprimtaria krijohet në mbivlera (produkti i pastër). Sipas mësimave të fiziokratëve, të gjitha tatimet të cilat drejtpërdrejt nuk e ngarkojnë bujqësinë barten dhe paguhet prej produktit të pastër, pra prapëseprapë nga bujqësia. Prandaj fiziokratët në një tatim i cili ngarkon pronarët e tokave dhe paguhet prej mbivlerës së krijuar në bujqësi e kanë bazuar mësimin e tyre mbi monizmin tatimor, pra të tatuarit vetëm me një formë apo me një lloj të tatimit. Sipas ithtarëve të monizmit tatimor, ka përparësi, sepse me aplikimin e një lloji të vetëm të tatimit më thjeshtë, më lehtë dhe më lirë bëhet prerja, mbledhja dhe kontrolli.

Megjithatë, sot askund nuk e hasim këtë lloj të sistemit tatimor i cili përbëhet vetëm prej një lloji (formë) të tatimit, për arsye se vetëm me një lloj të tatimit më nuk mund të përfshihet e tërë fuqia ekonomike e obliguesit tatimor i cili krijon të hyra prej burimeve të ndryshme, mandej duhet të caktohen norma tatimore të larta për mbulimin e shpenzimeve shtetërore dhe se, përveç qëllimeve fiskale, nuk mund të realizohen qëllimet ekonomike dhe sociale të tatimit.

Shtetet bashkëkohore në ditët e sotme aplikojnë sistemin pluralist të tatimeve, sistem i cili bazohet në shumë lloje të ndryshme të tatimeve, me ndihmën e të cilave realizohen politika dhe qëllime të caktuara ekonomike dhe financiare.

Në shtete të ndryshme përdoren lloje të ndryshme të tatimeve, në disa shtete përdoren më shumë tatime direkte, në disa përdoren më shumë tatime indirekte, varësisht prej qëllimeve dhe efekteve të tatimit në marrëdhëniet shoqërore – ekonomike etj.

Edhe pse vërejmë dallime në mes shteteve të llojet e tatimeve, në periudhat më të largëta kohore kemi pasur dallime shumë më të theksuara se sa kemi në kohët e sotme, sepse tani për shkak të lidhjeve ekonomike ndërmjet shteteve dhe krijimit të tregut të lirë, mund të themi se po vërehet një ngjashmëri e madhe tatimore në mes të vendeve, me qëllimin e zhvillimit të ekonomisë. Ngjashmëritë e sistemeve tatimore sidomos vërehen me themelimin e bashkësive ekonomike të cilat nxisin dhe mundësojnë ecuritë integruese në prodhim, në qarkullim të mallrave dhe në financa. Sidomos është i njohur grupi i shteteve të bashkësisë ekonomike Evropiane, për lëvizjen e lirë të kapitalit si dhe për monedhën e përbashkët euro, pastaj grupet integruese në Afrikë, Azi, Amerikën Latine etj. Të gjitha këto integritime në një formë apo në një tjetër bëjnë edhe koordinimin dhe ngjashmëritë në lëmin e sistemit tatimor. Kjo për arsye se lëvizja e lirë e kapitalit, e mallrave dhe shërbimeve, si dhe shfrytëzimi më i mirë i përparësive komparative në mes të shteteve anëtare të bashkësive integruese, përveç tjerash, mund të arrihet edhe me masat e


politikës tatimore. Prandaj bëhen përpjekje që të bëhet harmonizimi minimal i tatimit. Në sistemet pluraliste tatimore të sotme po aplikohen një numër gjithnjë e më i madh i formave tatimore, tatimet që i ngarkojnë të ardhurat, tatimet që i ngarkojnë të hyrat, tatimet mbi pronën, rritjen e vlerës së pronës ose bartjes së pronës, tatimet që ngarkojnë konsumin e të ardhurave, tatimet mbi vlerën e shtuar, tatimet mbi fitimin, tatimet në paga etj.

Kryesisht, sot ekzistojnë sisteme tatimore që mbështeten në tatime të drejtpërdrejta siç është tatimi në të ardhura si dhe në tatime indirekte siç është tatimi i vlerës së shtuar apo tatimi në qarkullim. Në dy dekadat e fundit vërehet një tendencë në rritje e zgjerimit të tatimit të vlerës së shtuar (TVSH), ky lloj tatimi është treguar shumë frytëdhënës për arkën e shtetit, sepse është një tatim i shpërndarë ku llogaritet edhe si tatim të cilin e paguan konsumatori i fundit.

Tatimin e vlerës së shtuar, shtetet e kanë në zbatim me disa shkallë tatimore, në Kosovë dhe shtetet përreth ky lloj i tatimit ka kryesisht tri shkallë tatimore, shkallën 0% në eksporte me të drejtë rimbursimi, shitje për KFOR-in dhe institucionet ndërkombëtare janë të përjashtuara, produkte medicinale janë të përjashtuara, si dhe shitja e banesave për banim është e përjashtuar, kurse në shitjet tjera kemi shkallën 16% (Kosovë), 20% në (Shqipëri) në shitje të tatueshme kurse në produkte medicinale me shkallën 0%, kurse në shtetet tjera të zhvilluara Europiane kemi shkallë të ndryshme si p.sh 19% në Gjermani, 20% në Poloni, Zvicra ka shkallën më të ulët prej 7% dhe në produkte ushqimore ka shkallë 0%, pra kemi ndryshime në shkallë tatimore. Në Kosovë tatimi i vlerës së shtuar është tatimi prej të cilit realizohen të hyrat më të larta ku shihet edhe nga tabela e paraqitur nëpër vite, si dhe nga pjesmarrja në % e paraqitur në grafe, nga viti 2008 deri në vitin 2013.

2008	TË HYRAT TATIMORE SIPAS LLOJIT							
DATA	TP	TF	TVSH	TB	PD	WR	CD	TOTALI
01-2008	25.645,72	120.399,44	4.994.369,62	2.775.366,07	3.625.656,03	701,71	10.448.890,59	21.991.029,18
02-2008	88.363,12	126.560,40	4.147.576,18	3.145.736,71	207.358,41	224,00	851.998,45	8.567.817,27
03-2008	56.770,57	136.982,61	4.093.414,81	3.040.293,84	533.033,33	224,00	1.096.404,74	8.957.123,90
04-2008	42.387,31	104.866,21	5.459.349,86	4.062.806,76	5.190.822,32	224,00	19.503.834,75	34.364.291,21
05-2008	38.139,01	108.611,65	4.033.411,89	3.578.323,89	260.904,70	224,00	1.250.874,88	9.270.490,02
06-2008	42.844,59	120.543,78	4.721.901,19	3.378.367,46	223.166,20	224,00	1.274.911,80	9.761.959,02
07-2008	34.571,96	8.191,29	4.265.382,74	3.345.562,97	3.625.540,95	625,78	13.510.181,53	24.790.057,22
08-2008	18.305,50	58.713,93	4.559.552,84	3.075.111,50	302.398,52	331,30	958.437,48	8.972.851,07
09-2008	66.880,73	32.381,84	6.039.897,66	3.183.021,06	159.246,76	319,62	1.289.196,48	10.770.944,15
10-2008	79.059,56	949.116,19	6.306.268,73	3.770.527,27	4.090.364,13	376,92	16.623.061,30	31.818.774,10
11-2008	62.004,21	80.802,32	4.398.586,63	3.010.439,62	318.261,92	967,85	1.012.034,00	8.883.096,55
12-2008	557.379,89	561.775,22	7.208.834,69	5.263.028,95	740.177,57	1.466,50	1.880.025,15	16.213.050,97
TOTALI	1.112.352,17	2.408.944,88	60.228.546,84	41.628.586,10	19.276.930,84	5.909,68	69.699.851,15	194.361.484,66


Tabela nr.4



Garfiku nr. 5

2009	TË HYRAT TATIMORE SIPAS LLOJIT							
DATA	TP	TF	TVSH	TB	PD	WR	CD	TOTALI
01-2009	164.937,12	107.743,37	10.908.865,77	3.604.623,48	4.329.979,05	1.005.055,88	10.682.987,69	30.804.709,86
02-2009	845.816,59	246.409,66	4.185.131,79	2.736.964,11	371.944,69	843.907,08	161.646,46	9.392.185,38
03-2009	100.230,20	167.916,76	5.129.330,35	2.639.688,10	1.530.945,51	1.101.999,81	5.984.372,71	16.654.848,44
04-2009	120.388,58	162.002,52	4.466.191,33	3.150.233,85	5.179.767,34	807.404,09	7.764.240,13	21.650.592,84
05-2009	62.643,09	168.994,51	5.368.234,08	2.792.564,68	281.785,45	724.986,41	179.613,14	9.578.821,36
06-2009	55.406,45	416.857,04	6.740.912,75	2.831.751,52	330.369,70	752.395,99	252.066,08	11.379.759,53
07-2009	49.577,09	94.407,17	5.139.104,11	2.716.913,91	3.768.920,70	675.336,02	5.317.251,09	17.761.664,64
08-2009	62.787,16	83.935,74	6.195.475,56	2.783.612,09	415.878,94	743.071,19	343.772,66	10.628.533,34
09-2009	64.557,02	807.949,45	7.247.006,74	2.750.252,97	435.285,39	2.651.430,91	147.150,60	14.103.633,08
10-2009	43.824,55	41.284,90	6.637.299,73	2.926.383,59	4.401.323,67	1.011.599,53	7.993.414,09	23.055.130,06
11-2009	145.549,86	102.182,65	8.790.588,15	3.229.237,79	1.001.123,93	1.994.873,73	540.057,59	15.803.613,70
12-2009	339.715,56	5.144.277,60	9.376.614,63	3.617.639,09	586.439,86	1.625.396,80	469.708,68	21.161.619,23
TOTALI	2.055.433,27	7.543.961,37	80.184.754,99	35.779.865,18	22.633.764,23	13.937.457,44	39.836.280,92	201.975.111,46


Tabela nr. 5



Grafiku nr. 6

2010	TË HYRAT TATIMORE SIPAS LLOJIT							
DATA	TP	TF	TVSH	TB	PD	WR	CD	TOTALI
01-2010	7.495,02	6.763,72	7.272.147,71	2.507.216,07	4.566.535,63	1.250.128,72	7.110.253,52	22.720.540,39
02-2010	23.268,80	36.604,57	5.686.157,86	3.817.895,57	723.635,03	1.022.275,72	210.080,73	11.519.918,28
03-2010	50.473,58	44.854,32	6.416.965,43	3.346.434,12	4.375.610,02	883.356,14	5.075.237,24	20.192.930,85
04-2010	121.095,08	22.751,03	6.116.253,72	3.725.796,03	4.447.475,24	1.383.955,08	6.616.605,09	22.433.931,27
05-2010	27.053,78	42.780,96	13.324.224,31	3.429.907,23	457.085,27	1.363.551,78	834.813,78	19.479.417,11
06-2010	32.498,07	31.239,86	6.703.371,49	3.285.019,56	468.569,69	1.004.570,44	283.869,97	11.809.139,08
07-2010	18.862,13	12.995,81	10.330.290,40	3.492.156,95	4.843.201,17	729.005,50	7.498.402,05	26.924.914,01
08-2010	53.911,28	49.925,90	8.723.511,83	3.350.857,62	500.745,11	795.066,30	1.221.523,55	14.695.541,59
09-2010	45.960,83	15.306,93	8.245.277,40	3.505.867,12	725.151,51	981.773,26	450.072,44	13.969.451,58
10-2010	69.908,82	329.228,39	2.775.685,01	3.758.530,32	5.288.999,11	2.216.353,31	8.138.952,17	22.577.947,59
11-2010	40.669,83	97.838,91	8.912.896,30	3.638.363,36	1.134.514,41	1.102.635,04	913.430,73	15.840.375,74
12-2010	13.617,05	21.872,94	9.045.730,95	4.173.601,68	489.789,49	1.379.186,25	1.591.090,72	16.714.959,74
TOTALI	504.814,27	712.163,34	93.552.512,41	42.031.645,63	28.021.311,68	14.111.857,54	39.944.331,99	218.879.067,23


Tabela nr.6



Grafiku nr.7

2011	TË HYRAT TATIMORE SIPAS LLOJIT							
DATA	TP	TF	TVSH	TB	PD	WR	CD	TOTALI
01-2011	6.609,85	12.699,82	11.942.919,03	2.921.357,81	5.328.668,12	1.775.813,97	11.272.114,63	33.260.183,23
02-2011	11.597,70	15.036,59	7.184.362,65	4.274.524,70	287.964,88	890.295,05	629.582,30	13.293.363,87
03-2011	20.544,04	12.046,91	6.523.661,08	3.021.384,39	3.299.669,30	927.800,41	3.626.398,79	17.431.806,89
04-2011	17.382,68	34.506,91	11.179.517,10	5.506.546,81	4.639.611,20	1.184.628,15	6.837.550,52	29.399.743,37
05-2011	12.814,60	163.372,47	9.972.258,46	2.946.982,11	454.931,07	993.363,63	402.042,81	14.945.765,15
06-2011	43.320,08	126.411,96	9.606.866,06	4.577.402,31	241.606,11	854.859,70	343.256,75	15.793.722,97
07-2011	45.640,01	20.819,65	11.674.128,11	4.131.600,77	5.157.477,65	1.354.562,61	7.823.798,26	30.208.027,06
08-2011	46.298,87	1.282.314,37	12.530.551,61	5.955.641,24	444.197,13	1.192.983,53	1.419.784,12	22.871.770,87
09-2011	29.822,87	10.763,69	15.782.334,31	2.932.766,30	382.454,99	1.426.383,86	554.398,67	21.118.924,69
10-2011	18.984,80	8.390,12	14.193.190,88	4.438.318,74	5.448.283,22	1.633.918,79	7.711.280,72	33.452.367,27
11-2011	-64.532,30	11.421,28	9.323.319,09	4.576.620,17	437.387,58	1.296.187,28	360.509,84	15.940.912,94
12-2011	7.397,24	21.057,88	11.040.254,43	6.831.407,94	352.417,85	1.122.056,73	413.175,27	19.788.878,37
TOTALI	195.880,44	1.718.841,65	130.953.362,81	52.114.553,29	26.474.669,10	14.652.853,71	41.393.892,68	267.505.466,68


Tabela nr.7



Grafiku nr.8

2012	TË HYRAT TATIMORE SIPAS LLOJIT							
DATA	TP	TF	TVSH	TB	PD	WR	CD	TOTALI
01-2012	10.626,98	12.089,73	11.233.210,90	3.187.005,08	5.709.259,39	1.979.139,28	8.288.920,38	30.420.302,53
02-2012	11.228,26	2.367,89	13.902.883,67	4.487.211,52	297.930,01	1.355.524,28	464.716,17	20.521.861,80
03-2012	11.396,53	12.826,61	9.147.953,35	4.406.076,17	1.466.453,93	1.081.999,51	3.508.572,12	19.635.278,22
04-2012	-917,07	5.959,84	11.162.579,95	4.525.632,64	6.557.335,13	1.347.816,14	12.278.119,98	35.879.250,96
05-2012	13.630,59	26.265,84	12.416.092,45	4.673.423,14	479.663,22	1.162.514,22	318.412,45	19.090.011,47
06-2012	6.346,75	1.010,40	9.539.950,59	4.576.935,66	396.028,95	962.424,91	304.736,00	15.787.433,26
07-2012	11.823,06	20.151,58	10.904.020,07	4.674.757,45	5.370.683,07	1.294.216,15	9.752.545,31	32.028.196,69
08-2012	15.030,01	12.227,77	12.874.078,87	4.627.383,13	370.787,37	1.144.316,02	803.251,03	19.847.074,20
09-2012	7.477,18	2.787,50	9.702.339,58	4.479.951,16	405.091,32	1.243.954,79	307.466,13	16.149.067,66
10-2012	4.667,10	10.633,34	11.551.964,57	4.579.486,80	6.408.641,25	1.569.082,48	9.804.654,03	33.929.129,57
11-2012	27.789,66	4.495,41	10.288.872,96	6.377.223,51	553.870,10	973.314,91	1.240.066,47	19.465.633,02
12-2012	8.852,14	14.517,46	11.036.818,85	4.938.215,17	602.439,25	906.933,64	507.972,08	18.015.748,59
TOTALI	127.951,19	125.333,37	133.760.765,81	55.533.301,43	28.618.182,99	15.021.236,33	47.579.432,15	280.768.987,97


Tabela nr. 8



Grafiku nr.9

2013	TË HYRAT TATIMORE SIPAS LLOJIT							
DATA	TP	TF	TVSH	TB	PD	WR	CD	TOTALI
01-2013	7.217,65	10.192,03	13.873.888,60	3.415.190,93	6.179.961,88	1.768.584,74	8.780.001,15	34.035.036,98
02-2013	5.907,17	7.009,90	12.911.359,58	4.768.534,96	523.693,24	1.230.617,33	381.559,59	19.829.143,91
03-2013	9.226,39	6.308,76	10.323.474,64	4.872.752,59	1.915.715,02	964.444,49	3.802.238,33	21.894.160,22
04-2013	2.787,42	28.567,37	10.425.500,14	5.079.096,17	6.905.939,74	1.274.292,13	12.502.636,13	36.218.819,10
05-2013	9.234,33	5.082,49	10.763.773,58	4.897.395,30	628.428,70	891.892,54	396.880,88	17.592.687,82
06-2013	9.218,30	1.300,00	11.014.920,31	4.918.656,57	578.516,95	989.033,59	314.390,11	17.826.035,83
07-2013	3.502,26	42.113,04	12.257.840,15	5.185.154,86	5.830.157,01	1.926.636,89	10.737.528,64	35.982.932,85
08-2013	4.519,82	57.286,37	14.864.905,04	6.399.198,48	471.047,80	1.152.605,77	623.629,80	23.573.193,08
09-2013	2.520,53	4.300,87	12.753.360,24	3.407.278,10	379.543,17	1.512.839,11	411.833,78	18.471.675,80
10-2013	2.159,46	7.777,36	12.564.273,72	4.937.697,05	6.297.939,96	1.603.600,95	10.222.696,29	35.636.144,79
11-2013	3.606,12	1.253,77	12.437.050,82	6.685.068,44	493.522,64	1.159.664,57	791.833,25	21.571.999,61
12-2013	13.561,60	7.788,04	13.282.595,29	5.085.807,92	456.727,19	1.043.889,18	272.168,76	20.162.537,98
TOTALI	73.461,05	178.980,00	147.472.942,11	59.651.831,37	30.661.193,30	15.518.101,29	49.237.396,71	302.794.367,97

Tabela nr .9



Grafiku nr.10

3.10 TVSH-ja (Tatimi mbi vlerën e shtuar)

Tatimi i vlerës së shtuar është kryesisht tatim i ri, i cili ka filluar të përdoret kah fundi i shek XX. Tatimi mbi vlerën e shtuar është formë e tatimit me të cilin tatohet vlera të cilën shitësi e ka shtuar në çmimin e shitblerjes të prodhimit dhe të shërbimeve në secilën fazë të ciklit të qarkullimit. Baza e tatimit mbi vlerën e shtuar është diferenca ndërmjet çmimit të furnizimit dhe çmimit të shitjes, pra është tatim mbi konsumin, ku edhe pagesën e këtij tatimi e paguan gjithmonë konsumatori i fundit.

Për herë të parë është aplikuar në Turqi në vitin 1926, por ishte i kufizuar vetëm në fazën e qarkullimit të prodhimit. Ky lloj i tatimit për herë të parë plotësisht është aplikuar në sistemin tatimor për qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve në Danimarkë dhe Brazil në vitin 1966. Më vonë prej 1 Janarit të vitit 1973 edhe shtetet anëtare të Bashkimit Ekonomik Evropian (BEE) e aplikojnë në sistemin fiskal, tatimin e vlerës së shtuar. Madje është kusht që për t'u anëtarësuar në Bashkimin Ekonomik Evropian aplikim i sistemit të TVSH-s (tatimit të vlerës së shtuar).

Shtetet e sapoformuara në Ballkan, në sistemin tatimor të tyre e kanë aplikuar TVSH-në. Sllovenia në vitin 1999, Kroacia në vitin 1998, Maqedonia në vitin 2000, Kosova në vitin 2001, Shqipëria në vitin 1995.

Tatimi mbi vlerën e shtuar në Kosovë ka filluar të aplikohet më 1 Korrik të vitit 2001 në bazë të rregullores së UNMIK-ut Nr 2001/11.

Por vlenë të potencohet se tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH-ja) nuk aplikohet ende në sistemin tatimor të SHBA-së dhe Australisë.

Aplikimi i tatimit mbi vlerën e shtuar në botë sot është shumë i madh, aplikohet në shtetet e zhvilluara dhe në shtetet në zhvillim, është bërë inovacioni themelor në sistemin tatimor të shteteve të ndryshme në botë. Me tatimin e vlerës së shtuar shtetet anëtare të Bashkimit Ekonomik Evropian ngarkojnë qarkullimin e të mirave materiale, patundshmëritë, shërbimet si dhe importin e prodhimeve. Ndërsa janë paraparë përjashtime, lirime dhe lehtësira për artikuj ushqimor, barna, libra, shëndetësi, kulturë, sigurim etj., si dhe shkalla zero e tatimit në eksporte, transport ndërkombëtar etj.

Qëllimet e TVSH-së janë që të ngarkohet me tatim vetëm qarkullimi i cili i shërben konsumit final. Parimisht te tatimi i vlerës së shtuar tatimohet çdo fazë e qarkullimit të mallit, mirëpo baza tatimore zvogëlohet për shumën e tatimit (tatimit të vlerës së shtuar) të zbritshëm, që do të thotë se tatimi i vlerës së shtuar nuk e ngarkon tërë bazën e faturës apo të qarkullimit, por vetëm vlerën

e shtuar (profitin). Biznesi tatimin e vlerës së shtuar e mbledh nga konsumatorët tërë muajin, kurse në muajin pasues atë pjesë të mbledhur e paguan në llogarinë e buxhetit shtetëror.

Përparësitë e TVSH-së – (Tatimi mbi vlerën e shtuar), në krahasim me çdo lloj tjetër të tatimit në qarkullim i ka disa përparësi:

1.Me tatimin e vlerës së shtuar mblidhen të hyra më të mëdha tatimore (ku shihet edhe nga tabelat e paraqitura më lartë - rasti Kosovë), të cilat shteti i arkëton në buxhet. Shuma më e madhe e arkëtimit të tatimit të vlerës së shtuar mblidhet para fazës së shitjes (sepse mblidhet ne Doganë rasti Kosovës), kjo mundëson sigurimin e mbledhjes efikase të të hyrave buxhetore.

2. Tatimi i vlerës së shtuar e zgjeron bazën tatimore dhe prodhimi përcillet dhe kontrollohet në të gjitha fazat e qarkullimit. Tatimin e vlerës së shtuar e paguan çdo furnitorë në zinxhirin prodhues – qarkullues, çdo furnitorë përveç çmimit të prodhimit ose shërbimit, blerësit të vet ia llogaritë edhe tatimin e vlerës së shtuar.

3. Metoda e zbritjes dhe mënyra e llogaritjes si dhe arkëtimit të tatimit të vlerës së shtuar bën evitimin e tatimit të dyfishtë të qarkullimit të mallrave dhe të shërbimit në të gjitha fazat e qarkullimit. Ky lloj i tatimit përfshin në vete një numër të madh të obliguesve tatimorë.

4.Tatimi i vlerës së shtuar karakterizohet me një numër më të vogël të normave tatimore dhe të normave normale tatimore, me çka prodhuesit dhe konsumatorët janë më neutral.

5.Tatimi i vlerës së shtuar me mekanizëm të veçantë ka rezultuar se e vështirëson dhe e zvogëlon evazionin tatimor, sepse përcillet dhe kontrollohet në të gjitha fazat e qarkullimit.

Te tatimi i vlerës së shtuar (TVSH) është ndërtuar mekanizmi vetëkontrollues në sistemin e tatimit për vet faktin se fatura tatimore si mekanizëm i tatimit të vlerës së shtuar i stimulon blerësit që të kërkojnë faturën e saktë nga shitësi me qëllim që ta gëzojë të drejtën e zbritjes së tatimit të paguar në blerje, me çka parandalohet mosparaqitja ose paraqitja e pasaktë e ulët e shitjeve. Me këtë lloj të tatimit (TVSH-Tatimi në Vlerën e Shtuar) kemi një sistem tatimor vetëmbikëqyrës dhe efikas, si dhe një paraqitje më të mirë të regjistrimeve në kontabilitet me çka verifikohen pagesat, te faturimi i mallit të shitur në rastin e (TVSH-së) interesi i marrjes së faturës është i dyanshëm si për blerësin ashtu edhe për shitësin.

BE – Bashkimi Evropian preferon një normë tatimore të (TVSH-së) tatimit të vlerës së shtuar prej 15% deri në 20% , kjo bazuar në vlerat aktuale të shkallës së (TVSH-së) tatimit të vlerës së shtuar në vendet Europiane apo vendet e Eurozonës.

Në Kosovë shkalla e (TVSH-së) është 16%, por ajo që e bën të dallueshëm sistemin e funksionimit të (TVSH-së) në Kosovë krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian është se në

Kosovë nuk janë të obliguara të gjitha bizneset për këtë lloj të tatimit por vetëm ato biznese të cilat arrijnë qarkullim vjetor mbi 50.000€ gjatë 12 muajve të fundit kur e mbërrin këtë limit të qarkullimit (jo viti kalendarik) ose në rastet tjera mund të jetë një biznes i regjistruar për tatimin e vlerës së shtuar nëse dëshiron në formë vullnetare.

Kjo ndarje mendoj se po i dëmton në një masë mjaft të lartë të hyrat e Kosovës, dhe po i stimulon bizneset të cilat nuk janë objekt i këtij lloj tatimi (tatimit të vlerës së shtuar), që mos të pajisen me fatura të rregullta dhe në një masë po krijojnë evazion fiskal, çka edhe bizneseve të cilat janë objekt i (TVSH-së) tatimit të vlerës së shtuar po u krijojnë probleme në shkarkimin me fatura për mallin e shitur .¹¹

3.11 Politika fiskale – Objektivat, instrumentet dhe efektet

Shpenzimet dhe taksat e shtetit ndikojnë drejtpërdrejt në performansat e përgjithshme ekonomike meqë ato përbëjnë një pjesë të madhe të aktivitetit në ekonominë kombëtare. Politika fiskale bashkë me politikën monetare janë dy komponentë themelore të politikës ekonomike shtetërore të cilat shfrytëzohen për qëllime makroekonomike: influencimin e produktit të përgjithshëm vendor, nivelin e punësimit, të ardhurën dhe nivelin e çmimeve.

Politika fiskale lidhet me veprimet e qeverisë në ndryshimin e kompozicionit të të hyrave dhe shpenzimeve publike, me qëllim të menaxhimit të kërkesës agregate për të mbajtur rritje të qëndrueshme ekonomike me punësim relativisht të lartë, pa gjenerim të inflacionit, pa rritje të borxhit publik dhe me bilanc të kënaqshëm të pagesave.

Varësisht nga ecuritë ekonomike, politika fiskale mund të jetë ekspansioniste dhe e shtrënguar. Një ekspansion fiskal do të thotë shkurtim i taksave ose rritje e shpenzimeve publike me qëllim të stimulimit të rritjes së konsumit, respektivisht rritjen e kërkesës agregate. Kjo ndodh kur qeveria vëren ngecje apo shtim të ngadalshëm ekonomik ose kur papunësia është e lartë. Kështu, me rritjen e shpenzimeve publike dhe shkurtimin e taksave, individëve dhe firmave u lihet një sasi më e madhe parash për t'i shfrytëzuar në shpenzime konsumi ose investime. Kjo ndikon drejtpërdrejt në rritjen e punësimit dhe shtimin ekonomik. Ndërsa, politika fiskale shtrënguese do të thotë ulje e shpenzimeve publike dhe rritje e taksave. Kur qeveria synon uljen e kërkesës

¹¹ Prof.Dr. Sabahudin Komoni,Financat Publike .
Universiteti i prishtinës –Fakulteti Ekonomik ,faqe116-146.Prishtinë 2008
Të dhënat në tabela janë marrur nga ATK-Administrata tatimore e Kosovës
Nëpër tekst ka nderhyrje nga autori me qëllim të pershtatjes me temën.

agregate për të ngadalësuar shtimin ekonomik apo uljen e inflacionit, përcaktohet për drejtimin e politikës fiskale shtrënguese. Nëpërmjet politikës fiskale shtrënguese ulet oferta e parasë e cila më tutje ul shpenzimet dhe kërkesën agregate. Njësoj, ulja e ofertës së parasë bënë presion edhe në ngritjen e çmimeve të gjithmbarshme në ekonomi.

Kur qeveria përcaktohet për politikën fiskale, ajo bën paraprakisht vlerësimin e një numri të madh faktorësh përfshirë dhe ecurinë e variablave dhe indikatorëve kryesorë ekonomik dhe financiar, për shkak të ndikimit të tyre në shumën e të hyrave të grumbulluara përmes taksave me të cilat përmbushen nevojat e financimit të programeve qeveritare.

Një çështje tjetër me rendësi për qeverinë është përcaktimi lidhur me deficitin buxhetor, pra a do të mbulohen shpenzimet e rritura ose të pambulluara të qeverisë me financim nga huaja apo përmes emetimit të parasë (financimi monetarë i deficitit).

Vendimet lidhur me politikat fiskale në masë të madhe varen nga konsideratat politike si, besueshmëria dhe roli që luan qeveria në ekonomi por edhe nga reagimet publike lidhur me drejtimin dhe veprimet e qeverisë. Vendimet e tilla mund të ndikohen edhe nga faktorët e jashtëm që do të thotë se qeveria duhet të marrë parasysh trendet globale ekonomike dhe politikat fiskale të vendeve tjera, të cilat mund të kenë efekt në rialokacion të kompanive vendore përmes beneficione fiskale.

3.12 Objektivat e politikës fiskale

Në procesin e formulimit të politikës fiskale, politikbërësit përcaktojnë objektivat të cilat synojnë t'i realizojnë dhe instrumentet me të cilat ato objektiva bëhen të realizueshme, duke iu përmbajtur detyrimisht principeve të menaxhimit fiskal si: **a)** transparenca lidhur me objektivat, implementimin e politikës fiskale dhe publikimin e llogarive publike; **b)** stabiliteti i procesit të bërjes së politikës fiskale; **c)** efikasiteti i ndikimit të politikës fiskale në ekonomi; **d)** përgjegjësia në menaxhimin e financave publike; **e)** efikasiteti i modelimit dhe implementimit të politikës fiskale; **f)** drejtësia (paanësia) duke përfshirë atë ndërmjet gjeneratave.

Objektivat e politikës fiskale lidhen me rritjen e mirëqenies së përgjithshme shoqërore si qëllim parësor i një shoqërie bashkëkohore. Kjo mirëqenie sigurohet vetëm në kushtet e një ambienti që e cilësojnë stabiliteti ekonomik, politik dhe social. Pra, kur flasim për objektivat e politikës fiskale kemi parasysh:

1) përmbushjen e nevojave publike përmes një sistemi të shëndoshë të financimit publik;

- 2) realizimin e punësimit të plotë;
- 3) rritjen e normës së shtimit ekonomik;
- 4) ruajtjen e stabilitetit të çmimeve;
- 5) stabilitetin e bilancit të pagesave;
- 6) përmirësimin e kushteve të punës duke përfshirë përmirësimin e strukturës kualifikuese të fuqisë punëtore dhe përparimin teknologjik;
- 7) stimulimin e kursimeve;
- 8) stimulimin e investimeve;
- 9) rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve dhe shërbimeve vendore;
- 10) rritjen e cilësisë së shërbimeve në arsim dhe shëndetësi.

Realizimi i këtyre objektivave varet nga: aftësia e qeverisë për bashkërenditjen e tyre me instrumentet fiskale për të influencuar kompozicionin dhe nivelin e kërkesës agregate; saktësia e analizave makroekonomike lidhur me trendët e indikatorëve kryesorë ekonomikë dhe financiar; rregullimi dhe marrëveshjet institucionale për koordinimin e politikave makroekonomike.

3.13 Instrumentet dhe efektet e politikës fiskale

Përmes politikës fiskale, shteti mund të ndikojë drejtpërdrejt në ekonomi. Kur ai vendos për taksat që i grumbullon, transfertat, të mirat dhe shërbimet që i blen, financimin deficitar, në fakt angazhohen në politikën fiskale. Çfarëdo ndryshimi në nivelin e këtyre instrumenteve ka efekte të drejtpërdrejta në rrjedhat e përgjithshme ekonomike.

Përmes instrumenteve të politikës fiskale ndikohet në punësim dhe nivel të çmimeve, në rishpërndarjen më të mirë të të ardhurës dhe pasurisë, në shtimin ekonomik, në rritjen e kursimit, në nivelin e investimeve, në çështjet e edukimit, arsimit, kulturës dhe shëndetësisë.

3.14 Veprimi i politikës fiskale në shtimin ekonomik

Masat e politikës fiskale mund të orientohen në përballimin e vështirësive afatshkurtra të nxitura nga rrjedhat e dëmshme në ekonomi dhe përmirësimin e tyre, respektivisht eliminimin e shkaktarëve të atyre rrjedhave dhe vendosjen e stabilitetit me masat e politikës stabilizuese. Përveç në rrjedhat afatshkurtra, politikat fiskale mund të orientohen edhe në rritjen afatgjate të BPV respektivisht të ardhurës për banor. Në këtë rast bëhet fjalë për normën e shtimit ekonomik.

Rritja ekonomike matet kryesisht me rritjen e BPV brenda një periudhe të caktuar. Kjo rritje do të thotë njëkohësisht rritje e shpenzimeve dhe të ardhurave publike, përmirësim i kushteve jetësore dhe ngritje e standardit të jetës.

Me masat e politikës ekonomike dhe të politikës fiskale tentohet arritja e një norme optimale e matur e shtimit ekonomik e jo ajo maksimale. Norma maksimale arrihet me punësim të plotë të të gjithë faktorëve të prodhimit. Por kjo do të ishte e pamundur në praktikë. Me rastin e hartimit dhe formulimit të politikës fiskale duhet marrë parasysh edhe faktorë tjerë si ruajtja e ambientit jetësor. Prandaj, nuk mund të bëhet fjalë për një punësim të plotë të të gjithë faktorëve të prodhimit në kushte ideale. Norma optimale e rritjes ekonomike do të thotë shfrytëzim i faktorëve të prodhimit duke marrë parasysh edhe faktorë tjerë me ndikim në interesat e përgjithshme shoqërore. Meqë BPV(bruto produkti vendor) rritet me rritjen e angazhimit të faktorëve të prodhimit dhe me shfrytëzim më të mirë të tyre, atëherë ndër masat e politikës fiskale në drejtim të nxitjes së shtimit ekonomik mund të numërohen ato që kanë ndikim në rritjen e produktivitetit të punës dhe shfrytëzimin më të mirë të kapitalit, në përparim teknologjik dhe shfrytëzim më të mirë të faktorëve të prodhimit, si:

- stimulimi i investimeve përmes lehtësive tatimore;
- subvencionimi i sektorëve të ndryshëm ekonomik;
- rritja e investimeve të infrastrukturës;
- nxitja dhe rritja e investimeve në kërkime, edukim dhe trajnim;
- heqja e rregullimit të tepërt i cili mund të pengojë zgjerimin e bizneseve.

Debatet publike lidhur me shtimin ekonomik përqendrohen kryesisht në masat të cilat nxisin investimet, uljen e deficitin buxhetor për të rritur kursimet në vend, rritjen e shpenzimeve publike në edukim, dhe reformimin e rregullimit shtetëror duke përfshirë rregullimin lidhur me mbrojtjen e ambientit për shkak të kostos së lartë krahasuar me dobishmërinë.

3.15 Veprimi i politikës fiskale në punësim dhe nivelin e çmimeve

Shteti dhe organet tjera publike – juridike disponojnë me një pjesë të rëndësishme të të ardhurave kombëtare. Ato paraqiten në anën e kërkesës në treg dhe drejtpërdrejt blejnë mallra dhe paguajnë për shërbimet që i shfrytëzojnë, njësoj si dhe subjektet jopublike. Nga të ardhurat publike shteti paguan pensionet, kompensimet në kohën e papunësisë, dhe ndihma të tjera sociale me të cilat ndikon në rritjen e fuqisë blerëse të atyre që i shfrytëzojnë këto pagesa. Kështu, shteti

ndikon edhe indirekt në rritjen e kërkesës në treg. Mirëpo, në rritjen e kërkesës ndikon edhe ulja e ngarkesës tatimore të tatimpaguesve, lehtësitë dhe përjashtimet tatimore. Me uljen e ngarkesës tatimore rritet fuqia blerëse e tatimpaguesve që për rezultat ka rritjen e kërkesës agregate.

Në kushtet e punësimit të plotë, rritja e kërkesës agregate nuk ndikon në rritjen e prodhimit dhe numrit të të punësuarve. Në këtë rast, rritja e kërkesës do të rezultonte me rritjen e nivelit të çmimeve. Për të penguar rritjen e nivelit të çmimeve duhet të zvogëlohet kërkesa deri në nivelin e duhur (të ofertës). Kërkesa agregate zvogëlohet me reduktimin e transfertave publike, zvogëlimin e aktiviteteve publike, rritjen e ngarkesës tatimore dhe heqjen e lehtësive dhe përjashtimeve nga tatimi. Të gjitha këto masa që ndërmerren me qëllim të zvogëlimit të shpenzimeve publike dhe rritjes së të ardhurave publike janë të njohura si masa të politikës restriktive apo kontraktive fiskale. Nëse, kërkesa agregate është më e vogël se oferta, prapë vjen deri te ndryshimi i nivelit të çmimeve, që d.m.th. çmimet ulen. Për të vendosur baraspeshën, shteti duhet t'i orientojë politikat fiskale në rritjen e kërkesës agregate përmes rritjes së shpenzimeve dhe uljes së të ardhurave publike. Në radhët e shpenzimeve shteti rrit dhënie sociale, hap vende të reja pune, rrit aktivitetin investues dhe zvogëlon barrën tatimore. Këto masa ndikojnë në rritjen e fuqisë blerëse të qytetarëve e me këtë edhe në rritjen e kërkesës së përgjithshme dhe njihen si masa të politikës ekspansive fiskale. Ndërsa, masat neutrale (konjunkturale neutrale) të politikës fiskale kanë për qëllim të ruajnë punësimin e plotë dhe nivelin e duhur të çmimeve. Në këtë rast, shpenzimet publike duhet të caktohen në atë mënyrë që kërkesa të mbetet e pandryshuar.

3.16 Veprimi i politikës fiskale në rishpërndarjen e të ardhurës dhe pasurisë.

Në rishpërndarjen e të ardhurave ndikohet edhe përmes shpenzimeve publike si instrument i politikës fiskale përmes formave të cilat shtojnë përkujdesjen më të madhe ndaj kategorive me të ardhura të ulëta. Me rastin e vlerësimit të masave, gjithherë duhet marrë parasysh ndikimi i tatimeve indirekte. Veprimet apo efektet regresive të këtyre tatimeve janë më të mëdha, sa më i madh të jetë numri i produkteve dhe shërbimeve të tatuara, sa më e madhe të jetë ngarkesa tatimore dhe sa më i vogël të jetë seleksionimi i produkteve dhe shërbimeve në qarkullim.

Në shpërndarjen më të drejtë të pasurisë ndikohet përmes këtyre masave të politikës fiskale: a) aplikimi i tatimeve në trashëgimi dhe dhurata si dhe tatimi real në pasuri; b) ofrimi i çmimeve më të ulëta të materialit ndërtimor për kategorinë me të ardhura të ulta; c) lirimi i përkohshëm

nga tatimi; d) shitja e parcelave tokësore që janë pronë e shtetit me kushte të volitshme; e) dhe masa që ndikojnë në rritjen e kursimit.

Dallimet në lartësinë e të ardhurave mund të zvogëlohen përmes: a) aplikimit të normave tatimore progresive në të ardhurat; b) lehtësive dhe përjashtimeve nga barra tatimore e tatimpaguesve me të ardhura të ulëta; c) aplikimit të tatimit diferencial në një pjesë të të ardhurave, ashtu që tatimpaguesit me të ardhura më të larta të ngarkohen me një përqindje më të madhe të tatimit.¹²

Public Economics from Econ WPA.

3.17 Efekte tjera të aplikimit të instrumenteve të politikës fiskale

Instrumentet e politikës fiskale mund të aplikohen edhe për qëllime tjera si në: fushën e politikës së edukimit, arsimimit, për qëllime demografike, kulturore, ndërtimore, shëndetësore dhe komerciale. Shteti paraqitet si punëdhënës në ndërmarrjet publike, në administratën publike, në organet e ruajtjes së rendit dhe sigurisë. Përmes politikës doganore, shteti rrit eksportin dhe zvogëlon importin, e me këtë zvogëlon deficitin në bilancin e pagesave dhe përmirëson vlerën e valutës kombëtare. Me politikën fiskale ndikohet edhe në zhvillimin regjional dhe në përmirësimin e strukturës ekonomike¹³.

3.18 POLITIKA FISKALE NË TRANZICION

Politika fiskale në vendet në tranzicion me orientim drejt reformave është modeluar sipas tri përparësive kryesore: thjeshtësimi i sistemit fiskal, krijimi i transparencës dhe procedurave të qarta dhe siguria se legjislacioni është duke u zbatuar në mënyrë të drejtë. Me kalimin e kohës, gjithashtu është bërë gjithnjë e më e qartë, se rritja e taksave me qëllimin e rritjes së të ardhurave të buxhetit mund të jetë vetëshkatërruese dhe se autoritetet publike duhet të kufizojnë

¹² www.politika-fiskale.com autor . Florije Govori .

Public Economics from Econ WPA

¹³ Mr.sc.Artan Nimani.Politikat Financiare.faqe 44 ,botues Kolegji Universitar “Biznesi”&ISRN ,me autorizim të Horizons University Paris Francë.

kontributet ndaj fondeve të sigurimeve shoqërore në mënyrë që të stimulojnë krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme .

Këto mësimë mund të vihen re brenda përpjekjeve të kuadrit të qeverive për të riorganizuar shpenzimet, në mënyrë që buxheti dhe deficitet e llogarisë rrjedhëse të mbahen nën kontroll. Në të njëjtën kohë, më shumë se disa vende në tranzicion e kanë përqafuar politikën fiskale si një mjet të mundshëm për tërheqjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja.

Gjatë viteve 1990 vendet e Evropës qendrore përdorën periudha pushimi për taksat dhe stimulime të tjera fiskale për këtë qëllim. Ndikimi që rezultoi mbi vëllimin dhe sasinë e vërshimeve të kapitalit ndihmoi që këto ekonomi të shëndrroheshin dhe përmirësonin aftësinë konkurruese të tyre.

Ndërsa byrokracia dhe korrupsioni përmenden më shpesh nga investitorët si pengesa ndaj zgjerimit të biznesit, politika fiskale (shteti) gjithashtu ka rëndësinë e saj.

Se sa e rëndësishme është politika fiskale dhe aftësia konkurruese e taksave mund të ilustruhet nga suksesi i Sllovakisë në joshjen e Hyundai për të investuar në një projekt të madh të automjeteve. Vendi konkurroi në mënyrë të ashpër me fqinjët e tij, duke kombinuar avantazhet e krahasueshme të pagave me burime financiare të jashtëzakonshme. Ky shembull mund të shihet nga dy këndvështrime. Njëri është në lidhje me pranimin e dhjetë vendeve të reja përfshirë tetë ish-vendet komuniste në Bashkimin Evropian, duket se pranimi në Bashkim i detyron vendet anëtare të gjejnë uniformitetin legjislativ. Sidoqoftë, ka sfera në të cilat prerogativat kombëtare mbeten të rëndësishme, duke rezultuar në dallime të dukshme edhe kur parimet e përgjithshme të politikës janë të njëjta. Legjislacioni i taksave është një sferë e tillë. Një këndvështrim i dytë ka lidhje me aftësinë e qeverive për të përdorur politikën fiskale në mënyrë që të inkurajojnë më shumë biznes. Disa vende të reja të sapo-pranuara në BE janë duke ulur taksat në një nivel të tillë sa që anëtarët e vjetër janë duke folur për "konkurrencë të padrejtë". Sllovakia ka vendosur një kuotë të vetme për taksën mbi të ardhurat (19 %) duke imituar modelin me të cilin vendet Baltike kanë eksperimentuar për vite. Taksat për korporatat gjithashtu janë ulur në Poloni dhe Hungari. Politikat e këtyre vendeve të Evropës Qendrore kanë krijuar reagime të ndryshme mes vendeve të vjetra anëtare të BE-së. Austria, për shembull, ka vendosur se duhet të hartojë politika të ngjashme në mënyrë që të frenojë një largim të mundshëm të kapitalit. Gjermania dhe Franca janë duke argumentuar se konkurrenca e taksave të kujton zhvlerësimet konkurruese, në të cilat kurset e shkëmbimit përdoren për të përmirësuar aftësinë konkurruese të eksporteve. Rezultati, paralajmërojnë ata, do

të jetë humbje për të gjithë. Francezët dhe gjermanët gjithashtu këmbëngulin se nuk është e drejtë që vendet, të cilat përfitojnë prej fondeve të organizimit dhe strukturimit të BE - së të praktikojnë konkurrencën e taksave ndaj donatorëve. Megjithëse politikat fiskale kombëtare paraqesin një gamë të gjerë versionesh brenda BE-së, reagimi i disa prej shteteve anëtare më të qëndrueshme nuk duhet nënvlerësuar. Sistemet e varfëruara të ndihmës shoqërore dhe pagat e larta janë duke përshpejtuar largimin e vendeve të punës jashtë vendit dhe mbylljen e vendeve të punës. Në të njëjtën kohë, mospasuria e BE-së në zbatimin e objektivave të Planit të Lisbonës, i cili synon ta bëjë Bashkimin, rajonin me aftësi konkurruese më të mirë në botë, për sa i përket ekonomisë së bazuar mbi njohuritë përforcon këtë frikë. Mund të jetë vetëm çështje kohe përpara sesa Komisioni Europian në Bruksel të merret me përcaktimin e "rregullave" që synojnë të administrojnë konkurrencën e taksave brenda Bashkimit.

Ndërkohë, kandidatët dhe ata që duan të jenë kandidatë për anëtarësimin në BE janë përfshirë në përpjekje konfliktuese të politikës. Është e qartë për Bullgarinë, Rumaninë dhe Kroacinë se ata nuk mund thjeshtë të rrinë duke parë se çfarë janë duke bërë fqinjët e tyre dhe se ata duhet të thjeshtëzojnë dhe përmirësojnë sistemet e tyre të taksave. Rumania, për shembull, duhet të pakësojë kontributet e saj për sigurimet shoqërore në një nivel shumë më të ulët. Në të njëjtën kohë, këto vende duhet të gjejnë mënyra për të mbajtur nën kontroll deficitet e buxheteve të tyre, ndërsa gjejnë të ardhura të tjera të nevojshme për financimin e projekteve të zhvillimit.

Konkurrenca për taksat paraqet si mundësi, ashtu edhe rreziqe. Taksa më të ulta mund të stimulojnë biznesin dhe, kur kushtet janë të përshtatshme, mund të rrisin të ardhurat e buxhetit. Megjithatë, nëse ulen shumë, ato mund të jenë të dëmshme ndaj të ardhurave të buxhetit dhe mund të rrezikojnë të mirat publike, të tilla si infrastruktura, arsimi dhe kujdesi shëndetësor etj.¹⁴

¹⁴ www.poltika.fiskale.com autor Kujtim SERXHANAJ
E publikuar në : Fre Human Rights Booklet, Raider Publishing, Yi Jing-Book of Changes,
KirtasBooks.com,Rare Bibles / Leaves,Rarebookreview.com.

3.19 Ndikimi i politikës fiskale në vendet e tranzicionit

Ndërtimi i politikave fiskale në shtetet me ekonomi në tranzicion

Në fillim të procesit të tranzicionit vendet ish-socialiste iu qasën një sërë reformash të domosdoshme për sendërtimin dhe funksionimin e ekonomisë së lirë të tregut.

Në kuadër të këtyre reformave apo politikave një vend kyç i takon reformave në kuadër të politikës fiskale.

Pasi që, vendet ish-socialiste kishin një strukturë tatimore të dizajnuar për ekonominë e planit, e cila ishte jocompatibile me ekonominë e tregut, si dhe një administratë tatimore që kishte nevojë për reformim dhe riorganizim të plotë, me qëllim të operimit të suksesshëm në kushte të reja.

Në mesin e ekonomistëve, ka tendenca që suksesin apo dështimin e vendeve ish — socialiste gjatë tranzicionit ta shpjegojnë me ecurinë e reformave fiskale. Vendet si Polonia, Republika çeke, Sllovenia, Hungaria, Lituania e të ngjashme, kanë qenë më të suksesshme në reformimin e sistemit tatimor dhe të Administratës Tatimore, kanë një ligjshmëri më të avancuar që u mundëson implementimin më efikas të ligjeve tatimore dhe kanë arritur një shkallë më të lartë të zhvillimit ekonomik, që përafërsisht u ofrohet vendeve të Evropës perëndimore. Vendet në tranzicion, kanë ndjekur rrugë të ndryshme në përzgjedhjen e strukturës së tatimeve dhe rëndësi që i jepet një tatimi të caktuar. Vendet me zhvillim më të avancuar dhe me Administratë Tatimore më të përgatitur, kanë përzgjedhur sistemin tatimor që i ngjan vendeve të BE-së. Kjo vjen si rezultat i përpjekjeve të këtyre vendeve që t'i plotësojnë parimet bazë të BE-së, e në këtë drejtim edhe harmonizimin e sistemit tatimor me atë të BE-së.

Në Poloni që nga qershori i vitit 1993, tatimi mbi qarkullimin është zëvendësuar me TVSH-në, ku ligji mbi TVSH-në lejon tri shkallë të tatimit: 22%, 7% dhe 0% . Mbi fitimin e ndërmarrjeve paguhet tatimi prej 40%, ku parashihen lehtësira të caktura për ato ndërmarrje, që fitimet e realizuara i rinvestojnë.

Në tatimin mbi të ardhurat personale, aplikohen tri shkallë tatimore : 21%, 33% dhe 45% varësisht nga niveli i të ardhurave vjetore të realizuara..

Poashtu, zbatohen edhe akciza të ndryshme si për karburante, pije alkoolike, duhan, armë, automobila, anije, mallra elektrike etj.

Në Republikën çeke i hasim të njëjtat tatime, ku dallojnë vetëm shkallët e tyre. Tatimi mbi fitim ka shkallën prej 35% dhe shkalla e reduktuar prej 25%, e cila aplikohet për fitimet e realizuara nga fondet investive të pensioneve dhe për të ardhurat e realizuara nga shpërndarja e fitimit. Në të ardhurat personale, varësisht nga niveli vjetor i tyre, aplikohen këto shkallë të tatimit: 15%, 20%, 25% 32% dhe 40% . TVSH-ja ka dy shkallë edhe atë 22% për mallra si dhe 5% për shërbime. Në Bullgari, tatimi në fitimin e ndërmarrjeve ka dy shkallë 27% dhe 20%, ku shkalla e reduktuar aplikohet për ato ndërmarrje që kanë fitim më të ulët se 25000 euro. Ndërsa shkalla e tatimit lokal është 10% .Tatimi në të ardhurat personale është i shkallëzuar, varësisht nga niveli vjetor i të ardhurave dhe është: 0%, 20%, 26%, 32% dhe 40%. Barrën kryesore në kontributet për sigurime sociale, e mbajnë punëdhënësit që paguajnë 34,7% të pagave, kurse punëmarrësit paguajnë vetëm 1%. Punëdhënësit poashtu paguajnë edhe 3,5% në fondin e të papunëve. Në Bullgari që nga viti 1999, aplikohet edhe TVSH-ja me shkallë unike prej 20%, përjashtim bën vetëm ari i importuar nga banka qendrore që tatimohet me shkallë prej 0% . Në Hungari, tatimi mbi fitimin e ndërmarrjeve luan një rol minor në të hyrat buxhetore, kjo mbase me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja, andaj është aplikuar shkallë relativisht e ulët prej vetëm 18% .Për të ardhurat personale aplikohen disa shkallë të tatimit, ku shkalla më e lartë është 42%. Për TVSH-në aplikohen dy shkallë, ajo standarde prej 25% si dhe shkalla tjetër për disa mallëra dhe shërbime prej 12%²¹. Në Hungari, konsiderohen të larta kontributet për sigurime sociale, shëndetësi dhe papunësi (gjithsej 54,5%). Pjesa e punëdhënësit është 43%(30% për pensione dhe shëndetësi dhe 4% për papunësi), kurse punëmarrësit paguajnë 11,5% (10% për pensione dhe shëndetësi, kurse 1,5% për papunësi). Në Kroaci, aplikohet tatimi në fitimin e ndërmarrjeve, me shkallë prej 35%.Tatimi në të ardhurat personale aplikohet në dy shkallë, atë prej 20% dhe 35% . Shkalla prej 20% fillon të aplikohet nga një shumë e caktuar e të ardhurave vjetore (rreth 2000 euro) shumë kjo, e cila është e liruar nga tatimi.

Poashtu, zbatohen edhe akciza të ndryshme si për karburante, pije alkoolike, duhan, armë, automobila, anije, mallra elektrike etj. Në Republikën çeke i hasim të njëjtat tatime, ku dallojnë vetëm shkallët e tyre. Tatimi mbi fitim ka shkallën prej 35% dhe shkalla e reduktuar prej 25%, e cila aplikohet për fitimet e realizuara nga fondet investive të pensioneve dhe për të ardhurat e realizuara nga shpërndarja e fitimit. Në të ardhurat personale, varësisht nga niveli vjetor i tyre, aplikohen këto shkallë të tatimit: 15%, 20%, 25% ,32% dhe 40% . TVSH-ja ka dy shkallë edhe atë 22% për mallra si dhe 5% për shërbime. Në Bullgari, tatimi në fitimin e ndërmarrjeve ka dy shkallë 27% dhe 20%, ku shkalla

e reduktuar aplikohet për ato ndërmarrje që kanë fitim më të ulët se 25000 euro. Ndërsa shkalla e tatimit lokal është 10%. Tatimi në të ardhurat personale është i shkallëzuar, varësisht nga niveli vjetor i të ardhurave dhe është: 0%, 20%, 26%, 32% dhe 40%. Barrën kryesore në kontributet për sigurime sociale, e mbajnë punëdhënësit që paguajnë 34,7% të pagave, kurse punëmarrësit paguajnë vetëm 1%. Punëdhënësit poashtu paguajnë edhe 3,5% në fondin e të papunëve. Në Bullgari që nga viti 1999, aplikohet edhe TVSH-ja me shkallë unike prej 20%, përjashtim bën vetëm ari i importuar nga banka qendrore që tatimohet me shkallë prej 0%. Në Hungari, tatimi mbi fitimin e ndërmarrjeve luan një rol minor në të hyrat buxhetore, kjo mbase me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja, andaj është aplikuar shkallë relativisht e ulët prej vetëm 18%. Për të ardhurat personale aplikohen disa shkallë të tatimit, ku shkalla më e lartë është 42%. Për TVSH-në aplikohen dy shkallë, ajo standarde prej 25% si dhe shkalla tjetër për disa mallra dhe shërbime prej 12%²¹. Në Hungari, konsiderohen të larta kontributet për sigurime sociale, shëndetësi dhe papunësi (gjithsej 54,5%). Pjesa e punëdhënësit është 43%(30% për pensione dhe shëndetësi dhe 4% për papunësi), kurse punëmarrësit paguajnë 11,5% (10% për pensione dhe shëndetësi, kurse 1,5% për papunësi). Në Kroaci, aplikohet tatimi në fitimin e ndërmarrjeve, me shkallë prej 35%. Tatimi në të ardhurat personale aplikohet në dy shkallë, atë prej 20% dhe 35%. Shkalla prej 20% fillon të aplikohet nga një shumë e caktuar e të ardhurave vjetore (rreth 2000 euro) shumë kjo, e cila është e liruar nga tatimi.

Gjithashtu, të ardhurat personale, përveç kësaj ngarkohen edhe me një tatim lokal, i cili varësisht nga regjioni ndryshon nga 6,25% deri në 18%. Kontributet për sigurime sociale, shëndetësi dhe papunësi përbëjnë gjithsej 41,2% dhe paguhen përgjysmë nga punëdhënësi dhe punëmarrësi. Nga viti 1998 në Kroaci, është futur edhe TVSH-ja me shkallë të vetme prej 22% me përjashtim, vetëm të disa mallrave si buka, qumështi, literatura, disa barëra, impiantet e të ngjashme për të cilat aplikohet shkalla 0%. Në Shqipëri, aplikohet tatimi në fitimin e ndërmarrjeve me shkallë prej 30%, përveç turizmit ku shkalla është 40% dhe ndërmarrjeve që eksploatojnë naftën dhe gazin të cilat paguajnë 50%. Në Shqipëri, karakteristike janë lehtësirat dhe përjashtimet e shumta për investime në sektorët produktiv. Tatimi në të ardhurat personale është i shkallëzuar varësisht nga niveli vjetor i të ardhurave dhe ndryshon nga 0%, 5%, 10%, 15% dhe 20%.

Kontributet për sigurime sociale dhe shëndetësi paguhen si nga punëdhënësi (32,5% dhe 1,7%), ashtu edhe nga punëmarrësi (10% dhe 1,7%).

3.20 Tranzicioni në Ballkan dhe stabiliteti i tij ekonomik

Ballkani është një bashkësi komplekse popujsh, etnike, kulturash e traditash, e ekonomive e këmbimeve, të përbashkëta e ndryshime deri rrënjësore, në marrëdhënie fqinjësie miqësore e kundërshti deri në urrejtje absurde, ndërmjet tyre. Këto rrrethana e bëjnë të domosdoshme njohjen më të mirë të historisë, zakoneve dhe mentalitetit të popujve të Ballkanit nga ana e atyre që i ndihmojnë apo ndërmjetësojnë, nga ata që i këshillojnë, në qoftë se duan përparimin dhe stabilitetin në rajon. Në të kundërt, "fuqia e barutit" do të vazhdojë të mbetet e tillë dhe që vetëm rastësisht mund të mos ndizet.

3.21 Tranzicioni në Kosovë

Duke u nisur nga konfiguracioni i ri i rrethinës ekonomike, rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe i kushteve specifike, ndërtimi i sistemit ekonomik të Kosovës duhet të mbështetet në:

1. Privatizim dhe ndërmarrësi;
2. Liberalizim ekonomik;
3. Rregullim ekonomik sipas konceptit të ekonomisë së hapur dhe të tregut,
4. Parimeve të shtetit ligjor;
5. Drejtësi sociale;
6. Në trendet e globalizimit të ekonomisë.

Kosova, si një vend i vogël dhe ballkanik, duhet të orientohet për ndërtimin e sistemit të ekonomisë sipas kërkesave të një ekonomie të hapur ndaj tregut evropian dhe botëror, politikë të matur, rregullative dhe liberalizim ekonomik. Ky duhet të jetë sistem ekonomik që krijon një ambient të përshtatshëm për integrimin e ekonomisë së Kosovës në rajon e më gjërë, stimulimin e bashkëpunimit ekonomik dhe që nxit investimet e përbashkëta me partnerët e jashtëm.

Lidhur me këtë nevojitet strategjia e përkufizuar qartë e transformimit të pronës shtetërore (shoqërore) në pronë private dhe për zhvillimin e ndërmarrësisë si filozofi zhvillimore me tërë infrastrukturën e saj të nevojshme. Kjo mundëson krijimin e një ambienti të volitshëm për zhvillimin e konkurrencës dhe të autonomisë së ndërmarrjeve, duke përfshirë kategorinë e rrezikut.

Kjo kërkon ndërtimin e tregut integral (tregu i mallrave dhe shërbimeve, tregu i punës dhe tregu financiar), me gjithë institucionet e tij.

Roli i shtetit duhet të përqëndrohet në rregullimin bashkëkohor makro-ekonomik që siguron stabilitet ekonomik dhe sendërtim të politikës zhvillimore. Këtu përfshihet: stabilizimi i valutës nacionale, kursi

devizor, rregullimi i marrëdhënieve ekonomike me botën e jashtme, sendërtimi i politikës regjionale, sendërtimi i politikës agrare, asaj ekologjike dhe financat publike. Shteti duhet t'i marrë mbi vete edhe funksionet e domosdoshme sociale, me qëllim që më lehtë të tejkalohen pasojat negative në fazën e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut. Sistemi ekonomik funksionimin e vet duhet ta mbështesë në institucionet demokratike, demokracinë liberale e shoqërinë e hapur, si dhe në internacionalizimin e ekonomisë dhe të shoqërisë kosovare. Tranzicioni është proces transformues i përmasave të thella të një sistemi shoqëror, nëpërmjet të cilit ky sistem kalon në një strukturë të re, e cila siguron një efikasitet dhe efektivitet më të lartë.

Për të arritur këto performanca, duhet sendërtuar ndryshime stimulante në të gjitha nënsistemet e sistemit shoqëror, e para së gjithash në sistemin politik, në sistemin ekonomik dhe në sistemin arsimor. Tranzicioni nuk mund të jetë proces që qeveriset nga rasti në rast, aq më pak në mënyrë stihie. Kjo do të thotë se nevojitet ndërtimi i strategjisë së tranzicionit, i cili në vete përmban qëllimet e shtruar qartë, pengesat në të cilat mund të ndeshë realizimi i këtyre qëllimeve dhe resurset e mekanizmat me të cilat duhet tejkaluar këto pengesa .

Mendimet e ekspertëve të ekonomisë në Kosovë, mbi specifikat e tranzicionit në Kosovë;

1. Situatën politike: pushteti i instaluar okupues dhe lëvizja e degëzuar dhe e masivizuar për liri;
2. Strukturën ekonomike të pavolitshme, me ndërmarrje shtetërore të okupuara, ruanim dhe prapambetje teknologjike, dhe dëmtim të infrastrukturës ekonomike që përmbledhen me një veprim tipik kolonial;
3. Nivelin e zhvillimit dhe problemet e theksuara sociale;
4. Iniciativën private relativisht të zhvilluar, por që nën presion të rrethinës në të cilën vepron, përjeton krizë konceptore dhe stagnim në zhvillimin e saj;
5. Diasporën mjaft të madhe dhe me peshë ekonomike e socio-demografike;
6. Nevojën e theksuar për asistencë teknike.

Tranzicioni në Kosovë ka filluar në fund të viteve 80-ta, gjegjësisht me lëvizjen për liri dhe demokraci, që ishte një lëvizje që pretendon ta çojë Kosovën në kalimin nga një sistem në një sistem tjetër, jo vetëm ekonomik por edhe të përgatitë terrenin për një tranzicion në të gjitha

sferat, me iniciativën relativisht të zhvilluar private, me disa transformime në procesin e arsimimit, me disa ndryshime në media, si dhe me aktivizimin e një numri organizmesh qeveritar dhe joqeveritar.

Prandaj, brendapërbrenda rrethanave që mbizotëronin në kohë të "pamundshme", në Kosovë lindin dhe zhvillohen segmente të shoqërisë së hapur dhe ky është një segment i rezistencës aktive, (që pretendohet asokohe) i përpjekjeve për liri. Kuptohet që ky nuk është një proces kompleks çfarë do të ishte në kushte normale.

Struktura e pavolitshme ekonomike, përpos në aspektin e veprimtarive (industria bazike e energjetika), shprehet me pjesëmarrjen e vogël të ndërmarrjeve të vogla dhe ndërmarrjeve të mesme. Karakteristikë tjetër është edhe prapambetja teknologjike e cila është pasojë e ndërprerjes së ciklit investues, e një procesi të gjatë dezinvestimi (amortizimi tejkalon investimet në fondet fikse të sektorit shoqëror që prej vitit 1990 e këndej).

Afërsisht 30% e popullsisë së Kosovës gjenden në Evropën Perëndimore dhe SHBA, pjesa dërmuese pa status të rregulluar, mirëpo ishin një shtyllë e fortë e mbijetesës dhe si shkëndijë në proceset e pasluftës. Lidhjet e kësaj pjese të emigracionit me vendlindjen janë të forta dhe të përhershme. Kapitali i kësaj pjese të popullatës mund të angazhohet në forma të ndryshme dhe mund të krijohen ura ndërlidhëse bashkëpunimi me vendet ku ata jetojnë, për të krijuar kushte për riintegrimin e tyre apo kthimin në atdhe bashkë me kapitalin e akumuluar. Ky veprim do të jetë një injeksion për ekonominë e Kosovës në këtë fazë tranzitore ku gjindemi tani. Kosova ka shtrirje në qendër të Gadishullit Ballkanik, nuk ka dalje në det. Kosova kufizohet me Serbinë në veri dhe lindje, Maqedoninë në jug, Shqipërinë në jugperëndim dhe Malin e Zi në veriperëndim. Sipërfaqja e Kosovës është 10.907 km², me rreth 2 milion banorë. Klima në Kosovë është e mesme kontinentale me vera të nxehta dhe dimëra të ftohtë. Kosova është e populluar dendur me rreth 175 persona për km² dhe e ndarë në 30 komuna.¹⁵

¹⁵ Artan Nimani, Menaxhimi i financave publike Prishtinë 2007, Servet Pellumbi Analize Tirane .
Prof.Dr.Selman Selmanaj, Riinvest, Globalizimi dhe tranzicioni, Prishtinë 2006.

KAPITULLI IV

MENAXHIMI I POLITIKAVE FISKALE DHE ZHVILLIMI

EKONOMIKË

4.1 Metodologjia e kërkimit - i cili është përdorur në këtë punim të diplomës së doktoraturës është shfrytëzimi i kuadrit teorik në funksion të studimit empirik, duke bërë krahasimin e ideve të ndryshme prej literaturës së përdorur, pyetësorët, intervistat, arkivat e ndryshme, praktikat e vendeve, shteteve të ndryshme në kohën e tranzicionit dhe të zhvillimit ekonomik, se si kanë menaxhuar me politikat fiskale, çfarë orientimi kanë përdorur për zhvillimin ekonomik të vendit? etj.¹⁶ Qëllimi i studimit është që të eksplorohej praktikat e menaxhimit të politikave fiskale kështu që natyra e pyetjeve që ngrihen janë: sa jeni të kënaqur me menaxhimin e politikave fiskale? - Shumë, mesatarisht, pak dhe aspak.

Rastet e studimit janë metoda e preferuar është përmes pyetësorëve dhe intervistave si dhe organizimi i tryezave të rrumbullakëta. Plani i këtij studimi është gjithashtu që të arrihet një tablo e përgjithshme e praktikave të menaxhimit të politikave fiskale në nivele të ndryshme të sektorit privat dhe publik dhe të identifikohen faktorët që ndikojnë në praktikat e menaxhimit.¹⁷

Të dhënat e grumbulluara nga intervistat në këtë metodë analizohen duke përdorur teknikën e analizës së përmbajtjes. Analiza e përmbajtjes konsiderohet si një ekzaminim i kujdesshëm, i detajuar dhe sistematik në përpjekjen për të identifikuar modelet, temat, mjetet. Kështu ky studim ka adaptuar teknikën e analizës së përmbajtjes për të analizuar të dhënat e rastit të studimit.¹⁸

Gjatë krijimit të pyetësorëve dhe intervistave kam shfletuar literaturë të ndryshme në mënyrë që të krijojë pyetësorin dhe intervistën sa më të mirë dhe profesionale duke u perputhur me kriteret e kerkuara.


¹⁶ "STRUCTURED METHODS: INTERVIEWS, QUESTIONNAIRES AND OBSERVATION" Constantinos N. Phellas, Alice Bloch and Clive Seale

¹⁷ "A general introduction to the design of questionnaires for survey research" AUTHOR: Dr Thomas F Burgess May 2001 EDITION: 1.1

¹⁸ "A Step-by-Step Guide to Developing Effective Questionnaires and Survey Procedures for Program Evaluation & Research" Rutgers Cooperative Research & Extension, NJAES, Rutgers, The State University of New Jersey.


4.2 Rezultati i pyetësorit (Paraqitja Grafike)

Pyetësi është krijuar për të hulumtuar tregun intelektual në disa institucione publike, biznese private, si dhe qytetar të rëndomtë sesa janë të kenaqur me ndodhitë deri më sot në zhvillimin ekonomik dhe qfarë presin ata në një të ardhme të shkurtër (formën e ndërtimit të intervistës dhe pyetësorit e gjeni në fund të **shtojcës**). Në pyetjet në lidhje me zhvillimin ekonomik jemi munduar të prekim nga pak të gjitha temat që kanë të bëjnë me të si; politikën fiskale, menaxhimi i të hyrave publike, roli i disa misionëve ndërkombëtarë, si do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik liberalizimit i vizave, privatizimi i ndërmarrjeve publike përmes AKP, etj. Ky anketim ka zgjedhur institucionet publike, bizneset private dhe qytetarët për arsye sepse të gjitha shtresat në një formë apo një tjetër preken nga politikat fiskale të cilat i ndërtonte Qeveria (Shteti).




Sa i përket referimit mbi rezultatin e shumicës mund të themi që shumica janë të kenaqur me menaxhimin e të hyrave publike në Kosovë.

Sa mendoni se kan ndihmuar ne menaxhimin e te hyrave publike misionet nderkombetare si BE,(Roli I OSBE-se, Roli I misionit EULEX) ne ndertimin e Kosoves pas pavaresis?




Verehet se misionet nderkombetare ne Kosove kan kenaqur shumicen dhe jane mirepritur roli I tyre ne vend.

A mendoni se ne Ksove duhet te ndryshojne Politikat fiskale,duke ju pershtatur komplet vendeve te BE-se?




Qytetaret e kosoves jane te vetedijshem se rruga drejt zhvillimit eshte ajo per te ndjekur hapat drejt BE.

Sa e vleresoni zhvillimin ekonomik te Kosoves pas Pavaresise?




Verehet se Shqiptaret e Kosoves kane pritur shume me shume ne zhvillimin ekonomik pas pavarsis dhe vrehet se jane te zhgjenyer.

Ne cilat fusha mendoni se duhet te korigjohen Politikat Fiskale ne Kosove!




Qytetaret mendojne se korigjimet duhen te behen ne politikat fiskale dhe dogana, sa kane te drejt mbetet te shihet ne te ardhmen.

Njerez te ndryshem kane mendime te ndryshme per ritmet me te cilat po ecen procesi I zhvillimit ekonomik te Kosoves. Sipas mendimit tuaj si po ecen ky proces?




Nje numer i madh i popullsis jan optimist dhe presin qe procesi te ecen me shpejt.

Sa kohe mendoni se I duhet Kosoves per ti arritur standaret ekonomike te vendeve si Sllovenia dhe Kroacia kundrejt BE-se (me te cilat ne nje kohe jo shume te larget kane qene ne nje shtet te perbashket ish-Jugosllavia)?




Edhe ketu qytetaret jane pak pesimist sepse afati ju duket shume i afert.

Per te ecur rruges se vendeve te cilat e kane kaluar tranzicionin, cilat veprime duhen ndemarrur me shpejtesi?




Verehet se pakenaqsia me e madhe eshte te forcimi dhe repsektimi i nje shteti ligjor.

Vendet perendimore (BE-ja) tani e sa kohe me pare kane eliminuar kontrollet e mallrave neper pikat doganore kane nje treg te lire global duke e rritur konkurencen dhe njekohesisht cilesine e produkteve, a mendoni se ekonomia e Kosoves mundet ta perballoj




Gjysma e buxhetit vjen nga dogana dhe kosovaret jane te vetedijshem qe kjo do te jete e veshtire.

Cilat nga veprimet e meposhtme mendoni se do te ndikojne ne rritjen e punesimit ne Kosove , duke u nisur nga gjendja ekonomike e cila eshte tani per tani?




Nje numer i madhe mendon se korrupsioni, krimi po e pakeson punesimin.


A jeni pro apo kunder globalizimit te ekonomise ne Kosove?



Nje numer i madh i qytetareve e dine qe globalizimi eshte i domosdoshem dhe jane pro ketij hapi.




Kosovaret kan qene optimist se liberalizimi do te behet qe nga 2014 por ky proces nuk eshte realizuar ende.




Siq duket qytetatren jane te zhgenjyer nga mos shfrytezimi i gjithe ketij resursi ne menyre te drejt.

Duke u nisur nga qellimi per terheqje te investimeve te huaja ne kosove e te cilat ndikojne ne zhvillimin ekonomik dhe punesim cilat mendosi se jane perparesite qe duhet I potencojm para faktorit nderkombetar?




Veqse jemi te vetedijeshem qe popullsia e re eshte prioritet i yni.


Sa besoni qe nese nje ndermarrje nderkombetare vjen per te investuar ne Kosove (psh. Kompani LG e cila merret me prodhim te televizoreve, Radiove aparatave te ndryshem etj) do te gjej menaxher vendor te gatshem per udheheqje profesionale si dhe punetore m




Kemi nje rini te shkolluar qe eshte e pregaditur per tregun.



Me kete proces pothuajse te gjithë jane te zhgenjyer.



Shtrierja ligjore eshte rreziku kryesor, i cili reflekton mosqendrueshmeri dhe pasiguri te madhe.



KOMENTI

Ne baze te rezultatit te dhene nga pyetesori arrim te kuptojme se te anketuarit jane nën mesatare te kenaqur me politikat fiskale e zhvillimin ekonomik te Kosoves gjate kesaj periudhe. Kjo arsyetohet per shkak sevetem 24.71% janë shum te kenaqur e optimins per gjerat qe priten te ndodhin ne te ardhmen.

Kurse 39.79% jane mesatarisht te kenaqur qe dmth se janë skeptik, 22.17 % janë pakë te kenaqur dhe 13.31% nuk janë aspak te kenaqur apo pesemist te thellë.

Ne nje ndarje ne vija te trasha mund te themi se 24.71% janë te kënaqur me politikat fiskale kurse 75.29 janë te pakenaqur me politika fiskale.

Hipoteza qendron.

4.3 Sfidat e tranzicionit-

Ballkani Perëndimor po ecën nëpër një tranzicion të stërzgjatur të shumfishuar e të stërngarkuar në rrugën e tij reformuese drejt stabilitetit ekonomik, politik dhe nga ana tjetër nga mungesa e një stabiliteti juridik që e sjell edhe stabilitetin ekonomik. Ky është një realitet që na ofrohet me mundësi që të përmirësohet, por asnjëherë që të mund të largohet pa u ballafaquar drejtpërdrejt me të.

Ballkani Perëndimor pothuajse tash e dy dekada po atakohet me këtë realitet të kalueshëm, por për disa shtete pothuajse më se të sfidueshëm nga ky tranzicion.

Shtetet e Ballkanit perëndimor aktualisht janë në një horizont të njëjtë në këtë rrugëtim, ku në të gjitha shtetet ecuria dhe sfidat janë të njëpasnjëshme në sektoret e njëjtë si në atë ekonomik, juridik dhe politik, ku të gjithë bëjnë përpjekje për të dalë nga ky izolim tranzitiv drejt një drite stabilizuese ekonomike.

Kosova tani më ka një interes, në fillimet e një stabiliteti ekonomik, mirëpo me një fillim të mbarë ekonomik, me një vizion dhe interes të ofruar nga BE-ja, dhe me shumë mësim të marra nga shtetet fqinje, që po kalojnë dhe kanë kalur fazat e këtilla ekonomike, ndaj ne duhet të jemi sa më vigjilent në adaptimin dhe përkushtimin e bërjes së ekonomive më të mira me përvojat e shteteve ballkanike e evropiane, *nevojitet* një kohezion më i qartë dhe bërja e disa politikave afatmesme dhe afatgjata në rrugëtimin ekonomik në interes të Kosovës.

4.4 Rëndësia e teorive të ndërmarrjes në praktikën e strukturës së politikës afariste

Teoria e ndërmarrjes mundëson të definojnë konceptet themelore të ndërmarrjes dhe qëllimet e saj.¹⁾

Kuptimi i ndërmarrjeve orientohet në shpjegimin e alokimit të faktorëve kufizues, ku në hulumtime, përveç këmbimit dhe konsumit, përfshihet edhe prodhimi si faza më e rëndësishme e riprodhimit ekonomik. Dihet se, ndërmarrja përfshin vetëm një segment në studimin e analizës së ekuilibrit të përgjithshëm ekonomik dhe në këtë mënyrë ndërmarrja paraqitet si objekt specifik i studimit në teorinë e ndërmarrjes e sidomos të ndërmarrjeve industriale.

Teoria e ndërmarrjes e trajton atë si “boks të zi” (kuti e zezë), brendia e së cilës është e pa përpunuar deri në fund në teorinë e ndërmarrjes, si teori e ekuilibrit të përgjithshëm.

Në teori ky “boks i zi” është shtjelluar deri në shkallë të shpjegimeve marginale mbi teorinë e ekuilibrit të përgjithshëm, duke u bazuar në shpjegime shkencore dhe praktike dhe duke u bazuar në ekuilibrin specifik të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha deri te kompanitë shumëkombëshe.

Ky rol i pazëvendësueshëm shihet në zhvillimin e ndërmarrjes si teori e menaxhmentit shkencor (organizimit të organizatës) prej ditëve të para në fund të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX e deri te teoritë bashkëkohore të menaxhmentit dhe menaxhimit të ndërmarrjes në ditët e sotme.

Teoria mbi të drejtën e pronës, shfrytëzimit të resurseve materiale, financiare dhe humane dhe e drejta mbi përfitimet nga këto të drejta, ajo ka hapur perspektivën e zhvillimit, mbijetesës dhe arritjes së qëllimeve parësore të ndërmarrjes. Në këtë drejtim “Teoria mbi menaxhmentin” (organizimin e organizatës) ka luajtur rol historik në këtë drejtim.

Ndërmarrja, në kuptimin e saj të plotë, paraqitet dhe zhvillohet prej organizimit të parë ekonomik të mesjetës, ku vend dominant kanë zënë ndërmarrjet bujqësore e deri te ndërmarrja e re në zhvillimin e ekonomisë së tregut, e quajtur si ekonomi kapitali (kapitaliste). Akumulimet e para të kapitalit, e sidomos kapitalit tregtar, kanë luajtur rol vendimtar në paraqitjen e prodhimit zejtar, manifakturës, fabrikës e deri te komplekset e mëdha industriale të njohura si periudha e revolucionit industrial, postindustrial, revolucionit teknologjik e deri në ditët e sotme të njohura si revolucion informativ dhe proces globalizues i ekonomisë botërore.

Përcaktimet e financimit të aktiviteteve të tilla ekonomike, përderisa mallrat e plasuara në treg nuk janë shitur, u ka kufizuar zejtarëve dhe prodhimit manifaktural që të prodhojnë kryesisht vetëm sipas porosisë dhe me paraqitjen e kapitalit financiar, këtyre u mundësohet që ta zgjasin “dorën” dhe të participojnë edhe në fushën e kërkesës së blerësve dhe konsumatorëve.

Me zhvillimin e fazës së revolucionit industrial që e ka mundësuar zhvillimi shkencor-teknik-teknologjik, pronarët e kapitalit financiar ia fillojnë një pjese të madhe të kapitalit të tyre ta bartin edhe në investime në fabrika industriale, duke mundësuar edhe punësimin e një numri të madh punëtorësh. Këta pronarë të kapitalit financiar bëhen ndërmarrës, pronarë të ndërmarrjeve. Zhvillimi i mendimit ekonomik dhe të ekonomisë, këtë kategori e merr si referencë duke u lidhur me të ashtuquajturën “boksi i zi”, që në vete përfshin paragrupimin e të gjitha segmenteve të aktiviteteve të përbashkëta dhe të veçanta në ndërmarrje.

Kjo bëhet për dy arsye: sepse askush nuk dëshiron të futet deri në fund të “boksit të zi”, ose për arsye të ndërlikueshmërisë që kjo materie ngërthen në vete. Përpunimi i kësaj tërësie të

ndërlikuar me të gjitha elementet përfshirëse, është studiuar kryesisht në elementet e matshme. Analizat e tilla shfrytëzohen në modelet e ekuilibrit të përgjithshëm dhe të pjesërishëm në makro dhe mikroekonomi, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me teoricientët e menaxhimit të industrisë. Ata e konsiderojnë ndërmarrjen si një njësi organizative, socio-ekonomike, tekniko-teknologjike, juridike dhe subjekt të veçantë me përgjegjësi edhe shoqërore (sociale).

Pronarët e ndërmarrjeve i kanë të drejtat e pacenueshme, të cilat i vërteton teoria dhe praktika e ndërmarrjes, si është e drejta mbi pronën e resurseve materiale (fizike) dhe financiare. Ata i vënë në dispozicion (deponojnë-investojnë) këto resurse të vetat dhe me marrëdhënien kontraktuese edhe me fuqinë punëtore, krijojnë në ndërmarrje shpenzime implicite, të cilat i japin të drejtën pronarëve të kapitalit, realizimin e të ardhurave të ndërmarrjes (pronarëve), që në esencë do të thotë e drejta në profit.

Ndërmarrja, aktivitetin e vet ekonomik –juridik e bën përmes kontratave, në mënyrë që ajo t'i realizojë të drejtat dhe obligimet e veta ndaj personave të tretë juridik dhe fizik dhe shtetit. (Në ekonominë e SHBA-ve është një thënie e vjetër, sa edhe ekonomia e tregut në Amerikë, do me thënë 300 vjeçare: “Edhe në qoftë se vëlla e ke, në biznes mos fillo me të, në qoftë se nuk është i gatshëm të nënshkruajë kontratë”).

Ndërmarrjet prodhuese lidhin kontrata me pronarët e resurseve që i vihen në dispozicion për shfrytëzim. Si shitës lidhet kontrata me ndërmarrje tregtare, distributive ose agent për shitje të produkteve të veta në formë malli në treg. Me kontrata nuk fitohet e drejta vetëm në shitblerje por është e drejta e përdorimit të elementeve të këmbÿera për kohë të caktuar. Kështu ndërmarrja e cila punëson punëtorët në marrëdhënie kontraktuese e ka të drejtën që ata t'i caktojë në detyra gjegjëse për kohë të caktuar.¹⁹

¹⁹ Prof. dr. D. Gorupic dhe D. Gorupic junior, Poslovna politika u poduzecu, Informator Zagreb 1988, fq. 54, 55 dhe 66

4.5 Objektivat dhe politikat makroekonomike

Nëpërmjet politikave ekonomike të përshtatura, qeveritë e vendeve demokratike synojnë të arrijnë, sidomos katër objektiva të rëndësishme makroekonomike:

1. Të sigurojnë ritme të larta e të qëndrueshme të "rritjes ekonomike", duke krijuar produkte kombëtare, sa më pranë kufirit të mundësive prodhuese, dhe sa më të harmonizuara e të balancuara me zhvillimet demografike e rajonale.

2. Të minimizojnë papunësinë, duke angazhuar në punë, sa më shumë njerëz që duan të punojnë, kundrejt niveleve më të larta të mundshme të pagës.

3. Të sigurojnë një stabilitet të qenësishëm çmimesh, duke toleruar vetëm disa luhatje xhentile të tyre, që kushtëzohen nga tregjet konkurrenciale, por pa i hapur rrugën valëve të fuqishme inflacioniste.

4. T' i zgjerojnë dhe t' i forcojnë lidhjet ekonomike ndërkombëtare duke i mbështetur në kurse këmbimi të stabilizuara, dhe në eksporte sa më kompetitive dhe të balancuara me importet.

Rrugët dhe mjetet kryesore që përdoren për arritjen e këtyre objektivave, mishërohen tek disa instrumente të larmishme politike, të cilat hartohen zakonisht, duke u mbështetur në teoritë dhe në doktrinat ekonomike më të përshtatshme me kushtet konkrete të çdo vendi, dhe zbatohen duke vënë në veprim, disa variabla dhe komponente ekonomike të veçanta, të cilat janë në vartësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të qeverisë. Teoritë kryesore ekonomike, mbi të cilat mbështetet hartimi dhe jetësimi i instrumenteve më të rëndësishme politike, janë teoritë klasike e neoklasike dhe shkollat ekonomike kejniane e neokejniane.

Gjatë shekullit të XIX-të dhe në dekadat e para të shekullit të XX-të, mendimi shkencor ekonomik, u sundua nga pikëpamjet klasike e neoklasike të Adam Smithit, David Rikardos, Georg Lukasit, etj.

Sipas këtyre pikëpamjeve, ekuilibri i përgjithshëm ekonomik, që karakterizohet nga përdorimi i plotë i burimeve, konsiderohet rezultat i nënkuptuar, i ekuilibrit të tregjeve të veçanta, dhe sigurohet nga veprimi spontan i mekanizmit të tregut.

Kurse çekuilibrimi dhe mospërdorimet e plota të burimeve, ekonomike mund të kapërcehen sipas tyre, pa vështiresi, nga vet mekanizmat përshtatës të tregut.

Por eksperiencia e gjysmës së parë të shekullit të XX-të, dhe sidomos depresioni i madh i viteve 1929-33, dëshmuar kundër pikëpamjeve klasike, dhe i hapën rrugën një shkollë të re të mendimit makroekonomik, që u quajt shkolla Kejnsiane.

Në veprën madhore "Teoria e punënxënies, interesi dhe paraja", që u publikua në vitin 1936, Kejnsi e shpalli papunësinë, si një nga sëmundjet kryesore të sistemit kapitalist, dhe bëri thirrje për të hartuar e zbatuar politika qeveritare efikase, që stimulojnë kërkesën agregate, sepse: ekuilibrimi i ekonomisë kombëtare sipas tij, mund të arrihet edhe në kushtet e mospërdorimit masiv të burimeve.

Teoritë dhe rekomandimet Kejnsiane, sunduan mendimin ekonomik për afro gjysmë shekulli, dhe u vunë në themel të politikave makroekonomike të shumë qeverive të vendeve perëndimore, gjatë tri dekadave pas Luftes së Dytë Botërore.

Por, kur ekonomia botërore u godit nga kriza e naftës e viteve 1974-75, dhe nga recensionet pasuese të viteve 1980-82, mendimi ekonomik kejnsian, e kishte të vështirë shpjegimin e këtyre situatave, ku bashkekzistonin, nivelet e larta të papunësisë, me normat dyshifrore të inflacionit, sepse në skemat teorike Kejnsiane, nuk parashikoheshin gjendje të tilla ekonomike.

Në këto kushte, u rigjallërua në mënyrë të përshtatur me situatat e reja, mendimi ekonomik neoklasik, në të cilin bashkërendoheshin me rrymën e monetarisë të Milton Fridmanit, shkolla e pritjeve racionale të Lukasit, dhe shkolla të tjera të anës së ofertës, të cilat rriteshnin aftësitë vetëpërshtatëse të tregjeve, dhe qëndrimin negativ ndaj ndërhyrjes së shtetit në ekonomi.

Këto rryma, vazhdojnë të kenë edhe sot, ndikim të konsiderueshëm në mendimin shkencor makroekonomik. Por bashkë me to vazhdon të ndikojë gjithashtu, edhe mendimi ekonomik neokejnsian, i cili u fuqizua që në gjysmën e parë të viteve 1980 dhe vazhdon të këmbëngul në idenë se: dështimet ekonomike dhe mospërdorimet masive të burimeve, janë të mundshme edhe në kushtet e ekuilibrit makroekonomik, prandaj duhet medoemos, ndërhyrja e shtetit në ekonomi.

Duke u mbështetur në modelet teorike neokejnsiane e neoklasike, dhe në treguesit ekonomikë me karakter përgjithësues, politikëbërësit e çdo vendi, përpiqen të hartojnë e të zbatojnë politika të përshtatshme, për të realizuar me ndihmën e tyre, synimet dhe objektivat më kryesore të rrafshit makroekonomik.

"Politikat ekonomike" më të rëndësishme, që i shërbejnë këtij qëllimi, janë:

1-Politikat monetare, që kanë të bëjnë kryesisht me kontrollin e ofertës së parave dhe me rregullimin e qarkullimit monetar nga Banka Qendrore.

2-Politikat fiskale, që kanë të bëjnë sidomos me tatimet dhe taksat e ndryshme dhe me shpenzimet qeveritare, të cilat ndikojnë direkt, jo vetëm në përmasat e produktit të përgjithshëm kombëtar, por edhe në nivelin jetik të qytetarëve.

3-Politikat e të ardhurave, që mbikqyrin nivelet e pagave dhe të çmimeve, për t'i minimizuar efektet negative të inflacionit.

4-Politikat e jashtme ekonomike, që kanë të bëjnë kryesisht, me levizjet e mallrave dhe të kapitaleve jashtë kufijve kombëtarë, dhe me administrimin eficient të kurseve valutore të këmbimit etj.²⁰

4.6 Financat dhe strategjia korporative

Udhëheqësit të cilët nuk merren me Financa ose Kontabilitet mendojnë se zgjidhja më e mirë është angazhimi i ekspertëve për këtë lëmi.

Rezultati është se ndonjëherë lëshohen shumë pjesë të vendimmarjes punuese ekspertëve për financa. Financat janë tepër të rëndësishme që të gjitha vendimet t'i lëshohen drejtorave financiar. Kur menaxheri nuk kupton në tërësi atë çka numrat konkretisht paraqesin dhe cilët janë parametrat për analizat konkrete, me siguri do të sjellë vendime të gabuara. Në të njëjtën mënyrë edhe ekspertët financiar të cilët nuk e kuptojnë problematikën udhëheqëse mund ta kufizojnë përdorimin e dijes së vet (ekspertizës), sepse nuk do ta kenë në total të qartë se çka prej tyre kërkohet, me siguri nuk do të jetë në gjendje të ofrojë informatat e nevojshme për aspektet e punës së subjektit .

Shkëmbimit të pamjaftueshëm të informatave i shkon edhe fakti që menaxherët financiar përjetohen edhe si persona të cilët janë të preokupuar me numra, të paaftë për ta kuptuar problematikën e strategjisë në vendimmarje.

Për fat të keq, nuk është e pazakontë të dëgjohet deklarata si: edhe pse numrat tregojnë diçka tjetër , ne kemi vendosur që ta vazhdojmë projektin për arsye strategjike, çka tregon se financat dhe strategjia janë të pavarura njëra nga tjetra.

²⁰Prof.As.Dr.Niko Ketri, Ekonomia Politike, tekst mësimor për studentë e shkencave politike & juridike faqe 179-181, Botues Ufo pres, Tiranë 2008.

Marrëdhëniet e ndërsjella që menaxherët kanë me financat shpeshherë rezultojnë me vendime që ju ulët vlera. p.sh. është shumë e njohur se marrja e kompanive tjera nuk e rrit vlerën për aksionar, arsyeja kryesore është çmimi tepër i lartë që paguhet . Kjo situatë mundet lehtë të tejkalohet, nëse drejtori mundet në të njëjtën kohë ta kuptojë potencialin e krijimit të vlerës gjatë marrjes dhe kuantifikimit të vlerës. Këtu flasim për problemet gjatë arritjeve dhe se si të tejkalohen, në të njëjtën kohë sqarimin si të vlerësohet ndërmarrja tjetër që t'i shmangemi pagesës së çmimit tepër të lartë.

Situata tjetër e uljes së vlerës është kontrolla e keqe e drejtorëve financiar.

Drejtorët ekzekutiv të ndërmarrjes zakonisht për shkak të dijes së kufizuar ose injorimit të drejtpërdrejtë nuk i kontrollojnë drejtorët financiar të cilët, duke udhëhequr me rreziqet e ndërmarrjes, hyjnë në investime spekulative, e nganjëherë punët e tyre kufizohen edhe me aktivitete kriminale. Për drejtorët ekzekutiv është e rëndësishme ta kuptojnë taktikën e udhëheqjes me rreziqe dhe potenciale të tyre për krijimin e vlerës, që të ishte e mjaftueshme të bëjnë politikën e udhëheqjes me rreziqe dhe t'u vendosin kufizime drejtorëve financiar.

Me qëllim të ruajtjes së ndërmarrjes dhe afarizmit të saj.²¹

4.7 Mjedisi financiar i biznesit (marrëdhëniet financiare me qeverinë)

Rreth biznesit, ndaj tij dhe mbi aktivitetin e biznesit vepron në mënyrë të vazhdueshme ambienti që e rrethon. Mjedisin për biznesin e përbëjnë bizneset tjera të llojeve të ndryshme, institucionet, agjencitë, organet qeveritare me të cilat bizneset hyjnë në lidhje ekonomike, në lidhje financiare etj.

Janë këto marrëdhënie biznesi, marrëdhënie financiare dhe konkurruese të një biznesi me bizneset tjera, marrëdhënie të cilat mund të ndodhin individualisht apo edhe bashkërisht.

Legjislacioni shtetëror në të gjitha fushat, sidomos në atë të politikës fiskale (tatimeve dhe doganave), ushtron një ndikim shumë të madh në veprimtarinë e bizneseve dhe në vet zhvillimin e biznesit. Krahas detyrimit të respektimit të rregullave e normave juridike të nxjerra nga shteti, bizneset kanë gjithashtu për obligim të respektojnë dhe të shlyejnë rregullisht detyrimet financiare dhe fiskale. Andaj një menaxhim i mirë dhe një menaxher koherent ka rëndësi në

²¹ M,p Naryanan & Vikran K. Nanda-“Financije za stratesko odlucivanje,faqe1-3.
Zagrebacka shkola ekonomije i managmenta,poslovna shkolla Sveucilista u Michiganu

mbarëvajtjen e biznesit, sepse detyrohet të zbatojë me rigorozitet kriteret për llogaritjen dhe për afatet e shlyerjes së detyrimeve, për mënyrën dhe format e llogaritjes së sigurimeve shoqërore të respektojë rregullat dhe normat për mbajtjen e kontabilitetit, për mënyrën e raportimit të të dhënave, nxjerrjen e bilanceve dhe të treguesve tjerë financiarë, të zbatojë rregullat dhe normat për amortizimin e mjeteve themelore dhe për mënyrën e përlllogaritjes së fitimit. Bizneset duhet të respektojnë kufijtë e vendosur nga qeveria për nivelin e pagave të punëtorëve. Me anë të legjislacionit, çdo qeveri rregullon edhe format e organizimit të bizneseve, marrëdhëniet tregtare dhe afariste, pranimin dhe sigurimin e punëtorëve, pranimin dhe sigurimin e punëtorëve në punë, siguron veprimtarinë e bizneseve me kapital të jashtëm, rregullon me ligj përmes politikës fiskale marrëdhëniet ekonomike me jashtë, bën organizimin e sindikatave për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve.

Pra, bizneset në shumë raste janë objekte të rregullimeve shtetërore. Në disa aktivitete qeveria financon ose subvencionon bizneset në funksion të prodhimit dhe të interesave të saj.

Ndërhyrjet qeveritare në ekonomi janë të njohura në formë të intervenimeve politike, eksproprijimeve, kontrollit të kursit revizor, kufizimeve në import, kontrollit të tregut, kontrollit fiskal, kontrollit të çmimeve, si dhe kufizimeve lidhur me fuqinë punëtore.

Në disa raste qeveria ndërhyr në jetën ekonomike për të siguruar shpërndarjen optimale të resurseve ekonomike, proporcionalitetin e zhvillimit dhe strukturën e nevojshme të produkteve në treg. Me ligje rregullohen kushtet në të cilat biznesi duhet të veprojë në njërën anë, por në anën tjetër ato prekin edhe rezultatin financiar të biznesit, duke vënë dorë mbi një pjesë të fitimit të biznesit në emër të tatimeve, doganave, taksave etj. Nëse tatimet mbi fitimin apo mbi të ardhurat e korporatave në një vend të caktuar janë shumë të larta, atëherë do të ndikojë në frenimin apo pengimin e futjes së konkurrentëve tjerë në atë degë të prodhimit dhe do të ndikon në zhvendosjen e investimeve në sektorë tjerë më fitimprurës. Shembull në Kosovë, pas luftës së vitit 1999 e deri në vitin 2005 bizneset nuk kishin interes të prodhojnë, për shkak të politikave jo të favorshme doganore dhe tatimore, andaj shumë biznese prodhonin në Maqedoninë fqinje dhe në Kosovë i sillnin produktet e gatshme, pra më me interes ishte importi se sa prodhimi, për shkak të politikave fiskale të pafavorshme në atë kohë mund të themi se rreth 97% e të gjitha të mirave materiale importoheshin. Andaj legjislacioni ka ndikim të madh, edhe në tregun e furnizimeve me lëndë të parë dhe pajisje nga importi, si dhe në eksportimin e produkteve jashtë vendit, masat lehtësuese apo preferenciale doganore vënë disa degë dhe veprimtari në pozitë më të favorshme afariste, të cilat nuk janë vetëm rezultat i punës së biznesit, por këto favore

krijohen nga kushtet ligjore të krijuara nga qeveria, kurse ato preteksioniste i vënë bizneset në pozitë të kufizuar dhe të pabarabartë me pjesëmarrësit tjerë. Kur kemi këto intervenime atëherë nuk mund të themi se kemi krijuar një treg të lirë i cili vepron nën ndikimin e ofertës dhe kërkesës, sepse kemi shumë masa të ndërmara nga qeveria .

Ky përshkrim apo kjo paraqitje, më lartë ka shumë ngjashmëri me politikat aktuale të sotme në Kosovë, ku kemi treg të lirë pjesërisht, por jo krejt sa duhet sepse kemi ndërhyrje të qeverisë në ekonomi në shumë raste, siç ishte rasti në vitin 2012 kur biznesi Sharrcem (prodhues i çimentos) ishte në pozitë financiare jo të mirë atëherë qeveria e bllokoi importimin e çimentos prej vendeve tjera, me qëllimin e vetëm që t'i krijojë fitim Sharrcemit dhe ta shpëtojë nga falimentimi.

4.8 Marrëdhëniet me tregun financiar dhe bankat

Kushtet ekonomike të financimit si: tregu i kapitalit, kurset e interesit dhe inflacioni kufizojnë qarkullimin e mjeteve financiare dhe determinojnë ritmin e gjallërimit ekonomik. Gjatë periudhave kur përqindja e interesit bankar ulet, konsumatorët janë më të gatshëm për të marrë kredi për blerje të mallrave dhe të shërbimeve që ofron tregu. Në këto rrethana biznesit i kushton më lirë blerja e kapitalit për zgjerimin e aktivitetit të tij.

Pyetja shtrohet, Bankat komerciale në Kosovë a e kanë ndihmuar zhvillimin ekonomik? Mendoj se shumë pak për arsye se dhënia e kredive ka një kamatë interesi shumë të lartë, ku sillet prej 11.5 % deri në 13% vjetore, dhe për habinë më të madhe edhe pse kjo përqindje është shumë e lartë kreditë e këqija në Kosovë janë më të voglat krahasuar me vendet e rajonit. Por pse ndodh kjo? Bankat thirren në atë që është rrezik sepse vendi trajtohet si gjendje pas lufte, por dyshimet janë që bankat komerciale në Kosovë kanë marrëveshje në mes veti që të mbajnë kamatat më të larta.

Bizneset hynë në marrëdhënie me bankat për të marrë kredi me afate të ndryshme.

Për kreditë që akordohen, banka kërkon të marrë interes, ndërsa për paratë që posedojnë bizneset në llogaritë e tyre bankare u paguajnë atyre një përqindje interesi prej 3-5% vjetore nëse ato mjete afatizohen për një periudhë mbi 1 vjeçare.

Dhënia e kredive i nënshtrohet një muri rregullash shumë rigoroze, bankat kërkojnë kthimin e kredive në afatin e duhur të dakorduar më parë në momentin e lejimit të kredisë në përputhje me të gjitha normat e interesit.

Problemi i kostos së kapitalit është i lidhur edhe me shkallën e inflacionit, sepse inflacioni nëse është i lartë ndikon në kapitalin tregtar në tri aspekte kryesore:

- Rrit nevojat për hua, meqenëse vlera e stoqeve dhe të ardhurat e pritshme rriten krahas inflacionit;
- Ndikon në rritjen e kurseve të interesit, duke shtrenjtuar kështu huatë;
- Ai shoqërohet zakonisht nga reagime qeveritare që çojnë në shtrëngimin e huadhënies.

Prandaj, zakonisht për bizneset e vogla, kjo është diskriminuese, meqenëse ato nuk janë të parapërgatitura mirë për të konkurruar me bizneset e mëdha, për lëvrimet e fondeve që mund të jepen hua, që vijnë gjithnjë duke i zvogëluar.

Nga shpjegimi i dhënë më lartë mund të vërejmë se bizneset janë përherë nën kontrollin dhe kërcënimin e bankës, ndërkaq një biznes mund të hyjë në marrëdhënie jo vetëm me një bankë por mund të hyjë në marrëdhënie me disa banka njëkohësisht, por bizneset të cilat nuk e njohin mirë sistemin financiar banka në kushtet e ekonomisë së tregut janë të predispozura për dështim.

Bizneset përveç marrëdhënies financiare me bankat zhvillojnë marrëdhënie financiare edhe në mes vete, siç janë: shitblerjet dhe likuidimi i pagesave dhe si marrëdhënie të konkurrencës.

Secili biznes në një moment të caktuar ka një numër të caktuar të produkteve dhe shërbimeve në treg, të cilat ofrohen bashkë me produktet dhe shërbimet e prodhuesve dhe të bizneseve tjera. Ngjashëm me këtë edhe bankat dhe ndërmjetësit financiar janë në konkurrencë me njëri-tjetrën për përqindjet e interesit dhe tërheqjen e depozitave nga bizneset dhe qytetarët.

Parimisht, si rregull apo si synim i çdo biznesi është që kërkon të shpenzojë më pak e të fitojë më shumë, ky parim është i shprehur në të gjitha bizneset afariste.

Fitimi është i lidhur me shpenzimet e prodhimit dhe me çmimin e shitjes. Biznesi kërkon që të blejë me çmim sa më të lirë dhe të shes me çmim sa më të lartë, por këtë balanc e dikton konkurrenca në treg sikur në rastin e shitjes ashtu edhe në rastin e blerjes, ky fakt tregon se menaxhmenti financiar duhet ta studiojë me shumë kujdes nivelin e ofertës dhe të kërkesës në treg si dhe elementet e tjerë përreth biznesit. Menaxhmenti duhet ta njohë tregun, të ketë njohuritë themelore për konkurruesit tjerë, të cilët i takojnë degës apo lëmisë së njëjtë, duhet të dijë cilët janë konkurrentët kryesorë me çfarë baze konkurrojnë, cilët janë konkurrentët e ardhshëm potencial? etj.

Pozita e bizneseve në konkurrencë varet nga shumë faktorë, ndër të cilët po veçojmë;

- a) cilësia dhe karakteristikat e produktit,
- b) relacionet e krijuara me klientët dhe furnitorët
- c) statusi dhe pozita sociale e klientëve dhe mjedisi ku vepron biznesi,
- ç) fuqia financiare dhe burimet financiare,
- d) partnerët strategjik,
- e) faktorët kulturor,
- f) faktorët socialë, dhe

g) faktorët psikologjikë.

Bizneset krahas marrëdhënieve finaciare me bankat dhe bizneset, kanë marrëdhënie financiare edhe me punonjësit e vet dhe për nga rëndësia i takojnë një shkallë mjaft të lartë. Drejtimi i burimeve njerëzore, të cilat i posedon ndërmarrja duke përfshirë; planifikimin, rekrutimin, seleksionimin, trajnimin dhe zhvillimin e tyre si dhe motivimin e punëtorëve për kryerjen e detyrave konkrete, të gjitha këto veprime lidhen ngushtë me menaxhmentin financiar.

Rëndësi e veçantë për bizneset ka oferta, cilësia dhe çmimi i punës. Shumë vende të zhvilluara i kanë transferuar prodhimet apo një pjesë të tyre nëpër vende tjera jashtë vendit të origjinës për shkak të fuqisë punëtore të lirë dhe të bollshme.

Përvojat shkencore kanë treguar se motivimi më efikas është motivimi përmes pagave dhe mëditjeve si dhe sigurimi i pjesëmarrësve në zgjidhjen e problemeve të biznesit.

Veprim tjetër me rëndësi për ndërmarrjen dhe për të cilin menaxhmenti i ndërmarrjes duhet të tregojë kujdes të vazhdueshëm është, marrëdhënia me klientët, sepse esenca e biznesit qëndron në marrëdhëniet në mes të bizneseve dhe konsumatorëve, apo blerësve (klientëve) të vet. Suksesi i biznesit varet edhe nga stabiliteti i klientelës së tij, që do të thotë se ka siguruar treg stabil për produktet dhe shërbimet e tij. Synimi i biznesit në vazhdimësi është që ta rritë numrin e klientëve të tij duke i përdorur reklamën televizive, propagandën ekonomike, promocioneve të ndryshme etj, këto veprime biznesi i ndërmerr që të përvetësojë konsumatorë të ri dhe që t'i kthejë ata të cilët i ka humbur. Mbajtja e klientëve ekzistues dhe përfitimi i klientëve të rinj zakonisht është i lidhur me çmimet e pranueshme nga ana e tyre.

Tek konsumatorët përveç reklamave, promocioneve të ndryshme etj, ndikojnë edhe shumë faktorë të jashtëm të cilët nuk varen nga biznesi siç janë: konkurrenca, rrjeti distribuimit, masat e politikës tatimore, rregullat dhe politikat qeveritare. Në kohën e tanishme shumë biznese po e praktikojnë shitjen e produkteve përmes ndërmjetsuesve e jo të jenë vetë të pranishme në treg, andaj roli i ndërmjetimeve po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm.²²

²² Prof.dr –Isa Mustafa Menaxhmenti financiar -Prishtinë 2008-f,26-31.

Sqarim: Nëpër tekst ka nderhyrje nga autori i temepë qellim të pershtatjes me temën.

KAPITULLI V

MENAXHIMI I PROJEKTEVE

5.1 Rëndësia e tyre në menaxhimin e politikave zhvillimore

Projektet dhe menaxhimi i tyre kanë një rëndësi të veçantë në menaxhimin e politikave zhvillimore, për arsye se zbatimi i çdo politike zhvillimore paraprakisht duhet bërë një projekt. Mënyra më e mirë për të shpjeguar rolin e një menaxheri është dallimi i tij me menaxherin funksional i cili ngarkohet në një nga departamentet funksionale si marketing apo financa. Drejtuesit e këtyre departamenteve zakonisht janë specialistë të këtyre fushave. Duke qenë specialistë ata janë të orientuar në menyrë analitike dhe i njohin detajet, andaj dhe kërkohet një detyrë konkrete dhe e vështirë nga ta.

Si menaxher funksional ata janë përgjegjës nga pikëpamja administrative për të vendosur

- se si duhet bërë diçka?
- kush duhet ta bëjë atë? dhe
- çfarë burime duhen për ta realizuar atë?

Menaxheri funksional është një supervisor teknik direkt, duke e njohur teknologjinë menaxheri funksional ka njohuri bazë teknike që kërkohen për të mbikqyrur dhe për t'i këshilluar vartësit për mënyrat më të mira të kryerjes së punës së tyre dhe për të zgjidhur problemet që mund të paraqiten gjatë punës në zhvillimin e projektit.

Menaxheri i projektit mund të ketë njohuri teknike të detajuara në një ose dy fusha specifike, por rrallëherë mund të ketë njohuri përtej këtyre fushave, andaj nuk mund të aplikojnë në mënyrë direkte njohuritë, por ai duhet të ndihmojë në kooperimin ndërmjet atyre që kanë njohuri të ndryshme të specializuara dhe atyre që këto njohuri u nevojiten.

Tre pyetjet që shtrohen përpara një menaxheri të projektit për punën e tij janë:

- 1.Çfarë duhet bërë?
2. Kur duhet bërë? (që projekti të mos vonohet)dhe
- 3.Si do të merren burimet që kërkohen për të bërë punën?

Pra, menaxheri është përgjegjës për organizim, buxhet, drejtim, planifikim dhe kontrollim të projektit.

Menaxheri i projektit menaxhon tërë projektin, kurse menaxheri funksional mund të ndikojë në zgjedhjen e teknologjisë e cila do të përdoret si dhe njerëzit të cilët do të marrin pjesë në zbatimin e këtij projekti.(S.Panariti 2009 f 151).²³

Duke ju referuar këtyre pyetjeve të cilat u cekën me lartë e kuptojmë se çdo projekt gjatë zbatimit të tij në vetvete është një zbatim i strategjisë.

5.2 Zbatimi i Strategjisë

Për të pasur sukses një organizatë apo një qeveri e një vendi të caktuar duhet të ketë objektivat e saj, pastaj sipas objektivave të caktuara të vendosë se si do të arrihen ato objektiva, cilave objektiva do t'u japë përparësi gjë e cila kërkon një analizë dhe një studim të mjedisit të jashtëm. Nëse analiza është bërë me kujdes dhe janë identifikuar shanset dhe kërcënimet e mjedisit të jashtëm, atëherë mund të vazhdohet me hartimin e alternativës strategjike.

Zhvillimi i alternativave strategjike do të krijojë terren për zgjedhjen strategjike, pra për përcaktimin e asaj strategjie që do të mund të çonte në realizimin e objektivave dhe në kënaqjen e nevojave të organizatës.

Në ekonominë e tregut ,qëllimi kryesor i një organizate biznesi është të sigurojë fitime nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, kjo teori vlen vetëm për organizata apo biznese të cilat kanë qëllim fitimin, kurse për organizatat të cilat janë jofitimprurëse kjo teori nuk vlen, sepse këto organizata kanë mision social, kulturor apo ekonomik dhe kryesisht sigurojnë shërbimet e nevojshme.

Një plan i caktuar ka për qëllim të arrijë objektivat e organizatës. Planit strategjik i hartuar kalon në fazën e zbatimit, pasi të rishqyrtohet edhe njëherë lidhur me disa pika kyçe siç janë objektivat e operueshme dhe strategjike në përputhje me mjedisin e kompanisë, vetëm pasi të jetë siguruar organizata për tejkalim të pengesave atëherë mund të fillojë me zbatimin e planit strategjik.

Procesi i zbatimit të strategjisë ka një rëndësi shumë të madhe. Ajo është një detyrë administrative ose menaxheriale. Në një përkufizim të ngushtë zbatimi i strategjisë përfshin në vete ato veprime apo aktivitete që lidhin organizatën me mjedisin e saj dhe krijon performancën e përgjithshme të saj.

²³ Suzana Pariti- Menaxhim projekti ,f,150-Tiranë 2009
Vasilika Kume- Menaxhim Strategjik.f 270-Tiranë 2010

Kurse, në një përkufizim më të gjerë zbatimi i strategjisë përfshin edhe procesin e vlerësimit dhe kontrollin që një organizatë përdorë për t'ju përgjigjur ndryshimeve apo devijimeve nga strategjia e planifikuar apo diferencat midis nivelit aktual dhe atij të planifikuar të performancës. Zbatimi ka të bëjë kryesisht me realizimin e disa planeve apo aktiviteteve të caktuara. Në mënyrën më të detajuar, zbatimi i politikave apo strategjive ka të bëjë me projektimin dhe menaxhimin e sistemeve për të arritur një integrim sa më të mirë të njerëzve, strukturave, proceseve dhe burimeve për realizimin e qëllimeve të organizatës.

5.3 Financimi i projekteve publike

Në të gjitha nivelet e qeverisjes, organet legislative kontrollojnë çështjet financiare dhe marrin vendime në lidhje me financimin e projekteve publike. Parlamenti, qeverisja në nivel qendror dhe ajo në nivel lokal, i japin financimin e përshtatshëm agjencive publike, të cilat, nga ana tjetër, i përdorin këto para për projektet publike.

Financimi për projektet publike mund të vijë nga një sërë taksash të përdoruesve, të tilla si taksa e benzinës, e cila ushqen “Fondin për Mirëmbajtjen e Autostradës”. Alternativa të tjera për financimin e projekteve tradicionale të borxhit publik përfshijnë marrëveshjet e qirasë, në të cilat publiku, jep me qira asete nga burime private dhe institucioni bën pagesat e qirasë në vend të pagesave të principalit dhe të interesit mbi bonot. Ato përfshijnë edhe mekanizmat e partneritetit në të cilat subjekte private ofrojnë para, financim për projektet publike.

Këto mekanizma janë nganjëherë pjesë e marrëveshjeve të partneritetit publiko- privat. Përveç kësaj, institucionet qeveritare mund të mbështesin marrëveshjet e drejtpërdrejta financiare, duke ofruar gjëra të tilla si sigurimi i obligacioneve, linjave të kreditimit, dhe garancive qeveritare.

5.4 Menaxhimi i projektit kundrejt menaxhimit të programit të përgjithshëm

Nëse përpjekjet e një institucioni publik rezultojnë në prodhimin e një serie produktesh se sa të një produkti unik, atëherë institucioni mund të konsiderohet se është duke menaxhuar një *program*. Trevor Young, në kontekstin e sektorit privat, e përcakton programin si një:

Koleksion të projekteve të ndërlidhura, që menaxhohen në mënyrë të koordinuar, e që së bashku do të japin rezultatet e dëshiruara të biznesit.

Ndërsa një godinë zyre, një burg, një riparim i kanalizimeve të ujërave të zeza, një autostradë, apo një fushë bejsbolli në një park publik mund të konsiderohen produkte unike të krijuara nga projektet publike, një institucion apo organizatë që menaxhon ndërtimin e disa impianteve të kanalizimeve të ujërave të zeza mund të jetë duke i ndërtuar ato si pjesë e një programi.

Që të konsiderohen si një program, Young pohon se projektet individuale duhet të jenë të ndërruar. Me fjalë të tjera, nëse ndonjë projekt nuk është plotësuar në kohë, gjithë programi është vënë në rrezik dhe tejkalime të konsiderueshme të kostos mund të ndodhin.

Padyshim që menaxherët e sektorit publik duhet të koordinojnë përpjekjet e menaxherëve të projekteve individuale. Në shumë raste, menaxhimi i programit u jep organizatave një mundësi për të copëzuar ato që mund të kenë qenë projekte të mëdha dhe të ngadaltë, në copa të vogla të ndërruar dhe të koordinojë menaxhimin e këtyre pjesëve, si pjesë e një programi.

Duhet dalluar projektet dhe programet nga operacionet, të cilat kanë tendencë të mos kenë asnjë pikë të përcaktuar përfundimi. Disa nga aktivitetet e renditura në fillim të tilla si ofrimi i sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve mjekësore ose kujdesja për të paaftët, janë operacione në natyrë dhe ndërmerren si pjesë e menaxhimit të përgjithshëm të institucioneve.

Administrata e Sigurimit Shoqërorë përpunon mijëra kërkesa dhe shpërndan përfitimet në një mënyrë të vazhdueshme. Këto kërkesa individuale apo përfitime nuk janë unike, dhe aktivitetet për përpunimin dhe shpërndarjen e tyre janë të vazhdueshme dhe të përsëritura.

Operacionet e institucioneve që ndërmerren si pjesë e menaxhimit funksional ose të përgjithshëm janë përtej objektit të studimit.

5.5 Menaxhimi i projektit në sektorin publik përtej konfuzionit

Çfarë i shkon në mendje publikut, kur publikohen tituj në lidhje me projektet publike që kanë tejkaluar buxhetet e tyre? Para së gjithash, shpesh ka konfuzion se kush është përgjegjësi në lidhje me këto projekte, kush kujdeset për mbarëvajtjen e tyre?

Shpesh ka konfuzion edhe rreth asaj se çfarë shkoi keq në projekt:

Ishte tejkalimi i kostos për shkak të një vonese në skedul, pse ka ndodhur vonesa?

Ishte rezultat i një problemi në zhvillimin e softwerit të sistemit?

Ishte për shkak të mungesës së standardeve të duhura dhe specifikimeve të përcaktuara nga agjencia shtetërore?

Ishin pritjet e institucionit realiste?

Ishte vonesa rezultat i një greve nga punonjësit e kontraktorit?

Ky konfuzion mund të ekzistojë edhe në mendjen e menaxherëve dhe administratorëve të përfshirë direkt. Përgjigjet ka të ngjarë të jenë komplekse.

Për të filluar zgjidhjen me anë të pyetjeve si këto dhe për të sjellë disa sqarime për këto çështje, le të fillojmë me shqyrtimin e një çështje shumë themelore për të cilën ka shumë konfuzion, se çfarë janë në të vërtetë projektet publike. Nisja e këtij punimi pse të mos fillojë me adresimin e sfidës së menaxhimit të projektit të sektorit publik dhe si ta bëjmë atë më mirë duke përcaktuar fillimisht termat "*projekt publik*" dhe "menaxhimi i projektit në sektorin publik". Do të vazhdojë punimi në këtë pjesë me një diskutim të menaxherëve të projektit në sektorin publik, kush janë ata dhe cilat janë aftësitë, atributet, dhe kërkesat e tyre, kushtet në ndryshim dhe në vazhdim në të cilat menaxherët e projektit të sektorit publik aktualisht veprojnë, për të përfunduar me mënyrat në të cilat menaxhimi i projektit në sektorin publik mund të ketë sukses dhe në të cilat shpesh dështon.

5.6 Kush janë menaxherët e projektit të sektorit publik?

Përkufizimi i menaxherit të projektit të sektorit publik është po aq i vështirë sa dhe përkufizimi i projekteve publike dhe menaxhimi i projektit në sektorin e publik. Specifikimi se kush janë menaxherët, aftësitë, kualifikimet, si dhe atributet që ata duhet të kenë për punët e tyre, dhe çfarë kërkohet nga punët që ata të bëjnë, është një fillim i mirë për t'i dhënë formë figurës së menaxherit të projektit në sektorin publik. Duhet gjithashtu të merren në konsideratë edhe disa nga kushtet kryesore politike, ligjore, ekonomike, dhe kushte të tjera me të cilat menaxherët e projektit aktualisht ballafaqohen kur ata bëjnë punën e tyre.

Siç theksohet në hyrje, pjesa më e madhe që merret me menaxhimin e projektit të sektorit publik duket se nuk bie dakord me publikun apo janë larg pritjeve të tyre. Kjo ka të bëjë, pjesërisht me aftësitë, kualifikimet dhe atributet që menaxherët e projektit të sektorit publik kanë, por një pjesë është qartësisht për shkak të situatave të vështira politike, ligjore, ekonomike me të cilat ata duhet të përballen.

5.7 Llojet e Menaxherëve të projekteve të Sektorit Publik

Menaxheri i projektit në sektorin publik konsiderohet një individ i cili është i ngarkuar me menaxhimin e projekteve publike në emër të zotëruesit të projektit. Zotëruesi i projektit publik në përgjithësi është një institucion (*agjenci*) publik.

Është e vështirë për të qenë më specifik në përcaktimin e menaxherit të projektit të sektorit publik për shkak të variacionit në lloje të projekteve publike që kryhen dhe për shkak se ka lloje të ndryshme të strukturave të menaxhimit publik brenda të cilave menaxherët veprojnë.

Këto struktura publike të ndryshme të menaxhimit çojnë në ekzistencën e llojeve të ndryshme të menaxherëve të projektit, të tilla si:

a) Menaxherët e projektit të institucioneve publike- Kjo kategori i referohet menaxherëve të projektit brenda institucioneve tradicionale në nivelet e qeverisjes qendrore dhe asaj lokale. Këta menaxherë ekzistojnë në nivele të ndryshme të institucioneve dhe ata mund të mbikëqyrin menaxherë të tjerë për secilin nga proceset kryesore të një projekti, të tilla si prokurimi, menaxhimi i kontratës, projektimi dhe ndërtimi.

Në komunat më të vogla, krerët administrativë të institucioneve dhe zyrtarët e zgjedhur, si edhe kryetarët e komunave, mund të jenë të përfshirë direkt në menaxhimin e përgjithshëm të projektit. Një strukturë menaxheriale hierarkike shpesh mbizotëron në këto institucione publike

në të cilat menaxherët e projektit në përgjithësi, u raportojnë niveleve më të larta apo krerëve të institucioneve.

Disa zotërues të projekteve punësojnë menaxherë projekt profesionistë edhe nga jashtë institucioneve të tyre. Linjat e autoritetit mund të bëhen mjaft të ngatërruara dhe konfuze në qoftë se disa institucione janë të përfshira në ndërmarrjen e projekteve individuale ose në qoftë se kontraktuesit ose konsulentët janë të përfshirë në rolet e menaxhimit të projektit.

b)Menaxherët e Institucioneve pothuajse publike dhe autoriteteve publike- Kjo kategori u referohet menaxherëve të cilët punojnë në kuadër të agjencive pothuajse publike dhe autoriteteve publike, të cilat janë agjenci jo tradicionale që ndonjëherë financohen me fonde publike, por gjithashtu mund të financohen nga burime të tjera përveç atyre të qeverisjes qendrore apo lokale. Disa institucione dhe autoritete pothuaj publike grumbullojnë fonde me anë të tarifave të përdoruesve psh. Shpesh, këto institucione mbikëqyren nga bordet ose komisionet. Në këto raste, drejtuesve të vetë institucioneve ju kërkohet të raportojnë në bordet apo komisionet, të cilat shpesh kanë autoritet mbi miratimin e financimit dhe vendime të tjera të rëndësishme në lidhje me projektet.

Strukturat burokratike apo hierarkike të llogaridhënies zakonisht mbizotërojnë në kuadër të institucioneve pothuajse publike, por marrëdhëniet midis administratorëve të lartë të institucioneve dhe bordeve ose komisioneve mbikëqyrëse janë shpesh me natyrë ligjore apo politike.

c)Menaxherë Privat- Qytetar-Në disa raste, qytetarët mund ta gjejnë veten në menaxhimin e projekteve publike disa milionëshe.

Financimi për projekte të tilla mund të vijë nga qyteti, nga shteti nëpërmjet një granti, si dhe nga burime private. Projekti mund të menaxhohet nga një pjesë e vogël e banorëve të qytetit të cilët angazhohen në një komitet të ndërtimit vullnetar për të miratuar vendime të rëndësishme të projektit.

Komisioni i ndërtimit përbëhet nga njerëz me nivele të ndryshme aftësish dhe ekspertize. Disa janë zyrtarë të zgjedhur dhe zyrtarë të planifikimit të qytetit, ndërsa të tjerët janë njerëz me përvojë në projektim dhe ndërtim.

Në situata të tilla, strukturat menaxhuese të llogaridhënies priren të jenë jo burokratike. Marrëdhëniet midis qytetarëve, komiteteve, dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në projektet publike priren të kenë karakteristika politike, ligjore dhe profesionale.

Duhet të theksohet se menaxhimi vullnetar nuk është gjithmonë një ide e mirë në ndërmarrjen e projekteve publike. Menaxherët e projektit të sektorit publik mbledhin ekipet e menaxhimit të projektit që mund të përbëhen nga inxhinierë të institucioneve publike, specialistë prokurimi, menaxherë të kontratës, auditorë, mbrojtës ligjor dhe persona të tjerë.

Menaxherët e projektit mund të ndërtojnë ekipet pjesërisht me punonjësit ekzistues në institucionet e tyre, pjesërisht duke rekrutuar punëtorë nga institucionet e tjera, dhe gjithashtu nga jashtë qeverisë.

Është e rëndësishme të theksohet se praktika e deritanishme ka treguar se shumë vendime të lidhura me menaxhimin e projektit, veçanërisht në fazën e planifikimit paraprak, bëhen nga administratorë të lartë të institucioneve, ligjvënës, apo zyrtarë të tjerë të zgjedhur, të cilët nuk mund të konsiderohen si menaxherë të projektit.

Përveç kësaj, disa projekte dhe programe përdorin menaxherë apo ekipe të ndryshme të menaxhimit gjatë fazave të ndryshme të projekteve apo programeve, p.sh. planifikimi kundrejt ndërtimit apo ekzekutimit.

5.8 Aftësitë, atributet dhe kërkesat e Menaxherëve të Sektorit Publik

Cilado qoftë strukturë menaxheriale në të cilën punojnë menaxherët e projektit të sektorit publik, ata duhet të kenë një gamë të gjerë të aftësive dhe njohurive për punët e tyre. Këta menaxherë duhet, për shembull, të kenë njohuri të proceseve dhe aktiviteteve kryesore me të cilat lidhet definimi i menaxhimit të projektit, d.m.th njohuri për planifikimin e projektit, përzgjedhjen e agentëve, miratimin e marrëveshjeve, kontrollin, monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjeve. Ata duhet të kenë aftësi të menaxhimit të përgjithshëm dhe aftësi ndërpersonale po ashtu. Aftësitë e menaxhimit të përgjithshëm përfshijnë aftësitë financiare dhe të kontabilitetit dhe njohjen e rregullave të prokurimit, ligjit të kontratës, strukturave organizative, praktikave të sigurisë, dhe teknologjive të informacionit. Aftësitë ndërpersonale përfshijnë lidërsip, komunikim, menaxhim konflikti dhe zgjidhje të problemeve.

Është e qartë se asnjë menaxher nuk i zotëron të gjitha këto aftësi. Kështu, ata duhet të kenë aftësinë për të gjetur njerëz që zotërojnë këto aftësi të domosdoshme, njohuritë dhe përvojën për përzgjedhjen e ekipit të tyre të menaxhimit. Shpesh atributet e veçanërisht njohuritë dhe përvoja, shpërfillen në punësimin e njerëzve dhe pse janë shumë të rëndësishme.

5.9 Menaxherët dhe Menaxhimi

Menaxherët në sektorin publik dhe privat

Menaxherët e një projekti caktuar të sektorit publik, si të gjithë të punësuarit në qeveri, punojnë në një mjedis që ndryshon me shpejtësi, i cili takon aftësitë, njohuritë dhe përvojën e tyre.

Në vijim po vëmë në dukje disa nga kompetencat dhe konsideratat kryesore të një rëndësie të veçantë për menaxherët e projektit të sektorit publik.

Disa nga këto konsiderata janë rezultat i drejtpërdrejtë i mjedisit të ndryshueshëm me të cilin këta menaxherë përballen, por me një dallim nga sektori privat, sepse këtu menaxheri nuk mundohet apo nuk e qan shumë kokën për buxhetin e një projekti të caktuar, sepse këtë e merr të gatshme nga buxheti i qeverisë (shtetit), ndërsa për dallim nga menaxheri i cili zbaton projekte qeveritare, menaxheri i një korporate apo një biznesi privat ka vështirësi shumë më të mëdha për ta siguruar buxhetin e duhur për realizimin e një projekti të caktuar.

-Kush janë menaxherët dhe ku punojnë ata?

Menaxherët punojnë nëpër organizata të ndryshme. Organizata siç e dimë është një grumbull i rregullt i personave të cilët janë mbledhur bashkë duke bërë bashkimin e kapitalit për të arritur një qëllim të caktuar specifik. Andaj këtyre personave të mbledhur të cilët kanë bashkuar kapitalin u duhet një menaxher me një vizion të qartë për të arritur sukses organizata, kjo ndodh në të shumtën e rasteve, por nuk mund të përjashtojmë edhe mundësinë apo rastet kur organizatën e menaxhon njëri nga aksionarët apo pronarët e korporatës. Secila organizatë ka tri karakteristika të përbashkëta.

Çdo organizatë ka një qëllim dhe përbëhet nga persona të cilët janë grumbulluar në një strukturë të caktuar. Synimi i veçantë i një organizate shprehet në mënyrë tipike nëpërmjet qëllimit të saj.

Për shembull, presidenti i dyqaneve 7Eleven ka vendosur të:

1. Forcojë përzierjen e mallrave nëpërmjet prezantimit agresiv të ushqimeve të freskëta.
2. Asnjë synim apo qëllim nuk mund të arrihet nëse individët nuk vendosin që të caktojnë një synim dhe nuk kryejnë një tërësi aktivitete për ta bërë realitet këtë synim.
3. Të gjitha organizatat zhvillojnë një strukturë sistematike që përcakton dhe kufizon sjelljen e anëtarëve të saj.

Zhvillimi i kësaj strukture përfshin krijimin e rregullave dhe të rregulloreve, caktimin e disa anëtarëve si mbikëqyrës të anëtarëve të tjerë, formimin e grupeve të punës, ose përcaktimin e përshkrimeve të punës, pra detyra të punës në mënyrë që anëtarët e organizatës ta dinë se çfarë

duhet të bëjnë. Kështu termi organizatë i referohet një entiteti të caktuar, që ka individë ose anëtarë dhe që ka një strukturë sistematike.

Menaxherët në një organizatë dallojnë nga punëtorët operativë edhe pse punojnë në të njëjtën organizatë, dallimi mes tyre është sepse punëtorët operativë punojnë në një detyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk kanë përgjegjësi për ta mbikëqyrur punën e të tjerëve, kurse menaxheri apo menaxherët drejtojnë aktivitetet e personave të tjerë të organizatës.

Por edhe mes vet thirrjes apo titullit menaxher kemi dallime si psh. Menaxher i lartë, menaxher i mesëm dhe menaxher i ulët, por edhe menaxherët mund të jenë të kyçur drejtpërdrejt në kryerje të detyrave të caktuara, disa menaxherë madje kanë përgjegjësi operative, psh. Menaxheri i shitjes së Coca Cola-s apo ndonjë produkti tjetër të caktuar, ai është përgjegjës për mbikëqyrjen e shitjes së menaxherëve të tjerë në rajone apo vende tjera të shitjes si dhe ka obligim të dokumentojë llogaritë financiare për shitjet e realizuara. Pra dallimi në mes të këtyre dy grupeve operative dhe menaxherë, është që menaxherët kanë punonjës që u raportojnë atyre në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Por thirrjen menaxher nuk e gjejmë nëpër të gjitha organizatat të njëjtë, sepse në disa organizata shpesh i emërtojnë si mbikëqyrës në disa të tjera i emërtojnë si udhëheqës grupi apo trajner apo koordinator njësie etj, pra kemi disa emërtime të ndryshme të cilat pothuaj kryejnë punën e njëjtë.

Më lartë thamë se menaxherët dallojnë edhe për nga shkallët menaxheriale si: menaxher i lartë, i mesëm dhe i ulët, psh. Nëse e marrim shembull universitetin, një shef departamenti është menaxher i lartë sepse i mbikëqyrë aktivitetet e pedagogëve të një departamenti përkatës, menaxheri i mesëm përfaqëson nivelin mes menaxherit të lartë dhe atij të ulët, këta administrojnë disa punonjës operativ, edhe menaxheret e mesëm bartin disa emërtime varësisht prej emërtimeve në rregulloret e organizatës, psh . në nivel të njëjtë për emërtime të ndryshme janë; shef departamenti, udhëheqës ekipi, drejtor agjencie, drejtues projekti, menaxher rajoni, dekan, menaxher sektori etj.

Kurse menaxherët e nivelit të ulët janë mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të aktiviteteve të përditshme operative.

Nëse e ndajmë në % matje të kohës për aktivitet sipas shkallëve menaxheriale, menaxher i ulët, i mesëm dhe i lartë, atëherë mund të kemi këtë radhitje (sipas Robbins/DeCenzo f,41),

Menaxheri i lartë; Organizim 36%, planifikim 28%, udhëheqje 22%, kontroll 14%.

Menaxheri i mesëm; Organizim 33%, planifikim 18%, udhëheqje 36%, kontroll 13%.

Menaxheri i ulët; Organizim 24%, planifikim 15%, udhëhqe 51%, kontroll 10%.

Nga kjo paraqitje vërejmë shpërndarjen e përgjegjësisë sipas fushave të caktuara.

Pra, menaxhimi apo termi menaxhim i referohet procesit të punëve efektive dhe efikiente përmes personave të tjerë dhe me persona të tjerë të cilët janë nën menaxhimin e tij apo saj.

Efektiviteti dhe efikasiteti merren me atë se çfarë po bëjmë dhe se si po e bëjmë. Efikasiteti ka të bëjë me kryerjen e punëve në mënyrë të saktë të detyrave të parashtruara dhe i referohet lidhjes mes inputeve dhe outputeve. Nëse kemi më shumë outpute për një sasi inputi atëherë kemi të bëjmë me rritje të efikasitetit, por nëse kemi të kundërtën atëherë kemi rënie të efikasitetit. Menaxherët merren më shumë me burime inputi që janë të kufizuar në para, njerëz dhe pajisje dhe menaxheri është i interesuar për një përdorim efikasiteti të këtyre burimeve. Prandaj duke i pasur parasysh këto që u thanë më lartë kuptojmë se menaxherët kërkojnë t'i minimizojnë kostot e burimeve ose të rezervave.

Menaxheri i mirë në kuptimin e plotë të fjalës interesohet për arritjen e qëllimeve (efektivitetin apo objektivave) të organizatës dhe për kryerjen e tyre sa të jetë e mundur dhe në mënyrë sa më efikiente.

Por nëse e shtrojmë pyetjen se a ka mundësi që një organizatë të jetë efikiente por jo efektive? Mund të themi po duke bërë mirë ato gjëra të cilat janë bërë gabim më herët.

Shpesh na bie të degjojmë se disa organizata apo agjensione të ndryshme janë efektive por nuk janë efikiente, sepse ato e arrijnë qëllimin e vet, por me një kosto shumë të lartë. Menaxheri i mirë apo drejtuesi i mirë synon dhe angazhohet që t'i arrijë të dyja edhe qëllimin (efektivitetin) por edhe për arritje të efikasitetit me një kosto sa më të ulët të mundshme. Që të jemi sa më konciz në arritjen e efektivitetit dhe të efikasitetit atëherë na duhet një organizim shumë i mirë i punës, duke përcaktuar saktë detyrat, përzgjedhej e njerëzve, kush do t'i kryejë ato detyra dhe analizën e saktë të detyrave duke bërë edhe kontrollin dhe analizën e performancës në fund fare. (Robbins / DeCenzo UET Press, 2011, f. 29-37).

Menaxherët në kuptimin e drejtë të fjalës bëjnë punën e njëjtë pavarësisht a është menaxher në institucione publike apo në korporata private mund të kenë ndryshime të vogla, por kryesisht mund të përmbledhet se bëjnë punën e njëjtë, kur është fjala për menaxhimin, sepse të gjithë menaxherët marrin vendime, vendosin objektiva, krijojnë struktura organizative të zbatueshme, marrin punëtorë në punë dhe i motivojnë punëtorët, sigurojnë legjitimitetin për ekzistencën e organizatës së tyre dhe zhvillojnë mbështetjen politike të brendshme, qoftë menaxheri i një

kompanie private qoftë menaxher i një departamenti të një ministrie të caktuar, në mënyrë që programet të mund të implementohen.

Po kështu menaxherët bëjnë punën e njëjtë me të gjitha karakteristikat e cekura më lartë edhe në raste kur korporata ofron me qëllim përfitimi apo me qëllim jopërfitimi, por ndryshimet ku mund t'i dallojnë menaxherët të cilët kanë punuar në organizata me qëllim fitimi në kompanitë e tyre krahasuar me menaxherët të cilët kanë punuar në organizata jofitimprurese si psh, në një agjension bamirës, dallimin mund ta bëjmë përmes matjes së performancës, të gjitha detyrat, vendimet, përzgjedhja e stafit organizimin, planifikimi, kontrolli e të tjera e kanë të njëjtë vetëm që te këto organizata apo agjensione fitimi nuk është qëllimi kryesor .

5.10 Konceptet e menaxhimit dhe kufijtë kombëtarë.

Nëse konceptet menaxheriale do të ishin plotësisht të përgjithshme ato do të mund të aplikoheshin në mënyrë universale në çdo vend të botës, pavarësisht ndryshimeve ekonomike shoqërore, politike apo kulturore, por nga studimet e bëra të autorëve të ndryshëm kemi të bëjmë me dallime menaxheriale varësisht prej shtetit apo prej rregullimit shtetëror si psh, Amerika krahasuar me Kinën kanë dallime konceptuale në mes veti, për shkak të rregullimit shtetëror të këtyre dy vendeve, sepse në Kinë ndryshon shumë krahasuar me Amerikën, Kanadën apo Evropën, ku demokracia dhe tregu i lirë janë më të zhvilluara.

5.11 Vendimmarrja dhe përballimi i ndryshimeve.

Janë dy këndvështrime që duhet të merren në konsideratë sa i përket rolit të menaxherëve dhe marrjes së vendimeve. Atyre u duhet të marrin vendime pavarësisht nëse bëhet fjalë për vendosjen e qëllimeve të organizatës, për përcaktimin e strukturimit të punëve, për përcaktimin si duhet të motivohen dhe si duhet të shpërblehen punëtorët për punën të cilën ata bëjnë, ose përcaktimin nëse kanë ndodhur shmangie domethënëse.

Pra, menaxherët më të mirë janë ata të cilët mund të identifikojnë problemet kritike me kohë si dhe t'i shqyrtojnë të dhënat e nevojshme, të kuptojnë informacionin në thellësi dhe të bëjnë zgjedhjen e kursit më të mirë për zgjedhjen e problemit të paraqitur.

Sot në kohën të cilën e jetojmë, organizatat veprojnë në një botë me ndryshime dinamike, andaj dhe menaxhimi në kushte kaosi nuk është më një përjashtim, por është bërë një situatë normale, duke e parë këtë dinamizëm të zhvillimit botëror kaq të shpejtë, menaxherë të suksesshëm janë

ata të cilët i pranojnë ndryshimet dhe me shpejtësi apo fleksibilitet u përshtaten praktikave të cilat i përballojnë këto ndryshime dhe njëkohësisht ju përshtaten për të qenë koherent. Për shembull një menaxher i suksesshëm i njëj efektet e ndryshimeve teknologjike në performancën e punës dhe veprojnë menjëherë, por gjithashtu janë të vetëdijshëm se punëtorët ju rezistojnë ndryshimeve dhe në këtë pikë ata paraprakisht organizojnë kontakte me punëtorë dhe i bindin që ndryshimet janë të detyrueshme, për të qenë koherent dhe e eliminojnë pengesën e rezistencës nga punëtorët.

Siç e dimë, menaxherët pavarësisht nivelit menaxhues, madhësisë së organizatës, njësisë fitimprurëse apo jofitimprurëse kryejnë aktivitetet themelore të menaxhimit.

Në vitin 1970 studiuesi i menaxhimit, Robert L. Katz, u përpoq ta studionte këtë çështje.

Ajo që Katz dhe të tjerët kanë zbuluar është që menaxherët duhet të zotërojnë katër aftësi menaxheriale vendimtare e këto janë: 1. Aftësi konceptuale 2. Aftësi ndërpersonale komunikuese 3. Aftësi teknike 4. Aftësi politike.

1. Aftësitë konceptuale- i referohen kapacitetit mendor për të analizuar dhe për të diagnostifikuar situatë komplekse.

2. Aftësitë komunikuese- përmbledhin aftësinë për të punuar me njerëz të tjerë, për t'i kuptuar ata dhe për t'i drejtuar dhe motivuar edhe në grup, por edhe individualisht, por për të qenë i suksesshëm menaxheri duhet patjetër të ketë aftësi edhe për t'i deleguar detyrat, sepse suksesi i tij është përmes punës së të tjerëve.

3. Aftësitë teknike- këto aftësi bazohen në njohurinë ose në ekspertizë të specializuara në një lëmi të caktuar. Për menaxherët e nivelit të lartë janë të ndërlikdhura me njohjen e industrisë apo edhe në rastin e marketingut apo edhe në raste tjera. Për menaxherët e nivelit të mesëm lidhet me njohjen e një fushe të caktuar ku ai punon si p.sh, financa, burime njerëzore prodhim e tjera.

4. Aftësitë politike – Këto aftësi lidhen më tepër për të përmirësuar apo fuqizuar pozicionin personal të vet menaxherit, duke krijuar lidhjet e duhura me qëllim që të jetë më koherent në kryerjen e punëve të organizatës ku punon. Organizatat e fuqishme pothuajse në të gjitha vendet, shtetet e veçmas në shtetet ballkanike e sidomos në Kosovë janë fushëbeteja politike në të cilat individët konkurrojnë për burime. Prandaj menaxherët me zotësi të lartë politike e kanë më të lehtë të sigurojnë burime për grupet e tyre krahasuar me menaxherët të cilët kanë aftësi të ulta politike, gjithashtu menaxherët me aftësi më të larta politike marrin edhe vlerësime më të larta dhe gëzojnë më shumë ngritje në detyrë (nëpër vendet më pak të zhvilluara, sikur rasti i Kosovës këtë karakteristikë e hasim më tepër te ndërmarrjet publike, si në udhëheqjen e tyre, po ashtu

edhe nëpër bordet drejtuese të tyre, për arsye se nëpër këto ndërmarrje, shteti apo qeveria ka ndikim të drejtëpërdrejtë si në emërimin e drejtorit po ashtu edhe në përzgjedhjen e bordit drejtues).²⁴

Por e gjithë kjo e cila u shpjegua më lartë është e vetëkuptueshme, që kemi një etik menaxheriale të cilën do ta shpjegojmë më poshtë.

5.12 Etika Menaxheriale

Etika menaxheriale përfshin të gjitha standardet e sjelljes apo gjykimit moral që menaxheri duhet të përdor gjatë drejtimit të një biznesi. Standardet lindin nga normat dhe vlerat e përgjithshme të shoqërisë, nga eksperiencia e individëve të ndryshëm në familjet e tyre, nga arsimi, nga feja apo institucione tjera, nga ndërveprimet ndërmjet personave etj. Për rrjedhojë etika menaxheriale mund të ndryshojë shumë nga individi prej individit, dhe këtu vjen në shprehje thënia e famshme e Fridrih Niçes i cili thotë: *Ti ke mënyrën tënde, unë kam mënyrën time*. Ndërsa mënyra e saktë, e duhura dhe e vetmja nuk ekziston.

Sipas A.B.Caroll, studiues i shquar në fushën e përgjegjësisë sociale, menaxheri normalisht karakterizohet nga tri nivele të gjykimit moral apo etik: 1. menaxhim imoral, 2. menaxhim amoral, 3. menaxhim moral.

1. Menaxhimit imoral- i mungojnë jo vetëm parimet etike, por ai vepron në mënyrë aktive në kundërshtim me sjelljen etike. Kjo mënyrë e të vepruarit dhe e të menduarit karakterizohet kryesisht nga preokupimi për përfitimet e kompanisë, për fitimin dhe suksesin e saj me çdo kusht, nga mungesa e preokupimit për të trajtuar të tjerët me drejtësi dhe nga vështrimi i ligjit si një pengesë e cila duhet kapërcyer patjetër qoftë edhe duke shkelur atë, po të jetë nevoja. Parimi kryesor i menaxhimit imoral është që të fitojnë para me çdo kusht duke e bërë këtë veprim apo duke marrë këtë vendim pa e çarë kokën për konsideratën apo rregullat ligjore. Këtë lloj të menaxhimit e hasim shpesh në vendet e Evropës lindore dhe sidomos në vendet të cilat janë në fazë të tranzicionit (këtë lloj të menaxhimit imoral e hasim shumë shpesh në Kosovë), ku si qëllim është fitimi duke mos marrë për bazë fare përgjegjësitë sociale apo normat e etikës menaxheriale, dhe duke shfrytëzuar dobësitë shtetërore apo vakuumet ligjore.

²⁴ Robbins De Cenzo- Bazat e Menaxhimit f,29- 45-UET-Press,2011
Sqarim- Nëpër tekst ka pershtatje dhe shtesa nga autori i temës.

2.Menaxhimi amoral- menaxhimi amoral nuk është as imoral por as moral. Më tepër ky lloj menaxhimi është i pakujdesshëm kundrejt konsideratave etike. Ekzistojnë dy tipe të menaxhimit amoral; i qëllimshëm dhe i paqëllimshëm.

-Menaxherët amoral të qëllimshëm nuk marrin parasysh konsideratat etike në marrjen e vendimeve të tyre, sepse nisen nga parimi se standardet e përgjithshme të jetës mund të jenë tjera po jo edhe në biznes.

-Menaxherët amoral të paqëllimshëm për dallim prej menaxherëve moral të qëllimshëm, ky tip i menaxherëve nuk i marrin parasysh çështjet etike për biznesin e tyre nga pakujdesia apo te pandjeshmëria ndaj aspekteve morale në marrjen e vendimeve të tyre. Ky tip i menaxherëve ndjek fitimin si synim dhe i kushton fare pak rëndësi sjelljes së tyre ndaj të tjerëve.

3.Menaxhimi i moralshëm. Për dallim nga menaxhimi imoral dhe amoral, menaxhimi moral përpiket të veprojë në përputhje me parimet etike.

Edhe menaxherët të cilët i përkasin menaxhimit të moralshëm duan dhe përpiqen që të kenë sukses në biznes, por dallimi është se këta tipa të menaxherëve dëshirojnë të arrijnë sukses duke respektuar parametrat e standardeve të etikes dhe idealeve të drejtësisë dhe ndershmërisë.

Për rrjedhojë këta menaxherë ndjekin objektivat e biznesit të cilat përmbajnë në brendësinë e tyre fitimin dhe sjelljen e standardeve të etikës brenda rregullave ligjore.

Disa nga parimet etike të cilat duhet të udhëhiqen menaxherët janë;

- a) Bindja ndaj ligjit, dhe ndaj frymës që përmban ligji,
- b) Tregoni të vërtetën. Tregimi i së vërtetës ka rëndësi në krijimin e grupet ” stakeholders” (palët e interesit). Shembull, kur një grup punëtorësh pyeten Digital Equipment Corporation se pse ka dështime të grave shtatzëna të cilat punonin në linjat zinxhir të gjysmëpërçuesve?- Corporata Digital Equipment menjëherë bëri një studim, i cili i kushtoi disa qindra mijëra dollarë me qëllim që t’u përgjigjet me korrektësi dhe saktësi punëtorëve dhe pas analizave ju përgjigj se dështimi i grave shtatzëna në linjat zinxhir të gjysmëpërçuesve është 39%, kurse në pjesën tjetër të korporatës është rreth 18% ,ky shembull na tregon më së miri se si tregohet e vërteta.
- c) Tregoni respekt për njerëzit. Nocioni i trajtimit të njerëzve me respekt i ka rrënjët thellë në studimin e etikës menaxheriale. Respekti për njeriun, për punëtorin në rastin tonë ka një rol të veçantë te menaxhimi i moralshëm, sepse mirret si motivim për punën e bërë, andaj shumë kompani në këtë pikë janë të kujdesshme, për shembull kompania Pacifik Bell ka përfaqësi shërbimesh, të cilët flasin anglisht, spanisht, kinezisht, gjuhën koreane, vietnameze e tjera me qëllim që punëtorët që u perkasin këtyre kombeve mos të ndihen të diferencuar duke i obliguar

me shërbime vetëm në gjuhën angleze, ky është një shembull i cili na tregon shumë mirë respektin për njerëzit.

d) Përmbajuni rregullit të artë. Rregulli i artë “Bëjuni të tjerëve atë që do të donit që të tjerët të ju bënin juve”(thënie e vjetër popullore e marrë nga bibla) na ofron një lloj testi për të vlerësuar marrjen e vendimeve etike (të moralshme) të biznesit. Pra një trajtim i individëve në mënyrën e drejtë e të ndershme në atë menyrë si do të deshironin menaxherët të trajtoheshin nga biznesi nëse do ishin vet në rastin e tillë si individë apo si punëtor operacional.

e) Mbi të gjitha mos bëni keq. Ky parim si rregull numër një në etikën mjekësore –konsiderohet nga disa studiues si kufiri i poshtëm i etikës, i cili mund të adaptohet me lehtësi në biznes. Për shembull, kompania H.J.Heintz e cila prodhon gjëra ushqimore për fëmijë i porosit furnitorët që mos të përdorin kimikale të cilat janë të dëmshme për shëndetin e fëmijëve edhe pse këto kimikale ishin ligjërisht të lejuara. Në Kosovë prej viteve të 90-ta e tutje e deri më sot importohen mishra të ndryshme nga Brazili me prejardhje të dyshimtë dhe të dëmshme për shëndetin si dhe shumëherë me afat të skaduar , dhe shumëherë të publikuara nga inspektoriati i ushqimit dhe veterinës si ushqime kancerogjene.

f) Praktikoni pjesëmarrjen e jo paternalizmin. Ky parim nënkupton faktin se menaxherët duhet të kenë parasysh se cilat janë nevojat e stakeholdersa-ve dhe jo të vendosin vet se çfarë është e mirë për ta.

g)Veproni gjithmonë kur keni përgjegjësi dhe mundësi. Menaxherët kanë përgjegjësi për kryerjen e veprimeve në çdo rast ku kanë mundësi apo burime për të vepruar.Veprimi menaxherial është veçanërisht i rëndësishëm në qoftë se ata që janë afër tij (punëtorët operacional) kanë nevojë dhe kur menaxheri është i vetmi person që mund t’u ndihmojë për ta kapërcyer një problem të caktuar apo për ta bërë më mirë një shërbim të caktuar.

5.13 Faktorët situacional që influencojnë mbi etikën menaxheriale

Shumë nga kërkimet shkencore mbi çështjen etike kanë zbuluar se disa faktorë në mjedisin e një organizate mund të çojnë në sjelljen joligjore apo joetike. Këta faktorë i ndajmë në faktorë të brendshëm dhe faktorë të jashtëm.

-Faktorët e mjedisit të jashtëm

- Mjedisi konkurrues pra konkurrenca e ashpër dhe jo lojale e kohës të cilën po jetojmë mund të çojnë drejt sjelljes joetike, sidomos aty ku konkurrenca është shumë e fortë.
- Konkurrenca mund të nxisë sjelljen jo etike jo vetëm në kompanit fitimprurëse, por edhe nëpër organizatat jofitimprurëse. Shembull më konkretë në Kosovë është fushata elektorale veprimet joligjore dhe premtimet pa mbulesë nga kandidatët politikë.
- Prania e një mjedisi me shanse shumë të vogla- të ofruar prej tij, mund të çojnë në sjellje joetike në përpjekjet e kompanive për një performancë financiare të lartë. Kjo vjen për shkak se edhe mundësitë për sukses janë të vogla nga konkurrenca në mes të kompanive që operojnë në të njëjtën fushë. Kjo konkurrencë bën që shpesh prodhimet nuk e posedojnë përshkrimin adekuat të përmbajtjes apo mund të themi shpeshherë edhe të falsifikuar si për shembull një litër lëng molle shkruan 100% lëng molle e në fakt lëng molle ka 50% apo edhe më pak . Kjo është një sjellje joetike ndaj konsumatorit por edhe ligjërisht e ndaluar, por menaxherët edhe pse janë të vetëdijshëm për këtë reklamacion të pavërtetë ata këtë e bëjnë për shkak të një performace finaciare.
- Por edhe kur mjedisi ofron shanse shumë të mëdha- edhe në këtë rast kjo situatë mund të çojë në sjellje joetike, në ato raste, kur organizata përpiket të rritet shumë shpejt dhe të përfitojë nga avantazhet e krijuara ku kërkesa është e lartë krahasuar me ofertën apo kur në një formë apo një tjetër kemi monopol në atë pjesë të tregut, këto raste si shembull më i mirë në Kosovë është rasti i Arkave Fiskale, ku qeveria në vitin 2010 ka liçencuar vetëm dy biznese për importimin nga jashtë të arkave fiskale dhe si pasojë çmimi i një arke i cili në një vend tjetër mund të kushtonte 250€, në Kosovë shitej me mbi 500€, sepse kompanitë bënë marrëveshje mes vete dhe kështu çmimi nuk ndikohej nga tregu, ky është një shembull tipik joetik.
- Varësia ekstreme (shumë e madhe) e një organizate nga një tjetër organizatë, në raste të tilla mund të gjenerojë presion për ryshfete dhe privilegje të tjera. Këto lloj presione më tepër i hasim nëpër projekte të cilat financohen nga shteti përmes tenderëve të ndryshëm. Shembull në Kosovë hapet një tender për ta shtruar një rrugë me asfalt dhe kërkohet vetëm një lloj i caktuar i asfaltit apo zhavorrit, ku në Kosovë zhavor të tillë ka vetëm një kompani, këtu kemi në mënyrë të drejtpërdrejtë varësi ekstreme.

-Faktorët e brendshëm;

- Presioni i madh për një performancë të lartë mund të nxitë individë të veçantë të shkurtojnë procedurat e domosdoshme në linjat zinxhimore të prodhimit të cilitdo prej produkteve që produkti mos të jetë i sigurtë.
 - Pakënaqësia e punëtorëve po ashtu mund të çojë në një sjellje jo etike, pasi që zemërimi mund të zëvendësojë sjelljen racionale (ky perceptim i nxjerrë për biznesit private prodhuese mund të përdoret me dallime shumë të vogla edhe për vetëqeverisjen e shtetit atëherë kur popullsia e një vendi është e pakënaqur me prioritet apo menaxhimin e politikave zhvillimore dhe keqpërdorimin e buxhetit shtetëror).
 - Delegimi i autoritetit dhe nxitja e inovacionit mund të çojë në sjellje jo etike për shkak të hapësirës së madhe të veprimet relativisht të pavarura të punonjësve të veçantë.
- Meqenëse faktorët e jashtëm dhe të brendshëm mund të çojnë në sjellje jo etike nëpër kompani private, por edhe në kompani shtetërore publike apo edhe nëpër dikastere të ndryshme të qeverisë, menaxherët (udhëheqësit) duhet të përpiqen në vazhdimësi për t'i bindur vartësit e tyre për rëndësinë e sjelljes etike nëpër vende të punës ku ata punojnë qoftë institucione shtetërore apo kompani private.

5.14 Krijimi i mjedisit për menaxhimin etik të biznesit

Çështje me rëndësi të veçantë për menaxherët është të nxisin sjelljen etike të vartësve të tyre në organizatë, edhe pse jemi të vetëdijshëm që për ta arritur këtë sidomos nëpër organizata të mëdha ku numri i punëtorëve është i madh, është mjaft sfiduese për vet faktin se kemi të bëjmë me karaktere dhe ambicie të ndryshme të njerëzve, por edhe përkundër këtyre menaxherët duhet të jenë këmbëngulës dhe të përdorin strategji dhe mekanizma të ndryshëm me qëllim që të kemi sjellje etike. Mekanizmat të cilët një menaxher mund të përdorë janë si: përkushtimi i menaxherëve të lartë, kodet e etikës, komitetet e etikës, auditimi i etikës, trajnimet për etikën, linjat telefonike direkte etj.

a)Përkushtimi i menaxherëve të nivelit të lartë, arsyeja pse kërkohet përkushtimi i menaxherëve të lartë përmes institucionalizimit të një sërë mekanizmesh në hierarki dhe me sjelljen e tyre duke qenë shembull vartësit tregojnë më tepër vëmendje.

b) Kodi i etikës është një dokument i shkruar, ku secila organizatë duhet ta ketë dhe punëtorëve duhet t’u ofrohet për nënshkrim me qëllim që të kenë njohuri se cilat janë rregullat etike të organizatës, me qëllim që në raste të caktuara të mos vijnë në situata të palakmueshme dhe në rastin më të keq mos të dinë se si të veprojnë. Në Kosovë nëpër organizata private kodi i etikës pothuaj nuk përfillet fare, kurse nëpër institucione shtetërore ekziston i shkruar dhe punëtorët njoftohen me kodin e etikës, por në zbatim ka ngecje në shumë raste. Për kodin i etikës duhet të tregohet më tepër kujdes, sepse nisur nga përvoja e vendeve të zhvilluara Evropiane ku kodi i etikës çdo ditë e më tepër po zë një vend mjaft të rëndësishëm, përveç kodit të etikës i cili është i rëndësishëm po kaq i rëndësishëm është edhe përcaktimi i standardeve të sjelljes brenda organizatës dhe kjo në shumë vende të zhvilluara të botës tani aplikohet që në start të nënshkrimit të kontratës së punës edhe nënshkrimin e kodin e etikës.

c) Komiteti etik - është një organizëm, i cili ka për detyrë të ndihmojë në përcaktimin e politikave etike si dhe zgjedhjen e çështjeve etike me të cilat ballafaqohen anëtarët e organizatës gjatë punës së tyre, si dhe bën mbikëqyrjen e trajnimeve të etikës. Komiteti etik në një organizatë zakonisht udhëhiqet nga njerëz të cilët kanë pozitë të lartë menaxheriale dhe bëjnë pjesë në bordin e drejtorëve. Në Kosovë Komitete etike të bizneset private vendore nuk ekzistojnë fare.

d) Auditimi i etikës, disa organizata kryejnë auditim të etikës me qëllim që të ndihmojnë për t’i kuptuar këto politika dhe për të identifikuar raste ku ka shkelje të etikës të cilat kërkojnë veprime rregulluese.

e) Linjat telefonike direkte –është linjë e veçantë e cila ju mundëson punëtorëve ta kapërcejnë zinxhirin normal të hierarkisë për të raportuar mbi ankesat apo problemet të cilat i kanë. Kjo linjë zakonisht administrohet prej menaxherit investigues i cili ndihmon në zgjidhjen e problemeve brenda organizatës. Qëllimi i kësaj linje është ruajtja e integritetit të punëtorëve që mos të bëhen publike informatat, dhe mos ta dëmtojë reputacionin dhe anën finaciare të organizatës.

f) Krijimi i një mjedisi etik të punës-zhvillimi në vazhdimësi i kodit etik të punës është vetëm një hap të cilin menaxherët duhet ta marrin, si hap tjetër është edhe përcaktimi i shefit apo menaxherit përgjegjës për etikën në organizatë, si detyrë kryesore e tyre është që të sigurojnë inegrimin e etikës në tërë organizatën me vendimet e përditshme në të gjitha nivelet e organizatës, menaxheri ndihmon në zbatimin si dhe përmirësimin e

strategjive që synojnë integrimin e sjelljeve etike në të gjitha fazat e operacioneve që kryen organizata. Mënyrë tjetër për të promovuar etikën në mjediset e punës është të sigurojë trajnimin e punëtorëve të organizatës. Si një ndër detyrat e menaxherëve të etikës është që të krijojnë kushte të tilla pune që u imponojnë punëtorëve sjellje etike dhe që të minimizojnë kushtet që lënë hapësirë për një sjellje joetike. Dy nga praktikatat më të zakonshme që stimulojnë sjelljen joetike janë: 1. Dhënia e shpërblimeve shumë të larta për performancë të mirë, dhe 2. Dënimet shumë të larta për performancë të keqe. Nga kjo kuptojmë se ekstremiteti çon në sjellje joetike, prandaj këto dy praktika duhet të eliminohen nga menaxherët.

Kodi i etikës i ndihmon njerëzit në veprimtarinë e tyre, por kur ndeshemi me një veprim etik personal në punë atëherë jemi në vetë vetë ata të cilët vendosim se si do të veprojmë për të bërë gjënë e duhur apo për të marrë vendime të drejta.

-Zgjedhja e një gjëje etike për të bërë përgjegjësi individuale, pra nuk duhet të themi që ajo nuk është punë e imja, sepse askush tjetër nuk duhet ta bëjë zgjedhjen për ju, prandaj duhet ndjekur parimet dhe rregullat të cilat pothuajse i zbaton edhe në shtëpinë tuaj,

-Analizo çdo situatë me kujdes dhe përgjegjësi individuale, identifikoj çështjet etike, krijo disa opsione dhe vendosni për atë që ju rrit vetërespektin, testoni çdo zgjedhje sipas standardeve tuaja të të kuptuarit të gjërave, të drejtësisë, ndershmërisë dhe të përkujdesit për të tjerët.

-Analizoni se si veprimet tuaja ndikojnë mbi njerëzit tjerë, mendoni se kush janë ata të cilët preken nga vendimi juaj si dhe çfarë ndikimi ka vendimi juaj mbi cilësinë e jetës së tyre, gjithashtu duhet të jeni sensitivë ndaj efektit që mund të keni tek njerëzit me të cilët ju punoni, pra fjalët dhe veprimet tuaja çfarë efekti mund të kenë .

Ndërmerrni veprime, sepse nëse nuk bëni asgjë nuk është zgjedhje etike.

Me qëllim që ta bëjmë sa më lehtë kuptimin etikës menaxheriale tani do të shpjegojmë dilemat etike të menaxherëve.

5.16 Dilemat etike në karrierën menaxheriale

Kur menaxherët ballafaqohen me dilema etike gjatë karrierës së tyre ndjekja e këtyre tre hapave është me rëndësi. Së pari të kërkojnë gjykimin e ekspertëve dhe mbështetjen e drejtë nga një rrjet i gjërë i njerëzve të cilëve menaxheri u beson, edhe pse nuk mund ta përjashtojmë faktin kur brenda këtij grupi të njerëzve mund të ketë të atillë të cilët një

praktikë e caktuar i duket si etike por për menaxherin është e diskutueshme, është etike apo joetike, në raste të tilla hapet rrethi i marrjes opinioneve prej miqve, kolegëve, dhe në rast nevojë edhe te ekspertë të fushës.

Së dyti, nëse është e nevojshme duhet të merren edhe veprime shitesë për ta sjellë gjendjen në një gjendje normale (edhe pse kjo gjendje ndoshta është shkaktuar nga persona të tjerë). Në raste të tilla menaxheri duhet të jetë bindës dhe të ketë faktet në dorë për të bindur se sjellja e të tjerëve është jo e përshtatshme apo jo konform rregullave ligjore.

Kur menaxheri e merr këtë veprim e vendos çështjen në qendër të vëmendjes së eprorëve të tij dhe përpiket që t'i bindë ata për të marrë veprime korrektuese apo për ta korrigjuar një veprim të mëhershëm, por nëse problemi etik vazhdon akoma atëherë mund të jetë i nevojshëm kalimi në hapin e tretë, i cili do të thotë ndërmarrja e veprimeve për ta mbrojtur vetveten. Veprimet për ta mbrojtur vetveten bëhen duke e argumentuar atë se çfarë po bën ,duke shtuar kujdesin të mos bëjë veprime ilegale dhe joetike. Si ide e mirë do të ishte të shkruarit e një memoje ku parashtrohen objektivat dhe bisedat e zhvilluara me të tjerët për çështjen e diskutueshme. Këtë hap të tretë menaxheri mund ta çojë edhe më tej duke biseduar edhe me punonjësit e tjerë për preokupimin e tij.

Të kërkuarit aktiv të një pune tjetër është hapi i mëtejshëm, i cili duhet të merret në konsideratë. Ajo që është më rëndësi në këto lloje të situatave që menaxheri të mos ndërmarrë apo të mos angazhohet në aktivitete ilegale.Të gjitha këto veprime së bashku të cekura më lartë, mbështesin faktin që menaxheri përpiket të eliminojë veshtirësitë etike në një organizatë qoftë organizatë private apo publike (shtetërore). Duke ju referuar këtyre të cilat u shpjeguan më lartë e kuptojmë se sa e rëndësishme është etika menaxheriale dhe etika morale në udhëheqjen e një biznesi afarist dhe në drejtimin apo organizimin e njerëzve punonjës (operativ) në një ndërmarrje të caktuar, por njëkohësisht e kuptojmë edhe rëndësinë e faktorit njeri apo të një menaxheri etik dhe të moralshëm dhe me aftësi menaxhuese, të cilat i përshtaten kohës aktuale ku përballemi me një zhvillim të hovshëm ekonomik dhe një konkurrencë të ashpër të tregut .²⁵

²⁵ Prof.Dr.Shyqyri Llaci-Manaxhimi.vep.,e cit ,fq 67-76, Tiranë 2010
Sqarim- Nëpër tekst ka përshtatje dhe shtesa nga autori i temës.

KAPITULLI VI

GLOBALIZIMI

6.1 Përshtatja e tregut të Kosovës ndaj globalizimit

Globalizimi është sfida më e madhe e shekullit 21, për shtetet në tranzicion dhe sfidimi i cili kërkon një kujdes shumë të madh të qeverive shtetërore në ruajtjen e ekonomive vendore. Çka kërkohet nga shteti me qëllim të një integrimi sa më të lehtë dhe gjithmonë duke i ruajtur ndërmarrjet vendore.

Mendoj se kërkohet ndryshim shumë i kujdesshëm në ndërtimin e politikave fiskale me qëllim të ruajtjes së prodhimeve vendore, por gjithmonë në trendin e zhvillimit të tregut të lirë. Globalizimi në shumë raste kuptohet si forcim dhe thellim i institucionalizimit të prodhimit, këmbimit dhe të zhvillimit në tërësi, që e kanë përcaktuar procesin e përhapjes së sistemit botëror, i cili rezulton me prezencën fizike të procesit dhe të modeleve të zhvillimit global. Në fazat e para të globalizimit kur shtetet eliminojnë barrierat doganore dhe kyçen në një treg të lirë, shumë nga bizneset private vendore falimentojnë për shkak të konkurrencës së fortë, dhe paaftësisë së tyre të përballjes me këtë konkurrencë. Globalizimi është tregues i faktit të sistemit ku integrimi bëhet në mënyra të ndryshme si shoqëri dhe qytetërime të ndryshme duke sjellë dhe kultura të ndryshme pa marrë parasysh fare vetitë e tyre autentike. Integrimi ekonomik sot është bërë çështje qendrore në marrëdhëniet bashkëkohore ndërkombëtare, pothuaj çdo qeveri e cilitdo vend i kushton rëndësi të veçantë marrëdhënieve ndërkombëtare e sidomos vendet në zhvillim apo vendet në tranzicion si është rasti i Kosovës, por sa munden që shpejt të integrohen në një treg global dhe sa me të vërtetë ndërtohet një treg i lirë, ku nuk ekzistojnë barrierat doganore dhe shumë barrierat dhe byrokraci të tjera. Këtë mund ta shohim në vitet në vijim pasi që tani për tani nuk mund të themi se kemi legjislacion dhe as politika fiskale integruese me të cilat do të mund të përballonim ekonominë globale apo globalizimin.

Integrimi i suksesshëm është njëri ndër gjeneratorët themelorë të rritjes ekonomike, në kuadër të integritimeve arrihet një mobilizim më i lartë dhe më fleksibil i fuqisë punëtore, sepse fuqia punëtore shtyn dhe orienton procesin e transformimit shoqërorë, drejt zhvillimit teknologjik.

Dihet mirëfilli se vendet të cilat janë treguar më të shpejta në përqafimin e politikave integruuese Evropiane (sepse Evropa është shtytësi kryesor i zhvillimit ekonomik global) kanë arritur një zhvillim më të shpejtë ekonomik. Shumë tregje të vendeve të ish sistemit socialist të cilat kanë pasur një ekonomi të kontrolluar nga shteti janë shkatërruar dhe janë integruar në sistemin e tregut të lirë të bashkimit evropian.

Analizat e shumë ekspertëve të ekonomisë kanë treguar se lëvizës i rritjes ekonomike dhe i zhvillimit në shtet në tranzicion është padyshim rikapitalizimi i teknologjiive ekzistuese mesatarisht të zhvilluara të industrisë së vendit gjë e cila iu ka mundësuar transformimin e shpejtë teknologjik dhe paraqitje të sukseshme në tregjet ndërkombëtare (psh, Çeki, Hungari, Slloveni etj).

Çka është në të vërtetë globalizimi-Globalizimi është një modus i zhvillimit bashkëkohor të botës i krijuar në funksionimin e tregut të lirë, përhapjes së demokracisë dhe respektimit të të drejtave njerëzore.”Bota pa kufij në të cilën dominon kapitali i papenguar”, por nuk mund të themi dhe nuk mohohen dallimet kulturore dhe civilzuese mes shoqërive, por theksohen dallimet individuale mes personave, çka do të thotë se këtu menaxherët e mirë të cilët kanë aftësi dhe njohuri të larta menaxhuese si në hulumtimin e tregut përpunimin i informatave dhe marrjen e informatës me kohë dallohen mes veti dhe njëkohësisht i zhvillojnë me lehtë dhe shpejt bizneset e tyre qoftë biznes prodhues qoftë biznes tregtar, sepse janë me afër realitetit dhe i pranojnë më lehtë ndryshimet (janë më koherent). Globalizimi çdo ditë e ma tepër po zhvillon kompleksitet dhe lidhshmëri të proceseve zhvillimore në botë, sepse me globalizim shteti apo qeveria e humb atë kontrollin e pavarësisë klasike të kontrollit.

6.2 Sfidat kryesore të globalizimit

Për shkak të ndryshimit të strukturës ekonomike, shoqërore dhe teknologjike në përmasa botërore, si dhe konkurrencës së ashpër të tregut, globalizimi është mjaft sfidues për shumë biznese vendore e në disa raste edhe vdekjeprurës apo shkatërrues. Prandaj nisur nga ky fakt kemi ende ide të ndryshme pro dhe anti globalizimit.

Grupet të cilat kanë dobi nga ndryshimet e globalizimit apo edhe mendojnë se ndryshimet globale sjellin efekte pozitive në zhvillimin ekonomik, apo ata të cilët mendojnë se i arrijnë më

lehtë qellimet e veta janë edhe pro ndryshimeve. Kurse ata të cilët mendojnë se për shkak të ndryshimeve humbin dhe nuk janë në gjendje t'u qëndrojnë ndryshimeve janë kundër. Ekzistojnë grupe të cilat janë plotësisht kundër këtij zhvillimi të ri global. Në vendet e industrializuara, grupet të cilat marrin ndihma sociale nga shteti janë kundër zhvillimit të ri global, sepse këto grupe janë grupi i parë humbës, pastaj si grupi i dytë humbës të cilët e kundërshtojnë janë punëtorët të cilët bëjnë punë krahu të cilët janë të pakualifikuar dhe gjysëm të kualifikuar, në industritë që i janë ekspozuar konkurrencës globale, këta punëtorë për shkak se janë të pakualifikuar i humbin vendet e punës. Zhvillimi i ri global po e humb edhe forcën e sindikatave të cilat i kanë mbrojtur të drejtat e punëtorëve, andaj nëse këto grupe e humbin forcën e tyre përgjithmonë, atëherë në zhvillimin e ri ekonomiko- shoqëror mund të priten konflikte dhe presione të rritura sociale. Kryesisht ky është argumenti kryesor i partive të majta politike.

Konfliktet dhe presionet mund ta sjellin edhe ndryshimin e shtetit nacional si dhe ndjenja e rrezikut për autonomi dhe sovranitet shtetëror, këto vështirësi pothuaj mund t'i ketë secili shtet në vetvete mund të sjellë edhe deri te ndjenjat nacionaliste dhe si të tilla mund të bëhen si lëvizje antiglobaliste. Procesi i homogjenizimit të cilin po e përcjell globalizimi po krijon dhe po nder gjithnjë e më shumë forcat tradicionale të nacionalizmit. Kështu që globalizmi po bëhet armik ideologjik i grupeve (grupet të cilat marrin ndihma sociale nga shteti si dhe punëtorët e pakualifikuar dhe ata të gjysëm-kualifikuar) të cilat po e përkrahin në mënyrë të veçantë orientimin nationalist. Rezistencë ndaj globalizimit kemi edhe te kultura e re globale. ku këta kundërshtues paraqiten në mbrojtje të kulturës nacionale dhe të disa vlerave shoqërore. Duke i analizuar këto të cilat u thanë më lartë mund të konstatojmë se njerëzit edhe më tutje do të jenë të ndarë rreth globalizimit disa do ta përkrahin disa do ta kundërshtojnë për shkaqe dhe arsye të ndryshme.

Por ajo që është më se e vertetë që dukuritë objektive të procesit të globalizimit të cilat po i ndodhin njerëzimit tani më askush nuk mund ta ndalojë. Ata të cilët janë çkyqur nga zhvillimi do ta kundërshtojnë për shkak të interesave materiale, këtyre mund t'u bashkangjitet edhe klasa e mesme në vendet e zhvilluara për shkak të vlerave dhe pikëpamjeve postmaterialiste, si dhe ato forca të ringjallura nacionalizmit tradicional dhe forcat e sovranitetit shtetëror. Të gjitha këto pro dhe anti globalizimit na mundësojnë të kuptojmë se globalizimi tani më është bërë çështje ideologjike.

6.3 Implikimet shoqërore që i shkakton globalizimi

Globalizimi krijon lidhje afariste jashtë kufijve shtetëror të një vendi, përhap inovacionet dhe zhvillon tipe të reja të marrëdhënieve shoqërore në largësi të mëdha, e gjithë kjo ndodh duke ju falënderuar zhvillimit të teknologjisë së informacionit, transportit dhe komunikimit të lirë të njerëzve mes veti. Përhapja e informatave të llojllojshme ka ndikuar që bota të duket më e vogël dhe më e arritshme, e cila ka si pasojë rritjen e aspiratave personale të njerëzve, por nëse këto aspirote apo synime të njerëzve nuk mund të arrihen atëherë kemi si pasojë frustrimin dhe pakënaqësitë e njerëzve. Për shembull, është vështirë të mendohet që kinezët mund ta arrijnë standardin amerikan të jetesës e që të mos e çrregullojnë seriozisht drejtpeshimin e tanishëm të resurseve dhe të kapaciteteve prodhuese. Përpjekjet për të arritur një standard të tillë jetësor me globalizimin si proces, sigurisht arrihen me shpejtësi nga mundësitë e plotësimit të tyre, sepse globalizimi së bashku me fenomenin e plakjes të shoqërive më të përparuara po i krijon disa fenomene interesante. Në shoqëritë të cilat po plaken është duke u rritur kërkesa për fuqi punëtore të re, kurse në anën tjetër globalizimi po përhap vlerat universale, vlera të cilat shumica e njerëzve të të gjitha vendeve gjithnjë e më shumë po i përvetësojnë si mënyrë të sjelljes dhe të organizimit perëndimor të jetës. Njerëzve në përgjithësi kjo dukuri kulturore e perëndimit u është bërë kryesore dhe gjithnjë edhe më e afërt.

Duke i parë keto dy trende po rritet dita ditës edhe nxitja e emigracionit të njerëzve nga vendet e pazhvilluara dhe vendet në zhvillim drejt vendeve perëndimore të zhvilluara në kërkim të një jete më të mirë dhe më të organizuar. Me këtë problem të emigracionit po përballet edhe Kosova për shkak të pasigurisë politike, standardet e ulëta të jetesës, zhvillimi ekonomik i ngadalshëm e shumë faktorë tjerë, janë shtytësit që rinia e Kosovës i mësyjnë vendet perëndimore duke rrezikuar shpesh edhe udhetime dhe kalime të kufijve në mënyrë ilegale, dhe me një rrezik mjaft të lartë.

Por edhe pse emigracioni po bëhet çdo ditë e më tërheqës edhe në pikëpamje kulturore i pranueshëm dhe i lehtë, por zhvillimi i teknologjisë së komunikimit po mundëson që procesi i asimilimit të jetë më i ngadalshëm krahasuar me periudhat e kaluara historike. Gjithashtu komunikimi me atdheun me familjen po bëhet çdo ditë e më i lehtë, sepse këtë po e mundëson interneti, por edhe çmimet e lira të biletave të udhëtimit nga aviokompanitë e ndryshme.

Nga i gjithë ky ndryshim po vërejmë se shoqëria po shkon drejt ndërtimit të një identiteti të ri si një proces i rëndësishëm për pjekurinë personale të njerëzve dhe është i lidhur me përkatësinë në grupet sociale, organizatat dhe shoqatat e bashkësive shoqërore në vendin ku jeton.

Identiteti është konstruksion shoqëror, i cili ndërtohet nga historia, nga gjeografia, nga biologjia nga institucionet produktive dhe riprodiktive, nga mbajtja kolektive e mendimit dhe paramendimet personale, nga aparati i forcës (shteti) si dhe nga religjioni. Njeriu gjatë këtyre trendeve globale takon njerëz të ndryshëm me kultura të ndryshme, dhe në rrjedhën e ndërtimit të identifikimit vepron edhe një dimension i ri i rrjetit shoqëror. Tani në veprim është krijimi i një identiteti të shumfishtë dhe kalimi nga identiteti nacional-shtetëro drejt identitetit global, proces ky i cili para qeverisë dhe politikës (të vendeve të ndryshme por edhe para qeverisë Kosovare) do të shtrojë kërkesa plotësisht të reja. Po e vërejmë se globalizimi ka një ndikim në rendin shoqëror të shteteve si dhe zhvillimi i teknologjisë (interneti) po e zbeh ndjenjen nacionale të shoqëritë e njerëzve të vendeve të ndryshme.

6.4 Ndryshimet politike si pasojë e globalizimit

Në qendër të pasojave politike të globalizimit kuptohet qëndron qeveria e shtetit nacional. Për shkak se rrethina e re globale dhe ndikimet e ndërlidhura transnacionale të cilat ndikojnë në kontekstin ndërkombëtar, po e detyrojnë edhe sjelljen e qeverive për sa i përket ekonomisë, të drejtës dhe ligjit, bashkëpunimi, pushteti dhe sovraniteti.

Procesi i internacionalizimit dhe i rirregullimit të kapitalit ,tregut të punës, e të tjera gjithnjë e më shumë po e dobëson autoritetin e intervenimit të shtetit nacional.

Prandaj në rrethanat e ditëve të sotme globale roli i qeverive është që të ndërtojnë politika fiskale sa ma tërheqëse për afarizëm dhe investime kapitale. Me qëllim që t'i nxisin investimet ato kryesisht po i miratojnë rregullat dhe ligjet transparente të cilat janë në harmoni me ato të vendeve evropiane, gjithashtu po e zhvillojnë infrastrukturën e komunikacionit dhe të komunikimit, si dhe po e arsimojnë fuqinë e vet punëtore nëpër vende të zhvilluara evropiane, me qëllim që të jenë më koherent me tregun global. I gjithë ky ndryshim dhe përshtatje vjen si nevojë e imponuar nga globalizimi.

Globalizimi po i ndan strukturat kryesore të shtetit modern, kjo po ndodh me praninë gjithnjë e më të madhe të ligjeve dhe rregullave ndërkombëtare në lëmin e të drejtave njerëzore dhe në mbrojtjen e ambientit. Prandaj qeveritë e vendeve të ndryshme janë të shtyra gjithnjë e më shumë

t'i koordinojnë veprimet në mes veti dhe ta rrisin bashkëpunimin global, e në këtë formë po rritet edhe ndërvarshmëria në mes të shteteve, dhe nga kjo mund të themi se tani shtetet kanë lidhshmëri dhe ndërvarshmëri në mes vete dhe nuk ka më pavarësi klasike shetërore siç ishte dikur.

Shtetet nacionale edhe më tej janë ndërmjetësuese mes nivelit lokal dhe atij global, ato edhe më tej do të kenë mbikëqyrje në territorin e vet dhe do t'i imponojnë ligjet dhe rendin, por gjithnjë ligjet dhe rregullat do të jenë multilaterale, kurse aspekti territorial do ta humbë rëndësinë (këtë rend me pak ndryshime e ka edhe Kosova). Me qëllim që të imponohen masat globale, institucionet globale shpesh ndërhyjnë në punët e shteteve, ky është edhe imperativi kryesor për ndryshime politiko-institucionale, si rast më i freskët është Kosova (2014) nëse qeveria dëshiron t'i rrisë pagat e punonjësve civilë paraprakisht duhet ta marrë miratimin nga FMN-Fondi Monetar Ndërkombëtar se a mundet dhe deri në çfarë përqindje mund t'i ngritë pagat, për ndryshe pasojnë sanksione sipas rregullave të caktuara.

6.5 Ekonomitë në tranzicion si pasojë e globalizimit

Globalizimi në përgjithësi ka imponuar rregulla të reja të zhvillimit për ekonomitë nacionale.

Pothuaj në të gjitha vendet qeveritë e vendeve dhe partitë opozitare i kanë ndryshuar programet e tyre me qëllim që ta inkuadrojnë realitetin e ri politik globalizimin. Posaçërsisht krijuesit e politikës dhe analistët e ndryshëm gjithnjë e më shumë po e pranojnë modelin neoliberal të zhvillimit me ekonomi të hapur me intervenime minimale të shtetit në tregun e lirë, duke inkorporuar rrjedhën e lirë të kapitalit dhe tregun fleksibil të punës si e vetmja paraqitje frytdhënëse në ekonominë e re globale. Por sa janë të rëndësishme politikat fiskale të cilat i ndjek shteti në këtë realitet të ri global?- Po i referohem një citati të Joseph Schumpeter: "Shpirti i ndonjë populli, niveli i kulturës së tij, struktura shoqërore e tij, veprat të cilat politika e tij mund t'i pergatitë, të gjitha këto dhe më shumë, janë të shkruara në historinë fiskale... Ai i cili di t'i dëgjojë këto porosi, ai e dëgjon qartë murmurimën e historisë botërore më shumë se kushdo tjetër".-Joseph Schumpeter.

Vendet gjatë tranzicionit (rasti Kosovës) i percjellin një mori problemesh të cilat duhen zgjidhur. Problemet kryesore të vendeve në tranzicion kanë të bëjnë zgjidhjen e strategjisë së

mirëfilltë zhvillimore. Kjo zgjidhje do të duhej të bazohej në përparësitë komparative dhe kompetitive të vendeve përkatëse, përvojat e tyre deri më tani po tregojnë që përkundër drejtimeve të qarta kah rritja e konkurrencës, rezultatet mes vendeve janë mjaft të ndryshme.

Disa shtete e kanë kaluar me sukses procesin e tranzicionit dhe i kanë avancuar reformat shoqëroro-ekonomike, dhe ato tani po ballafaqohen me problemet e kapitalizmit si sistem, në anën tjetër disa shtete po ngecin në këtë proces. Në Shqipëri ,p.sh. janë duke ngecur reformat shoqëroro-ekonomike dhe për këtë arsye është ngadalësuar procesi i tranzicionit dhe transformimit shoqëror (për shkak të mosmarrëveshjeve politike pozitive-opozitive). Në Maqedoni, për shkak të kundërthënieve politike mbi bazat etnike shqiptaro-maqedonase, si dhe problemi i emrit me Greqinë, procesi i reformave të filluara është ndërprerë dhe ekzistojnë mjaft vështirësi të fillojnë reformat e reja.

Kurse në Kosovë ku edhe e kemi theksin kryesor të këtij punimi doktoral, reformat shoqëroro-ekonomike mund të themi që ende nuk kanë filluar apo sapo kanë filluar për shkak të mungesës drastike të mjeteve finaciare, dhe të mosnjohjes së shtetit tash e 7(shtatë) vjet nga faktori ndërkombëtar dhe byrokracitë, procesi i transformimit në tërësi është në një ngecje të plotë.

Presionet globale në vendet në tranzicion janë të shumfishta ku ekonomia është vetëm një nga shumë kërkesat tjera. Standardet e caktuara nga vendet e Bashkimit Evropian të cilat janë strikte kërkojnë një rregullim ekonomik-shoqëror sipas standardeve të caktuara të cilat duhen të plotësohen me qëllim që vendi i cili është në tranzicion të vlerësohet nga Pakti për stabilizim asocim si parakusht për integrim në Unionin Evropian.

Vendet e vogla si Kosova, tranzicioni është nevojë e përshtatjes më të shpejtë ndaj rrethanave të reja të procesit të globalizimit i cili është duke ndodhur në tregjet botërore.

Duke parë edhe nga përvoja e vendeve tjera se kriteret dhe përshtatja varen nga shpejtësia e realizimit të reformave shoqëroro-ekonomike, prioritetet dhe qëndrueshmëria e masave reformuese të cilat menaxhohen nga qeveria përfundimisht e përcaktojnë suksesin e reformave.

Shpejtësia e reformave ekonomike varet edhe prej partive opozitare pasi që kërkojnë konsensus më të gjërë të votimit të ligjeve në parlament.

6.6 Si ta fillojmë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Kosovë

Globalizimi në shekullin XXI është thirrje për kombet, për ndërmarrjet, vendet e punës dhe jetën e njerëzve në përgjithësi. Rrjedha transnacionale e lirë e ideve, e informatave, e dijes, njerëzve, kapitalit e të tjera po e krijon një drejtim të ri të zhvillimit ekonomik në tërësi. Është çështje e

veçantë për ekonominë dhe shoqëritë e vendeve në tranzicion që në harmoni me rrethanat e veta ekonomike, civilizuese të trashëgimisë kulturore si dhe të specifikave natyrore dhe prodhuese të nxisin një zhvillim të atillë ekonomik i cili do të paraqet lidhshmërinë me zhvillimin e trendit ekonomik bashkëkohor global. Zhvillimi i një vendi do të ishte shumë më racional sikur të nixtej nga tregu dhe demokracia vendore në të gjitha nivelet e prurjes së vendimeve ekonomiko-zhvillimore.

Duke i parë këto rrethana çështje prioritare për ekonominë e Kosovës është si të fillohet loja e zhvillimit të ekonomisë së tregut të lirë. Kosova ka përjetuar një deindustrializim të të gjitha kapaciteteve ekzistuese industriale prej viteve të 90-ta nën okupimin serb. Tani Kosova po përballlet me mungesë të akumulimit të kapitalit dhe me një shkallë jo reale të kamatave, këta janë vetë disa indikatorë të cilët po ndikojnë në shkallën shumë të ulët të investimeve ekonomike.

Në Kosovë kemi sistemin bankar të zhvilluar mjaft mirë dhe kemi kredi të këqija në një masë mjaft të vogël, edhe pse e kemi këtë zhvillim bankar mjaft të suksesshëm mund të themi se nuk ka ndikuar në zhvillimin ekonomik të bizneseve, sepse kemi kamata mjaft të larta të cilat po u krijojnë vështirësi biznesve në zhvillimin e tyre dhe në kthimin e kredive.

Procesi i tranzicionit dhe i transformimit është proces mjaft i gjatë i dhimbshëm dhe i mundimshëm, i cili shkakton shpenzime të larta shoqërore. Prandaj si mundësi ndër të paktat mundësi është investimi i kapitalit të huaj (të jashtëm) si domosdoshmëri pa të cilin ekonomia e Kosovës vështirë se mund ta ketë ndonjë rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, në kushtet e ekonomisë së tregut. Investimet e huaja drejtpërdrejt ndikojnë në zbutjen e papunësisë (ku në Kosovë shkalla e papunësisë sillet mbi 45%), sigurimin e tregjeve të jashtme, ardhjen e teknologjisë së re në prodhim dhe shërbime, do të përmirësojnë të hyrat buxhetore të vendit.

Për këto arsye Kosova duhet të krijojë kushte shumë të volitshme administrativo-ligjore duke u ofruar politika fiskale të favorshme dhe siguri të mjaftueshme të zbatimit të ligjit, me qëllim të ofrimit të sigurisë për kapitalin e investuar. Kosova ka një përparësi për kompanitë të cilat vijnë në Kosovë për të investuar, sepse ka një popullsi mjaft të re ku moshë mesatare sillet rreth 28 vjeç, por mangësitë janë sepse janë të pakualifikuar apo gjysëm të kualifikuar.

Kosova duhet me shpejtësi ta jetësojë ligjin për nxitjen e investimeve të jashtme, sepse kjo mund të themi se paraqet edhe bazën e tërheqjes së investimeve nga jashtë. Ardhja e korporatave dhe investimet e tyre në ekonominë e varfër në tranzicion të Kosovës potencialisht do të shpejtonte rritjen dhe vëllimin e prodhimit, do ta forconte aftësinë konkurruese të

ndërmarrjeve vendore si dhe do ta rriste eksportin vendor. Nisur nga përvojat botërore kapaciteti i qeverive në qeverisjen e ekonomisë drejt qëllimeve ekonomike nacionale përmes politikave fiskale dhe politikave për mbrojtjen e ambientit janë të mbështetura në forcën e korporatave transnacionale, edhe për vet faktin që tani shumë prodhime të këtyre korporatave të jashtme i kanë produktet e tyre në tregun e Kosovës, andaj ardhja e filialeve të këtyre korporatave për të prodhuar në Kosovë është më se e kuptueshme se është me interes për këto korporata.

Ligji për investime i siguron dhe i mbron investimet vendore dhe të huaja dhe praktikisht intensifikohen mundësitë për partneritet ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe investuesve potencil vendorë dhe ndërkombëtarë, por përveç ekzistimit të ligjit kërkohet edhe seriozitet dhe siguri në zbatim të ligjit drejt dhe pa vonesa byrokratike.

Masat nxitëse përmes lehtësimeve tatimore dhe doganore ndihmojnë në tërheqjen e investimeve si dhe inkuadrimin e ekonomisë Kosovare në tregun e këmbimeve ndërkombëtare, përmes kësaj do të arrihet që ekonomia e vogël e Kosovës të jetë ekonomi e hapur e cila do të jetë në ndikimin e proceseve zhvillimore të ekonomisë globale. Kjo masë do ta përshpejtonte procesin e tranzicionit dhe ristrukturimit ekonomik modern, si dhe do të fillonin reformat shoqëro-ekonomike të domosdoshme për integrim më të shpejtë të ekonomisë Kosovare në Unionin Evropian. Prandaj e vetmja alternativë për ringjalljen e ekonomisë së Kosovës janë investimet direkte të huaja dhe vendore (duke llogaritur në kapitalin e Kosovarëve në diasporë).

6.7 Globalizimi dhe rreziku nga mallrat e falsifikuara

Kosova duke mos pasur mundësi kontrolli të mirë për të gjitha mallrat të cilat hyjnë në Kosovë rrezikohet mjaft shumë nga mallrat e falsifikuara dhe të dëmshme për shëndetin e popullsisë vendore. Duke u nisur prej kohës së pasluftës së UÇK-së në vitin 1999 e deri më sot (me pak përmirësime) pothuaj që në Kosovë kanë ardhur mallra të ndryshme të falsifikuara duke filluar që nga data e skadimit ndërrimi ose falsifikimi i markave e deri te mishi industrial, mallrat të cilat kanë hyrë nëpër pika doganore, por pa një kontroll adekuat e deri te mallrat të cilat në Kosovë kanë hyrë ilegalisht, andaj konsumatori kosovarë sot fare nuk mund ta dallojë çka është origjinale e çka e falsifikuar. Kosova është vend i cili importon 95%, në raport me eksportin, dhe se në këtë përqindje mallrat e konsumit të gjërë kanë pjesëmarrje mbi 60% të mallrave të tërësishme të importuara. Edhe sot e kësaj dite askush nuk mund të thotë me saktësi e as

përafërsisht se çka po ndodh me prodhimet ushqimore dhe me barnat e importuara dhe rezikun e shkaktuar në shëndetin e popullsisë vendore. Ashtu siç e dimë në Evropë shteti më problematikë (kur është fjala për falsifikime të markave të ndryshme të të drejtave autoriale) është Turqia, e ç'është e vërteta Kosova tregtinë më të madhe e zhvillon me Turqinë sidomos në tekstil, por viteve të fundit sidomos prej vitit 2010 ka një rritje shumë të madhe edhe në mallra ushqimore, mallrat të cilat shpesh kanë origjinë të dyshimtë ku do t'i krahasoja me mallrat apo mishin i cili vjen nga Brazili në Kosovë. Nëpër tregjet e Kosovës dhe nëpër qendrat tregtare më të mëdha nëse kërkon tekstil (veshmbathje) atëherë mbi 80% ke për të blerë tekstil të Turqisë me marka të dyshimta apo komplet të falsifikuar, Nëse kërkon mish të pulës apo edhe mish të gjedhit atëherë mbi 70% ke për të blerë mish të importuar nga Brazili me afat të dyshimtë, por edhe me cilësi të dyshimtë, shpesh me rrezikun që mund të jetë kancerogjen.

Duke i parë këto rreziqe nga tregu i hapur qeveria duhet të marrë urgjentisht masa të një kontrolli shumë më të rreptë për kontroll të cilësisë nëpër pika doganore, kur them se duhet kontroll i rreptë nuk aludoj në rritje apo vënie të barrierave, por kontroll e cila duhet t'u përmbahet standardeve të domosdoshme Evropiane.

- Pse duhet Kosova të tregojë kujdes në marrjen e vendimeve afariste gjatë nëshkrimit të marrëveshjeve për tregti të lirë dhe në zbatim të reciprocitetit me shtetet në rajon?

Këtë pyetje e kam ngritur me qëllim që të japë një përgjigje në aspektin e interesit nacional, i nxitur nga marrëveshja e nënshkruar në vitin 2013 në mes të Kosovës dhe Turqisë, në vitin të cilin e kemi kaluar dy qeveritë respektive e Kosovës dhe e Turqisë nënshkruan marrëveshje për tregti të lirë në mese veti çka do të thotë se brenda vitit 2013 Kosova ka eksportuar mallra të ndryshme (duke e llogaritur edhe hekurin për skrap) për në Turqi në vlerën rreth 20 milion euro kurse ka pasur import nga Turqia apo Turqia ka eksportuar në Kosovë mallra të ndryshme mbi 200 milion euro, atëherë duke e bërë një llogaritje të shpejtë ku dogana në Kosovë është 10% në hyrje nëse e llogaritim 200 milion vlera e mallit atëherë i bie që Kosova nga kjo marrëveshje jo nuk ka përfituar asgjë prej gjëje, por edhe ka humbur 20 milion euro të hyra në vit.

Andaj ky fakt na bën të kuptojmë se ne nuk është menduar mirë dhe nuk i kontribuon fare në zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Reciprociteti-Si shembull , shteti i Maqedonisë vendos barriera apo ndalon hyrjet e mallrave bujqësore të Kosovës (domatet) në Maqedoni edhe pse të dyja vendet janë nënshkruese të marrëveshjes së CEFTA-s për tregti të lirë, kurse Maqedonia pothuaj gjatë gjithë vitit i fut në

Kosovë mallrat e veta pa u penguar nga askush (në kohën e Kosovës të administruar nga UNMIK-u Maqedonia edhe bananet i ka eksportuar në Kosovë si prodhime vendore made in Maqedonia ku tatimohen vetëm me 1% doganë), kjo tregon më së miri për pasojat që mund t'i ketë një vend nga tregu i lirë, në falsifikim të mallrave dhe pasojat e marrjes së vendimeve të pa analizuara mirë .²⁶


6.8 Krisja e re midis “pro” dhe “anti” globalizimit

Që prej disa vitesh jemi dëshmitarë që e gjithë vëmendja është kthyer drejt çështjes së globalizimit ekonomik, ndërvarësisë së sistemeve kombëtare të prodhimit dhe shkëmbimit, të financiarizmit të botës, ku kriza e subprimeve amerikane në vitin 2007 tregoi qartë shtrirjen e tij. Në çështjen e globalizimit apo të tregut global të ekonomisë vijnë në shprehje kostoja më ulët e krahut të punës, humbja efikasitetit të rregullave kombëtare fiskale e juridike si dhe dobësimi i idesë së sovranitetit klasik shtetëror, pastaj kemi daljen e Kinës dhe Indisë në skenë si aktorë të rinj të fuqishëm në ekonominë globale të cilat u bëjnë konkurrencë ekonomisë amerikane dhe ekonomisë evropiane, pra aspekte të ndryshme të globalizimit ku zënë me të drejtë vendin e parë në media, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke e parë një shpjegim të autorit Pierre Calame nga ideatorë të ndryshëm (si Rene Passet dhe Martin Wolf) të krahut pro globalizimit dhe antiglobalizimit autori nxjerr në pah ndarjen e disa mendimtarëve të cilët janë për kontrollin e shtetit mbi ekonominë dhe se ishin të mendimit se kolektivi apo shoqëria kishte përparësi mbi individin. Secili nga këta kërkonte të merrte pushtetin dhe pikërisht kjo i bëri shumë të rrezikshëm.

Në pyetjen time drejtuar qytetarëve të Kosovës për Globalizimin, a jeni pro apo kundër, përgjigja ishte kjo shiko grafikun:

²⁶ Dr.Sc Bedri Selmani- Globalizimi-tranzicioni dhe integrimet (refleksionet në Kosovë) f,159-197. Botues Albanica dhe Zenith Lubjanë-Prishtinë 2006. Sqarim;Nëpër tekst ka nderhyrje nga autori i temës ,për qëllime të përshtatjes.



6.9 Globalizim apo ndërkombëtarizim?

Duke parë ide të ndryshme pro dhe kundër globalizimit mund të themi se globalizimi i ekonomisë në 50 vitet e fundit të shekullit tonë ka qenë i dobishëm, si: p.sh përdorimi i internetit, zhvillimi i transportit, lëvizja e lirë e njerëzve etj. Të gjitha këto ndryshime kanë pakësuar rrjedhshmërinë e hapësirës, kanë ulur koston e mallit dhe kanë rritur konkurrencën përmes asaj që quhet tregu i lirë, e cila nga konkurrenca e tregut është rritur edhe cilësia e produkteve .

Si rrjedhim i kësaj po zhvillohet gjithnjë e më shumë sektori i shërbimeve, ku shërbimet publike dhe private po zënë një vend gjithnjë e më të madh, por në disa raste këto shërbime janë të

lidhura nga natyra me popullsi dhe terriore të lokalizuara (arsimi, shëndetësia, kujdesi ndaj të moshuarve) në funksion të popullsisë aktive etj.

Këto ndryshime teknike përmbajnë një potencial të ri të globalizmit ekonomik p.sh. shërbime të ndryshme nga Azia në Evropë, Afrika në Azi, Evropë- Kinë, Indi etj. Të gjitha këto janë rezultate të Globalizimit ekonomik (hapjes së tregut të lirë global).

Nisur nga shembulli i Evropës së një ndërtimi të një tregu të lirë të ekonomisë, heqjes së barrierave ekonomike e shoqëruar me një vullnet politikë të BE-së tregon më së miri zhvillimin e vendeve të integruara në treg të lirë siç janë: Spanja, Portugalia. Irlanda etj.

Por kur jemi te globalizimi i ekonomisë duhet ta kuptojmë se disa ndërmarrje mund të falimentojnë, sepse nuk janë të përgatitura për ta përcjellur trendin e zhvillimit botërorë si për nga cilësia në produkte, si për nga kostoja e produktit por edhe nga mospërgatitja adekuate e stafit (faktorit njeri).

Nisur nga njohuritë e përgjithshme rreth globalizimit të ekonomisë, duke parë që globalizimi ka bërë që rritja ekonomike në vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim të përmirësohet në të shumtën e rasteve pajtohem me autorin dhe jam pro globalizimit të ekonomisë dhe lëvizjes së lirë të mallit dhe njerëzve.²⁷

6.10 Anti dhe alterglobalizmi

Nisur nga fakti se në botë globalizimi nuk perceptohet vetëm si histori suksesi ose burimesh pozitive zhvillimi. Paralelisht me përkrahësit e tij janë shfaqur edhe kundërshtarët e tij.

Thelbi i kundërshtarëve është i dyfishtë, krahu më ekstrem janë antiglobalistët të cilët globalizmin e proklamojnë si të keqen më të madhe të njerëzimit si fenomen me të cilin po përballet bota, me shkakun kryesor të përdorur nga ata mosbarazinë në shoqëri dhe si rrjedhojë ky krah apo kjo klasë e njerëzve e luftojnë globalizimin në të gjitha mënyrat shpeshherë janë mjaft të dhunshëm, kundërshtojnë çdo element të globalizmit, por me theks të veçantë e kundërshtojnë globalizmin ekonomik, financiar, politik dhe kulturor.

²⁷ Pierre Calame-Ekonomia në shek.XXI pikpamje analiza reflektive 2011,f 41-49.
A.Civici- Ligjerata doktorale-Prishtinë 2012.

Ndërkohë në një pozicion më të moderuar të kundërshtimit të globalizmit janë rryma apo krahu i quajtur “alterglobalistë” ,rrymë e cila e pranon globalizimin si fenomen të pashmangshëm të zhvillimit të botës që njih meritat dhe mundësitë e tij për ta ndihmuar njerëzimin që të ecë përpara, por është terësisht kundër mënyrës se si menaxhohet globalizimi. Alterglobalistët përpiqen për të krijuar një globalizim më human një globalizim në favor të të gjithëve dhe jo një globalizim me përfitime të njëanshme. Përballë këtij globalizimi të egër dhe të kontrolluar nga vendet e zhvilluara, që e menaxhojnë në funksion të interesave të tyre, alterglobalistët përpiqen të ndërtojnë modelin e tyre alternativ të zhvillimit, të cilin e lidhin shumë ngushtë me problematikën e mjedisit, të varfërisë të pabarazive sociale dhe ekonomike, dhe përpjekja e tyre është që të arrijnë të bëhen një lëvizje e institucionalizuar në nivel botëror, krahas këtyre përpjekjeve po synojnë që të rekrutojnë figura apo njerëz me ndikim nga më të shquarat të fushave të ndryshme të shkencës, të politikës dhe të shoqërisë civile me qëllim që të jenë sa më konkret dhe bindës në platformën e tyre.

6.11 Historia dhe përbërja e alterglobalistëve –Lëvizja alterglobale lind në fund të viteve të 70-ta të shekullit XX kryesisht në vendet e quajtura të jugut apo siç jemi mësuar t’i identifikojmë më mirë vendet në zhvillim, si një formë e protestës kundër borxheve të OBT-së (Organizata Botërore e Tregtisë) si dhe programit të axhustimit strukturor të FMN-së (Fondi Monetar Ndërkombëtar),etj. Në Evropë dhe në SHBA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës) kjo lëvizje u shfaq për herë të parë në vitin 1994 në kuadër të kritikave të forta kundër papunësisë, kundër kushteve të punës dhe të mbrojtjes sociale. Në vitin 1999 alterglobalistët shënuan manifestimin më të mediatizuar në shkallë ndërkombëtare, pastaj më vonë ato u shoqëruan nga shumë evenimente sociale botërore, kontinentale e lokale si “Forumi social botëror”i parë si një organizëm alternativ i “Forumit ekonomik botëror” të Davosit, formës sociale të Gjenevës, të Porto Alehres, të Firences, të Athinës, të Mumbait (Kongo) e tjera.

Alterglobalistët u konturuan si një lëvizje e shoqërisë civile e cila e konteston modelin liberal të globalizimit dhe e cila e rivendikon (rivendos) një model zhvillimi më të afërt me zhvillimin human, parimit të barazisë në zhvillim dhe të mbrojtjes së natyrës.

Në thelbin e alterglobalistëve, qëndrojnë pozicionet e përbashkëta për “drejtësi ekonomike “, autonominë e popujve në vendimet e zhvillimit ekonomiko-social”,”mbrojtjen e mjedisit”, thellimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe respektimin real të të drejtave themelore të njeriut”, etj. “Termi “ alter (ndryshe) u fut për herë të parë në vitin 2001 me qëllim të dallimit nga termi “anti”(kundër) i cili kishte mbizotëruar në fillim të kësaj lëvizjeje.

Lëvizja alterglobale përbëhet prej shumë grupeve të ndryshme nën flamurin e vet. Ajo përmbledh: fshatarë, punonjës të varfër, përfaqësues të borgjezisë së vogël të vendeve në zhvillim, punonjës me paga të ulëta nga vendet e zhvilluara Perëndimore, sindikata të ndryshme të punëtorëve, shoqata të konsumatorëve, grupime mësuesish dhe kërkuesish, lëvizje ekologjiste, lëvizje antimilitariste, grupime militante feministe, rryma komuniste marksiste, nacionaliste, përkrahës të teorisë së Kejnsit, anarkiste e të tjera e të tjera. Prandaj për vet faktin se në vetvete mban shumë lëvizje të ndryshme, kjo lëvizje shpesh quhet edhe si “lëvizja e shumë lëvizjeve ose grupimeve”.

Orientimet shumë të ndryshme politike e bëjnë këtë lëvizje të veshtirë për t’u profilizuar, por me gjithë diversitetin dhe heterogjenitetin e saj, fenomen i cili e ka penguar lëvizjen alterglobaliste të prodhojë një program politik të qartë dhe gjithpërfshirës me qëllim të orientimit unik, kjo lëvizje ka kristalizuar tashmë si orientim të përbashkët “luftën sociale në favor të një zhvillimi të arsyeshmëm” dhe njëkohësisht ka përcaktuar si kundërshtar të saj ideologjik “neoliberalizmin”.

Kritikat e alterglobalistëve bazohen në faktin se diferencat në nivelin e jetesës janë thelluar shumë në favor të vendeve të zhvilluara, dhe se hendeku në mes të varfërve dhe të pasurve po thellohet me shpejtësi, dhe se pasiguria ekologjike dhe ndotjet industriale po bëhen të frikshme, si dhe efekti serrë nuk po ndalet. Alterglobalistët akuzojnë kompanitë e mëdha financiare dhe tregtare ndërkombëtare se drejtpërsëdrejti ose në mënyrë indirekte favorizojnë më shumë interesat private sesa interesin e përgjithshëm në fushën e bioteknologjive, në zbatim të protokollit të Kyotos.

Alterglobalistët konsiderojnë se globalizimi nëpërmjet tregut nuk është sinonim i zhvillimit human, se nga tregu nuk përfitojnë në mënyrë të barabartë të gjithë, dhe se rritja e pabarazive dhe e varfërisë në botë janë efektet perverse të “tregut të lirë global”. Në mënyrë të veçantë, alterglobalistët denoncojnë pabarazinë në rritje në mes të varfërve dhe të pasurve. Sipas tyre “tregu e redukton njeriun dhe karakterin e tij vetëm në vlerat tregtare”, dhe se drejtimi i ekonomisë së vendeve të varfëra dhe atyre në zhvillim nuk është fryt i ligjeve ekonomike natyrore e as dëshirë e popujve të këtyre vendeve, por është fryt i politikave të qeverive të tyre që ndodhen nën diktatin e vazhdueshëm të institucioneve ndërkombëtare si FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar), OBT (Organizata Botërore e Tregtisë) etj. Natyrisht që mendimet dhe propozimet alterglobaliste paraqesin “anën tjetër të medaljes “që ka shkaktuar dhe vazhdon ende të shkaktojë reagime e kundëargument të majft ekspertëve, përfaqësuesve e organizmave ndërkombëtarë, pasuesve dhe mbrojtësve të doktrinë liberale. Por ajo që konsiderohet pozitive

në këtë rrymë të mendimit dhe veprimit, është se ajo provokoi dhe vazhdon ende të provokojë një reflektim intelektual shumë të domosdoshëm për situatën e botës dhe persepektivën e saj. Partizan të reformimit rrënjësor të OKB-së, debati i hapur në Bankën Botërore nga neoklasiket si Joseph Stiglitz.²⁸

6.12 Kosova në prizmin alterglobal

Duke i parë këto veprime të alterglobalistëve dhe të antiglobalistëve të cilat i shpjegojmë më lartë po mundohem që ta tërheq një paralele me veprimet e sindikatave të punëtorëve nëpër ndërmarrjet publike të cilat menaxhohen nga AKP (Agjensioni Kosovar i Privatizimit).

Prej vitit 2008 kur edhe ka ndodhur Pavarësia e Kosovës ku të gjitha ndërmarrjet shoqërore dhe publike deri në atë kohë menaxhoheshin nga AKM (Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit) nën administrimin e UNMIK-ut, nga kjo kohë, pra nga viti 2008 tani këto ndërmarrje administrohen nga AKP-ja (Agjensioni Kosovar i Privatizimit) prej vitit 2008 e deri (më sot) në 2014 ne kemi vërejtur shumë parregullsi, si nga forma e privatizimit, nga mungesa e ideve për ta shfrytëzuar privatizimin drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm, në tërheqjen e investimeve të huaja, në tërheqjen e brendeve të ndryshme Botërore dhe Evropiane, mund të themi lirisht se ka pasur të interesuar shumë ndërmarrje të fuqishme botërore dhe shumë emra të njohur të skenës së biznesit dhe të politikës të rangut Botëror dhe Evropian, çka po të shfrytëzoheshin me mençuri ofertat e tyre, sot në Kosovë do të kishim Brende apo Marka të njohura dhe numrin e të papunëve do ta kishim shumë më të ulët.

Privatizimi në Kosovë është udhëhequr në bazë të parimit kush jep çmim më të lartë është edhe fituesi, por me kalimin e viteve kjo u dëshmuar që ka qenë gabim shumë i madh dhe unë kisha me thënë i pafalshëm dhe vështirë i përmirësueshëm për të mos thënë i papërmirësueshëm, sepse ekonomia private e Kosovës edhe ashtu mjaft e dobët nga dëshira për t'i poseduar këto pasuri hynë në garë dhe blen një pjesë aq sa kishin mundësi duke i tërhequr paratë e gatshme nga biznesi dhe duke marrë kredi nëpër banka komerciale të Kosovës me kamata mjaft të larta dhe aspak zhvillimore.

Bizneset të cilat kanë privatizuar apo kanë blerë prej AKP-së (Agjensioni Kosovar i Privatizimit) kryesisht mbi 80 % e tyre nuk kanë mundur të zhvillohen në trend me kërkesat e kohës dhe në vazhdimësi kanë shkuar drejt lodhjes e jo drejt suksesit. Çka ndodhi pastaj? Ndërmarrjet të cilat

²⁸ Adrian Civici-Globalizimi...Ante portas 2012 f,90-98.

u shiten paratë e grumbulluara nga shitja një kohë u ruajtën si një thesar i mbyllur më vonë u dhanë kredi me kamata shumë të ulëta vjetore vendeve Evropiane, çka do të thotë se nuk pati asnjë efekt zhvillimor në ekonominë e Kosovës, prej këtyre parave nga shitja e ndërmarrjeve 20% u takojnë punëtorëve të cilët kanë qenë të punësuar deri në momentin e shitjes së ndërmarrjes. Punëtorët këtë vlerë 20% e cila u takonte sipas ligjit të privatizimit në Kosovë në shumë raste e kanë marrë me vonesa të mëdha me vite, por ka edhe shumë raste të cilët nuk i kanë marrë ende për shkak të byrokacive të ndryshme qeveritare dhe neglizhencës fare të paarsyeshme .

Duke i parë këto vështiresi u rrit pakënaqesia e punëtorëve të cilët formuan sindikatat e pavarura nëpër këto ndërmarrje dhe filluan edhe protesta për ta penguar privatizimin në disa raste ishin komplet si antiprivatizim dhe njëkohësisht edhe antiglobal e në disa raste tregoheshin si alterprivatizim dhe alterglobal njëkohësisht, duke mos u pajtuar me formën e privatizimit këta punëtorë filluan ta fitojnë përkrahjen e popullsisë dalangadalë dhe fituan edhe përkrahje nga klasa politike, duke e bërë për vete opozitën në shumë raste. Në debate të shumta të cilat u zhvilluan në parlamentin e Kosovës asnjëherë nuk u tha se ishin kundër privatizimit, por ishin për një privatizim më ndryshe .


Andaj nga Politikat Fiskale jo të favorshme të qeverisë dhe serioziteti jo i duhur në sigurimin e kapitalit, sot kemi edhe tërheqje nga gara të shumë kompanive të huaja.

Rasti i fundit është rasti PTK-së (Posta dhe Telefoni i Kosovës), ku për herë të tretë dështon privatizimi tregon për një joseriozitet të qeverisë, dhe për humbjen e besueshmërisë për të tërhequr kapitalin e huaj, në herën e tretë kishim kompani mjaft serioze nga Gjermania dhe nga Amerika ishte Konzorciumi i ish sekretares së shtetit Amerikan Madeleine Albright. Punëtorët e kësaj kompanie ishin kundër privatizimit si pasojë e humbjes së besimit nga dështimi e dy herave të para.

Nga kjo e cila u tha më lartë kuptojmë se në Kosovë me prioritet ka qenë çmimi e jo projekti zhvillimor ekonomik apo tërheqja e brendeve të njohura botërore, ku përmes këtyre brendeve të caktuara ne do të mund të përfitonim në rregullimin e imazhit të shtetit tonë, do të rritej eksporti i mallit do të ulej papunësia dhe çka është më e rëndësishmja do të ishim më të sigurtë në konsumimin e gjërave ushqimore, ku si pasojë do të kishim mallra të falsifikuara më pak edhe sëmundje nga produktet me origjinë të dyshimtë do të kishim më pak në treg, sepse do të ishin përmbushur nevojat prej filialave të ndërmarrjeve të mëdha botërore të cilat do të kishin prodhuar në Kosovë.

Sikur Qeveria e Kosovës ta kishte orientuar privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore në bazë të projekteve investive me siguri që sot do të kishim gjendjen ekonomike shumë më të favorshme dhe të hyrat në buxhet do t'i kishim shumë më të larta.

Në pyetjen time drejtuar qytetarëve të Kosovës se çfarë mendoni për privatizimet që janë bërë nga AKM-ja dhe Tani AKP-ja kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik, përgjigja ishte me sa vijon:



6.13 Globalizimi Financiar

Krahas globalizimit të tregut po e vërejmë edhe globalizim financiar, ku si shembull konkret është përdorimi i valutës Euro në pjesën dërmuese të Evropës. Ekspertët ekonomiko – financiar dhe liderët politikë të botës po nxjerrin konkluzione për efektet domino të globalizimit në raste të krizave, globalizimi pothuaj i ka vendosur në të njëjtën anije lundruese, dhe çdo krizë finaciare në një vend prek menjëherë edhe vendet tjera.

Kriza e bursave dhe e tregjeve financiare në fund të vitit 2008 në SHBA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës) i ka bërë të mendojnë dhe të frikësohen për skenarin e mundshëm të krizës së madhe botërore 1929 – 1932. Aq kritike dukej gjendja në shumë institucione finaciare amerikane, evropiane, kineze e japoneze sa që shumë nga drejtuesit dhe aksionarët e tyre po i referoheshin katastrofës së kapitaleve që ndodhi në Azi dhe në Lindjen e Mesme në vitet e 90 – ta të shekullit të kaluar. Bursat kryesore finaciare të botës e filluan javën me kuotat më të ulëta në aktivitetin e tyre, dhe u cilësuan si “seanca katastrofike”.

Gjatë gjithë fund vitit 2008 dhe fillimit të vitit 2009, bursat e Frankfurtit, Parisit, Londrës, Milanos, Amsterdamit, Madridit, Zyrihut, Wall Street, Dow Jones, Nasdaq, Moskës, Torontos, Sao Paolos, Bueneos Aires, Santiagos, Bogotas, Meksikos, Hong Kongut, Shangait, Tokios, Xhakartës, Seulit, Bombeit, Dubait, Dohas etj., pothuaj të gjitha bursat e mbarë botës hapen dhe funksionojnë duke humbur vlera mjaft të mëdha nga kursi i tyre normal.

Shifrat prej miliona dollarëve, pound, yen, dhe euro të humbura brenda ditës nga bankat më të mëdha amerikane, evropiane, kineze, e japoneze, shkaktuan panik dhe frikë të përgjithshme për atë që mund të ndodhte gjatë vitit 2009 dhe 2010, recesion dhe krizë ekonomike – financiare botërore (globale).

Ndikimi i krizës finaciare në Kosovë

Kjo krizë finaciare botërore ndikoi edhe në Kosovë, në ekonominë kosovare, edhe pse Kosova nuk ishte drejtpërdrejt e kyçur me kapitalin e vet në ndonjë prej bursave botërore, kriza financiare u vërejt mjaft fuqishëm në ekonominë e vendit për arsye se Kosova nuk ka monedhë të veten nacionale, kriza finaciare erdhi si pasojë e përdorimit të euros dhe si pasojë e importimit të 90 % e të gjitha produkteve në tregun e Kosovës, duke qenë përdoruese e euros Kosova është e ndikueshme prej çfarë do krize të euros, sepse edhe vet kriza është e importueshme, por edhe ngritja e euros në Kosovë ka ndikim, andaj Kosova edhe pse nuk është

anëtare në Unionin Europian përdorë monedhën euro kjo në bazë të marrëveshjes së administrimit ndërkombëtar të Kosovës pas luftës së vitit 1998 – 1999.

Gjatë kësaj kohe të krizës monetare kishte shumë zëra pesimist ku flitej për një situatë depresioni. Asnjëherë më parë institucionet financiare nuk ishin ndeshur me një situatë të tillë kaq problematike e me shumë dyshime dhe pesimizëm për të ardhmen e tyre. Kjo situatë e sqaroi njëherë e mirë që intervenimi i shtetit në kohën e krizave është i pamohueshëm edhe pse po thuaj të gjitha bankat të cilat u prekën nga kriza ishin private u deshtë që shteti t’u japë kapital me qëllim që mos të vije deri te falimentimi i tyre. Kjo krizë financiare e vitit 2008 – 2009, ku zanafillën e ka në Amerikë në kreditë e patundshmërive, edhe sot e kësaj dite ka shumë dilema nga ekonimistët dhe analistë më të njohur botërorë për recesionin e shkaktuar dhe daljen nga kjo krizë. Drejtori i FMN-së (Fondi Monetar ndërkombëtar), D.Starus – Kahn e cilësoi këtë krizë si një situatë shumë serioze për të ardhmen e ekonomisë botërore. Kriza financiare e vitit 2008 – 2009 ka luhatur edhe besimin për një treg vërtet të lirë global. John Kenneth Galbraith i cili është fitues i çmimit nobel në ekonomi njëri ndër ekspertët më të mirë në botë për krizat e bursave, shkruante në një nga analizat e tij të viteve më parë se “ ajo që ne jemi të sigurtë është se kriza të tilla nuk përfundojnë kurrë me qetësi. Duhet të përgatitemi për më të keqen edhe pse pjesa më e madhe e njerëzve mendojnë se ajo ka pak gjasa të ndodhë. Gazeta e njohur franceze: “Le Monde” e cila ka një lexueshmëri dhe besueshmëri mjaft të lartë, në Qershor 2008 me shkronja të mëdha në kryetitull kishte shkruar se kriza financiare nuk është vetëm krizë e kredive të këqija në SHBA, por ajo është krizë e kreditit financiar global. Edhe multimiliardi dhe filantropi George Soros, në një intervistë për gazetën “Standard” të Vjenës e cilësoi situatën “si kriza më e madhe që ka përfshirë ndonjëherë botën ekonomike dhe financiare pas Luftës së Dytë Botërore”. Edhe Fituesi tjetër i çmimit nobel Josef Stiglitz vlerëson se kjo krizë financiare e cila ndodhi ishte pasojë e parashikueshme e një administrimi të keq të ekonomisë dhe financave botërore, ndërkohë që financieri i njohur M.Roubini parashikon një recesion të rëndë në SHBA ku si pasojë do të ketë një ngadalësim të ashpër të rritjes ekonomike në evropë dhe një frenim të ritmit të zhvillimit në vendet emergjente si Kina, India, Brazili, Rusia dhe Afrika e Jugut. Origjina e kësaj krize dihet që ishte Amerika për shkak të kredive të patundshmërive, kjo krizë filloi të shfaqet në SHBA në fund të vitit 2006, ku u paraqit fenomeni i rënies spektakolare të kredive hipotekare, dhe si pasojë në fillim të vitit 2007 filluan të preken nga kjo krizë shumë banka të botës, e cila bëri që kriza të japë efektet e mungesës financiare në botë, prandaj bankat qendrore të shumë vendeve u detyruan që të ndihmojnë në likuiditet, shumë banka në tregun

ndërbankar ndihmuan në banka që të jenë likuiditet si dhe u detyruan të zbusnin politikat e tyre monetare.

Kështu p.sh. vetëm gjatë një dite më 7 gusht 2007, në ndërhyrjen e parë që u bë për këtë qëllim, Banka Qendrore Evropiane hodhi në tregun evropian 95 miliardë euro për likuiditet, ndërsa Fed po me datë 7 gusht 2007 hodhi në tregun amerikan për likuidim 24 miliardë dollar.

Por edhe me gjithë këtë intervenim të qeverive shtetërore prapë shumë banka të mëdha falimentuan dhe u vunë nën administrim shtetëror, kështu i ndodhi me bankën Lehman Brothers në Amerikë. Por në gjithë këtë krizë të frikshme financiare, vjen një propozim gjithpërfshirës për dalje nga kriza prej "Henry Paulson" një plan special antikrizë i quajtur "plani Paulson", një njeri i cili kishte drejtuar njërin nga bankat më të mëdha amerikane "Goldman Sachs" (bankë e cila ishte prekur nga kriza fatkeqësisht) Paulson propozoi planin para presidentit Bush dhe për këtë plan u mbajtën shumë debate dhe analiza dhe pas shumë kritikave e shumë debateve me datën 3 tetor 2008 në kuadër të një ligji të stabilizimit ekonomik me urgjencë për 2008" dhoma e përfaqësuesve me 263 vota pro dhe 171 kundër votoi planin Paulson me përmirësime.

Me gjithë rrezikun e një krize vetëm Paulson pati guximin që të tregojë i aftë të lundrojë nëpër ujërat e turbullta të krizës aktuale, dhe të reagimit të dhjetëra milionëve amerikanë të thjeshtë që protestonin çdo ditë kundër favoreve për Wall Streetin, shqetësimet e bankierve dhe të liderëve të mbarë botës, u rezistoi dhe u imponoi planin e tij, që me gjithë rezervat dhe kritikën duket se ishte i vetmi për të dalë nga kjo krizë financiare me përmasa të frikshme globale.

6.14 Kriza financiare në Evropë – apeli i ekonomistëve

Në fillim të vitit 2009 kriza e cila shpërtheu në SHBA po paraqitet në Evropë me përmasa edhe më shqetësuese. Lëvizjet mjaft intensive të gjithë drejtuesve politikë e qeveritarë të niveleve të larta të Bankës Qendrore Evropiane dhe të bankave tjera të mëdha dëshmojnë për gjendjen mjaft shqetësuese të financave të ekonomisë evropiane, por edhe shkallën maksimale të impenimit politik, qeveritar e institucional të të gjitha institucioneve përgjegjëse për ta përballuar me kosto sa më të ulët këtë krizë. Për ta zgjedhur rrugën dhe formën më të mirë, shumë ekonomistë të njohur evropian si Alberto Alisina, Willem Buiter, Klaus F. Zimmermann (mbi 250 ekonomistë nga e gjithë Europa) etj., kishin dhënë propozimet e tyre dhe i kishin firmosur. Kuptohet synimi i tyre ishte të shtetet e mëdha si: Anglia, Gjermania, Franca etj., por nuk i

kishin lënë anash as vendet vendet tjera më të vogla dhe as ballkanin përendimor por as vendet e Mesdheut, sepse konsideronin se janë në varkën e njëjtë lundruese.

Sipas tyre Evropa ndodhet në mes të një krize që evropa nuk e ka njohur asnjëherë që nga krijimi i saj, ata sugjeruan se duhet urgjentisht të qetësohet furtuna e tregjeve financiare para se të shkaktohen plagë të rënda në ekonominë reale.

Por në apelin e ekonomistëve insistohet se çdo ndërhyrje thjesht nacionale, apo çdo ndërhyrje e koordinuar në një numër të vogël vendesh mund të ketë pasoja të paparashikueshme për vendet e tjera evropiane. Është imperativ i kohës që autoritetet nacionale evropiane të koordinohen sa më shpejt për të gjetur dhe për të dhënë një përgjigje unike në shkallë evropiane – kështu përfundojnë apelin e tyre grupi i ekonomistëve evropian.

6.15 Çka ndodhi në Kosovë, a ka strategji antikrizë?

Kur të gjitha vendet e botës po ndërtojnë strategji të ndryshme antikrizë, duke marrë masat më të ashpra të shkurtimit të shpenzimeve, duke i thirrur nëpër tryeza konsultative ekonomistët më të mirë në hartimin e planeve nga më të ndryshmet me qëllim që ta kenë nën kontroll krizën të cilën pothuaj e kishte përfshirë gjithë botën dhe po injektojnë bankat e tyre me qëllim që të jenë likuide dhe mos të vijë deri te falimentimi i tyre e shumë e shumë masa tjera.

Në Kosovë qeveria sillej sikur ne të ishim në ndonjë planet tjetër duke jetuar, duke u marrë me projektin e autostradës dhe duke premtuar rritje të rrogave për të gjithë shërbyesit civilë. Anomalia apo ironia edhe më e madhe ishte kur dëgjoje nga qeveritarë të lartë duke u përgjigjur me shaka për krizën ” thonin ne nuk kemi nevojë për plane, për këtë krizë, sepse në këtë lloj të krizës e kemi në Kosovë shumë para Evropës dhe Amerikës dhe nuk kemi nevojë të frikësohemi fare, kurse ata sapo kanë filluar dhe janë tmerruar nga frika tani e tutje, ata do të na kuptojnë se çka kemi hequr ne, kështu që nuk u ndërtua asnjë plan, asnjë intervenim askund, kam dëgjuar disa debate nga disa të ashtuquajtur analistë të pavarur nëpër televizionet tona lokale dhe publike, por asgjë konkrete, bile këta analistë fare nuk ishin të pavarur, sepse vërehej qartë që ishin proqeveritarë, por për habinë më të madhe nuk ka pasur asnjë përplasje serioze në mes të pozitës dhe opozitës, vazhdohej me prerje të shiritave për ndonjë copë rruge të shtruar me asfalt, për ndonjë shkollë të ndërtuar, për ndonjë kanalizim të ujërave të zeza të kryer, opozita e akuzonte pozitën se ka ardhur në pushtet me vota të vjedhura, pozitë dhe opozitë bënin gara se kush është më evropian se tjetri, interesimi më i madh ishte dhe vazhdon tutje të jetë te dhënia e

tenderëve me vlera të mëdha, kush po i fiton a është i partisë në pushtet, por edhe nëse është i partisë në pushtet duhet marrë informata a ka kontribuar në buxhetin e partisë në fushatë elektorale etj. Gjëra fare të parëndësishme për kohën në të cilën kriza pothuaj kishte arritur kulminacionin, çdo ditë e shihnim në televizion çfarë po ndodh me Greqinë dhe me vendet tjera, popullsia ishte ngritur në protesta shumë të ashpra.

Nga qeveria nuk u vërejt asnjë lloj ndryshimi në menaxhimin e buxhetit dhe asnjë lloj ndryshimi në politikat fiskale.

Në Kosovë për habi nuk çanin kokën as qeveria as opozita, por as populli nuk kishte asnjë lloj reagimi për të protestuar.²⁹

6.16 Globalizimi i dijes dhe informacionit

Ekonomia e dijes dhe informacionit çdo ditë e më tepër po tregon se bota nuk vuan nga globalizimi i tepërt, por nga mospërshtatja e shumë vendeve me globalizimin. Vendet në zhvillim sa më tepër që investojnë në ekonominë e re, aq më lehtë do ta kenë ta ndjekin ritmin dhe performacën e vendeve të zhvilluara, të integrohen në ekonominë botërore e të përfitojnë prej saj, në këtë konkluzion përfshihet edhe Shqipëria dhe Kosova si vende në zhvillim.

Nëpër debatet tona televizive por edhe jashtë televizionit termet si “ekonomi e dijes “ose shoqëri e informacionit “ dëgjohen shumë pak. Natyrisht duke parë përtej shprehjes së intelektualitetit dhe të shqetësimit qytetar në ndonjë debat publik. Shoqëria jonë po bën hapa shumë të ngadaltë drejt zhvillimit të dijes dhe informacionit. Fillimi i shekullit XXI, në kuadrin e zhvillimeve moderne ekonomia e dijes dhe informacionit po konsiderohet si faktor thelbësor i zhvillimit ekonomik, si elementi bazë i konkurrencës dhe të performancës të një vendi në botë, i cili po globalizohet me shpejtësi dhe ku të gjithë po përpiqen të përshtaten dhe të përfitojnë prej globalizimit.

Konceptet, praktikat dhe interpretimet për zhvillimin dhe krijimin e pasurisë dhe mirëqenies së kombeve ose të shteteve të ndryshme kanë evoluar ndjeshëm. Gjatë dy shekujve të fundit teoritë neoklasike kanë njohur vetëm faktorë bazë të prodhimit; punën dhe kapitalin. Por tash me

²⁹ Adrian Civici-Globalizimi...Ante portas - 2012 f,109-146

Adrian civici – Kriza Financiare apo globale - 2010 f , 19-72

Nëpër tekst ka nderhyrje nga autori i temes , ne rastet e krahasimit e ndikimit te krizes finaciare në Kosovë.

zhillimin e ri ky perceptim po ndryshon në vet thelbin e saj. Informacioni dhe dija po e zëvendësojnë kapitalin dhe punën .

Shekulli XXI po e thellon edhe më shumë dhe më me shpejtësi këtë prirje. Teknologjitë e reja dhe dijet konsiderohen tashmë si faktorë çelës të prodhimit dhe të rritjes ekonomike. Ekonomistët kanë filluar të mendojnë se aktualisht është i nevojshëm një revolucion i tërë edhe në treguesit e matjes dhe të shprehjes së kësaj ekonomie të re gjithnjë e më “jomateriale” . Ky është një debat mjaft i pranishëm në SHBA, Japoni, Kinë, dhe Evropë. Një krahasim mjaft interesant dhe domethënës për rëndësinë e informacionit e ka bërë Daniel Sichel (ekonomist në Bankën Qendrore në SHBA), në librin e tij “ The Computer Revolution ” ku vlerëson se informatika peshon vetëm 2% në stokun e kapitalëve të SHBA-së, kurse ndihma e saj në rritjen ekonomike është shumë herë më e lartë.

Bota po shndërrohet me shpejtësi në një shoqëri informacioni të inkuadruar në një ekonomi të dijes dhe të teknologjive moderne. Në shumë shtete të zhvilluara tashmë është vendosur si përparësi strategjike – futja dhe integrimi në shoqërinë e informacionit dhe në ekonominë e dijes, “duke ndërtuar projekte e programe speciale financimesh e mbështetje humane”.

Kompanitë e mëdha private nëpër vende të zhvilluara ose institucionet që merren me problemet e zhvillimit ekonomik e social, tashmë po bëhet e zakonshme dhe një profesion apo post i ri pune, posti i “ekspertit për dijen dhe njohuritë e reja”.

Konkurrenca më e madhe e për pasojë dhe pabarazitë në zhvillim, po vijnë gjithnjë e më tepër si pasojë e asaj që quhet “ekonomia e dijes dhe e shërbimeve”, e cila mbështetet në sistemet e teknologjisë së lartë të informacionit.

Globalizimi, efektet e të cilit ne i ndiejmë dhe i komentojmë çdo ditë, është para së gjithash pasojë e revolucionit të teknologjisë së informacionit e komunikimit si dhe e sistemit liberal të shkëmbimeve tregtare në kuadrin e OBT-së (Organizata Botërore e Tregtisë) ose marrëveshjeve rajonale në kontinente të ndryshme të botës. Në thelb globalizimi është zhvillimi i ekonomisë së dijes dhe i administrimit të njohurive.

Rritja e konkurrencës në shkallë ndërkombëtare, që rezulton nga ky proces, është shumë më e fortë se konkurrenca klasike e mallrave dhe produkteve me të cilën jemi ndeshur deri më tani.

Përballimi i kësaj konkurrence është i lidhur ngushtë me një proces inovativ të vazhdueshëm të bazuar në njohuri të thella shkencore dhe mbi të gjitha në aftësitë e shpërndarjes dhe të përvetësimit imediat të tyre në shkallë të gjërë.

E tërë ekonomia e vendeve të zhvilluara është tashmë e përfshirë në sistemin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit të pranishme kudo në çdo hap të procesit të prodhimit dhe të shpërndarjes. Kompanitë dhe firmat e ekonomisë së re po i shkurorëzojnë çdo ditë e më tepër kompanitë e ekonomisë së vjetër. Ekonomia e re çdo ditë e më tepër një realitet imponues, sepse po tregon se bota nuk vuan nga globalizimi i tepërt, por nga mungesa e globalizimit dhe sa më tepër e sa më shpejt vendet e varfëra dhe ato në zhvillim duke e përfshirë këtu edhe Shqipërinë dhe Kosovën, të investohet në “ ekonominë e re” (ekonomia e dijes dhe informacionit) aq më lehtë do ta kenë që të ndjekin ritmin dhe performancën e vendeve të zhvilluara dhe aq më të lehtë do ta kenë integrimin në ekonominë botërore globale dhe të përfitojnë prej saj. Efektet e ekonomisë së globalizimit po japin efektet edhe në shkollimin e lartë në përgjithësi si nevojë koherente për të qenë një model i përgjithshëm, i cili është synim që të zbatohet në të gjithë botën me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të kuadrove të reja për ekonominë e re globale, prandaj nisur nga ky synim arsimimi i lartë po merr gjithnjë e më tepër një rol parësor por dhe unik në përmirësimin e kohezionit social të një vendi, ku universitetet po bëhen burimi i shpërndarjes së profesionalizmit dhe etikës qytetare, ku universitetet janë në linjën e parë të respektimit të kodeve të sjelljes së mirë në të gjitha fushat.³⁰

6.17 Integrimet kryesore ekonomike rajonale Evropiane

- Kuptimi i integritimeve ekonomike ndërkombëtare

Të definohet kuptimi i integritimeve ekonomike ndërkombëtare është vështirë pasi që në integritime nuk ndikojnë vetëm faktorët ekonomikë, por aty implementohen edhe shumë faktorë politikë, ushtarakë etj. Mirëpo sido që të jetë, mund të themi se integrimi rajonal ndërkombëtar ekonomik nënkupton përfshirjen e dy a më shumë vendeve të një rajoni të caktuar gjeografik botëror në formë institucionale në fusha të caktuara, që i karakterizon sistemi i njëjtë ekonomik – shoqëror dhe përafërsisht niveli i njëjtë i zhvillimit të forcave prodhuese.

Integrimet ndërkombëtare tashmë janë bërë realitet dhe ato i hasim në fusha të ndryshme si psh: politike, ushtarake, ekonomike, tregtare, kulturore etj. Në kohën aktuale Evropa e sotme gjendet në proceset më të mëdha të ndryshimeve dhe integritimeve që nga Lufta e Dytë Botërore e

³⁰ Adrian Civici-Globalizimi...Ante portas - 2012 f,187-202
Nëpër tekst ka nderhyrje nga autori i temes.

këndej.Unioni Evropian sipas madhësisë dhe strukturës së tij, paraqet integrimin unik dhe tregun më të madh të këtij lloji në botë. Si i tillë për nga shkalla dhe numri i ndërlidhshmërisë deri më tash historikisht nuk ka ekzistuar, dhe as që aktualisht ekziston, ndonjë integrim i ngjashëm i këtij lloji tregu në botë.

Integrimi ekonomike nuk kemi vetëm në Evropë, modele të përafërta tani kemi të themeluara dhe funksionojnë edhe në rajone të tjera të globit tokësor. Kështu që ndërvarësia e shteteve në mes veti në fusha të ndryshme dita-ditës po rritet, dhe në një mënyrë apo në një tjetër po kushtëzohen në bërjen e reformave të ndryshme të integriteteve rajonale dhe globale njerëzore.

Format më të shpeshta të integriteteve janë integritet ekonomike, por duke mos lënë anash as ato ushtarake dhe shoqërore.

Këtë lloji të integriteteve kemi në kontinentin e Amerikës si: Shoqata e Amerikës Qendrore Të Tregtisë së lirë (CARIFTA) etj. ; në Azi Kooperimi regjional për zhvillim (CRD), Shoqata e Vendeve të Azisë Juglindore (ASEAN), Tregu i përbashkët Arab (AEC), Organizata e Vendeve Arabe Prodhuese të Naftës (OPEC),etj., në Afrikë: Organizata e Përbashkët Afro-Malgashe (OCAM), Bashkësia Ekonomike e Afrikës Lindore (EAC), Unioni Doganor i Afrikës Perëndimore (ECOWAS) etj.

Duke e parë nga shpjegimet e cekura më lartë shohim se format integriteteve ekonomike ndërkombëtare janë të ndryshme, në kuadër të globalizimit integritet ekonomike ndërkombëtare dallojmë katër zona kryesore të cilat janë;

- a) zona preferenciale,
- b) zona e tregtisë së lirë,
- c) unioni doganor dhe
- d) unioni ekonomik.

a) Zona preferenciale.-Kjo formë e integriteteve ekonomike ndërkombëtare paraqet një instrument të veçantë të tregtisë së jashtme, me ç'rast u jepet përparësi tregtare vendeve anëtare të bashkësisë së caktuar, (vendet pjesëmarrëse të asaj marrëveshje) e cila arrihet në bazë të një marrëveshje bilaterale dhe multilaterale të vendeve anëtare të integritetit përkatës. Me këtë rast preferencat tregtare janë reciproke dhe kanë të bëjnë me lirin nga doganat për mallrat e eksportuara ndërmjet vendeve anëtare nënshkruese të marrëveshjes.

Një marrëveshje të tillë të zonës preferenciale e kishte edhe ish-Jugosllavia me Maqedoninë, që nënkupton eksportimin e mallrave dhe të shërbimeve të ndryshme në mënyrë të ndërsjellë

ndërmjet këtyre dy vendeve pa dogana, përkatësisht me një normë vetëm 1% te doganës. Kjo marrëveshje më vonë pas luftës së UÇK-së të vitit 1998 – 1999 i kushtoi shumë negativisht Kosovës, për arsye se Kosova administrohej nga UNMIK-u dhe këtë marrëveshje si të tillë UNMIK-u e zbaton po ashtu si ishte edhe më parë, ku mallrat të cilat hynin në Kosovë nga Serbia dhe Maqedonia paguanin vetëm 1% taksë doganore, një taksë kjo e cila i mbulonte vetëm shpenzimet manipulative tregtare, por ajo që ishte absurditet i llojit të vet, mallrat e Kosovës nuk lejoheshin të hynin në Maqedoni me këtë taksë doganore prej 1% , me arsyetimin se Kosova nuk bënte pjesë në kuadër të ish-RF të Jugosllavisë, çka do të thotë se këtë preferencë në tregtinë e jashtme u ka lejuar UNMIK-u këtyre vendeve pa kurrfarë arsye juridike dhe ekonomike. Këtë vendim me kohë e kanë kundërshtuar ekspertët e ekonomisë së Kosovës si dhe institucionet vendore, por ishte pa efekt sepse nuk kishin në atë kohë fuqi në marrjen e vendimeve. Në këtë mënyrë UNMIK-u me qëllim apo pa qëllim i ka shkaktuar dëme shumë të mëdha ekonomisë së Kosovës dhe Buxhetit të Kosovës.

Maqedonia këtë marrëveshje e keqpërdorte deri në maksimum , duke lëshuar çertifikata falso nga Oda Ekonomike e saj për prejardhjen gjeografike të prodhimeve (mallrave), ku në shumë raste edhe “bananet” na dilnin si prodhim i Maqedonisë.

Kurse mallrat të cilat hynin nga Kosova në Maqedoni, Mal të zi, Serbi , i nënshtroheshin taksës doganore, madje këto vende u merrnin bizneseve kosovare edhe një taksë tranzite për mallrat të cilat kalonin nëpër territorin e tyre, por që kishin destinacion Kosovën.

b) Zona e tregtisë së lirë.- Kjo formë e integritit ekonomik ndërkombëtar paraqet shkallë më të lartë të lidhshmërisë tregtare ndërmjet dy e më shumë vendeve të një bashkësie rajonale në krahasim me zonën preferenciale.

Zona e tregtisë së lirë në vetvete nënkupton anulimin e plotë të doganave dhe qarkullimin e tregtisë së lirë të mallrave dhe shërbimeve në mes të shteteve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.

Këto beneficione të tregtisë së jashtme shfrytëzohen vetëm nga vendet anëtare të integritit përkatës ekonomik ndërkombëtar.

Karakteristikat kryesore ekonomike të zonës së tregtisë së lirë janë;

- heqja e kufizimeve në tregtimin e mallrave të ndërsjella të cilat kryesisht janë të prodhuara në vendet e zonës së tregtisë së lirë,

- futja e masave dhe instrumenteve me të cilat sigurohet që heqja e kufizimeve në qarkullim të ndërsjellë të mallrave ka të bëjë vetëm me ato mallra, (siç është psh, çertifikata për prejardhje gjeografike të mallrave etj) dhe mbajtja e së drejtës së vet (vendit) të politikës së tregtisë së lirë ndaj vendeve të treta (vende të cilat janë jashtë marrëveshjes së zonës së tregtisë së lirë).

Vendet të cilat nënshkruajnë marrëveshje për tregti të lirë, mund të bëjnë marrëveshje të pjesshme të tregtisë së lirë, duke bërë listimin (përshkrimin) e mallrave të cilat hyjnë në tregtinë e lirë, por mund edhe ta bëjnë të tërësishme e cila përfshin tërë qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve.

Një marrëveshje të tregtisë së lirë të pjesshme e kemi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në vitin 2003, ku në këtë marrëveshje janë listuar mallrat dhe shërbimet të cilat hyjnë në marrëveshje të tregtisë së lirë në mes të dy vendeve.

Në këto marrëveshje të tregtisë së lirë vendi i cili është më i zhvilluar ekonomikisht ka përfitime më të mëdha, sepse ka eksport më të madh të prodhimeve të veta, andaj gjatë hartimit të listës duhet pasur kujdes që të menaxhohet mirë çfarë mallra dhe shërbime po listohen në këtë marrëveshje.

c) Unioni doganor.-Unioni doganor paraqet bashkimin e dy e më shumë vendeve në një territor doganor me kufij dhe tarifë të përbashkët doganore. Me qëllim të përfitimeve ekonomike, vendet kanë pretendime të bëjnë marrëveshje bilaterale apo multilaterale për tarifatat e përbashkëta doganore ndaj vendeve të treta, kurse në qarkullimin e mallrave mes tyre nuk zbatojnë kurrfarë doganash. Prandaj unioni doganor paraqet nivel edhe më të lartë të integritimeve ekonomike ndërkombëtar, në krahasim me dy format e para. Karakteristikë e unionit doganor është se shtetet nëshkruese të kësaj forme integruese ekonomike ndërkombëtare, jo vetëm që anulojnë tarifatat doganore reciproke, por edhe inaugurojnë vendosjen e tarifave doganore ndaj vendeve të treta, të cilat nuk janë të përfshira në union. Një formë e tillë është shembulli i Bashkimit Evropian në raport me Turqinë. Nga kjo kuptojmë se unioni doganor nuk mbështetet vetëm në interesa dhe kritere ekonomike, por është mjaft i lidhur edhe me elemente politike (unë kisha me thënë që elementet politike janë faktori bazë në marrëveshje të tilla).

d) Unioni ekonomik.- Kjo formë e integritimit ekonomik ndërkombëtar në vete përfshin, jo vetëm heqjen e doganave për qarkullimin e mallrave, por edhe të gjitha inputeve (faktorëve) tjerë siç është fuqia punëtore, kapitali, shërbimet etj., midis shteteve nëshkruese të tij. Nga kjo konstatojmë se unioni ekonomik deri më tash paraqet shkallën më të lartë të integritimeve ekonomike ndërkombëtare. Unioni ekonomik përpos elementeve të cekura më lartë përfshihet

edhe në përcaktimin e politikës së përbashkët zhvillimore ekonomike, monetare etj., ashtu siç është me Unionin Europian.

Proceset integruese ekonomike rajonale ndërkombëtare nuk varen vetëm nga vullneti i mirë i shteteve që dëshirojnë të krijojnë apo të futen në këto procese, por edhe nga kushtet dhe faktorët e tjerë, si p.sh, faktori politikë (i cili është faktori kyç) shoqërorë, ekonomik, gjeografik sistemorë etj.

Si faktorë të rëndësishëm të veçantë janë;

Niveli i zhvillimit- nënkupton shtetet të cilat mund të integrohen dhe të kenë transaksione ekonomike në mes veti, së pari duhet të kenë nivel të përafërt të zhvillimit të forcave prodhuese mes veti me qëllim që interesi të jetë i balansuar në mes shteteve të cilat janë nënshkruese të kësaj marrëveshjeje. Ky nivel i integritetit ekonomik në praktikë shprehet nëpërmjet bruto produktit shoqëror (BPSH – GDP) si dhe të ardhurave kombëtare (TK) për kokë banori.

Ky rregull na jep të kuptojmë se vendet të cilat kanë ndryshime të mëdha nuk mund të kenë integrim ekonomik në mes veti, për arsien e thjeshtë, niveli jo i barabartë i zhvillimit ekonomik, p.sh, Japonia dhe Ruanda nuk mund të kenë integrim ekonomik në mes veti apo Gjermania dhe Moldavia etj.

Afërsia gjeografike –Paraqet faktor dhe kusht të rëndësishëm të integriteteve ekonomike rajonale ndërkombëtare. Që të ketë efekt integrimi ekonomik, është e preferueshme që shtetet të jenë fqinje, ose së paku t'i takojnë rajonit të përbashkët gjeografik botëror. Është i pakuptimtë integrimi ekonomik mes vendeve të rajoneve të ndryshme të botës, p.sh, është iracionale të kërkohej integrimi ekonomik mes vendeve Skandinave me vendet e Azisë ose të Afrikës. Ndonëse, edhe këtu mund të ketë përjashtime, në qoftë se është interesi reciprok ekonomik dhe politik i vendeve që dëshirojnë të hyjnë në integritete ekonomike ndërkombëtare.

Sistemi i njëjtë ekonomik – shoqëror.- Paraqet, po ashtu, faktorin shumë të rëndësishëm në integritet ndërkombëtare. Pa dyshim, rregullimi ekonomik – shoqëror paraqet faktorin e rëndësishëm dhe limitues në integritetin ekonomik rajonal ndërkombëtar bilateral dhe multilateral. Kuptohet integrimi ekonomik rajonal ndërkombëtar nuk mund të bëhet mes vendeve me rregullim të ndryshëm ekonomik – shoqëror, si dhe me sistem dhe me politika të ndryshme ekonomike . Natyra e integriteteve ekonomike në vete kërkon edhe kompatibilitet të sistemeve ekonomike të vendeve të cilat do të përfshihen në këtë proces integrues, sepse nuk mund të hyjnë në integritet vendet të cilat kanë ekonomi të tregut të lirë me vendet të cilat kanë ekonomi të dirigjuar me plan apo të centralizuar nga shteti, pavarësisht nga afërsia gjeografike apo kushtet

tjera ekonomike të tyre. Sistemet e ndryshme ekonomiko – shoqërore kanë edhe koncepte, sistem dhe politikë të ndryshme ekonomike, që paraqet pengesë kryesore në integrimet ekonomike ndërkombëtare. Vetë koncepti i sistemeve ekonomike pengon integrimin ekonomik të vendeve me rregullim të ndryshëm ekonomiko – shoqëror, sepse ndryshon edhe vet qasja e sistemit dhe e politikës makroekonomike, si nga pikëpamja teorike ashtu edhe nga pikëpamja empirike. Andaj, për realizimin e integritimeve ekonomike rajonale ndërkombëtare, pos tjerash, vendet duhet të kenë edhe sistem të njëjtë ekonomiko – shoqëror .

Marrja e vendimeve.- Nënkupton një karakter obligativ të integritimeve ekonomike rajonale ndërkombëtare. Integrimet ekonomike ndërkombëtare kanë karakter institucional dhe obligativ. Anëtarësimi në integrimet ekonomike rajonale ndërkombëtare bëhet me pëlqimin e organeve përkatëse shtetërore nacionale. Me këtë rast, shteti merr përsipër dhe i pranon të gjitha detyrimet ekonomike dhe politike që dalin nga integrimet ekonomike, të cilat përcaktohen me marrëveshje të posaçme.³¹

6.18 Qëllimi i angazhimit të firmave në (integrimet ekonomike) biznesin ndërkombëtar

Kompanitë angazhohen në biznes ndërkombëtar për tri arsye kryesore:

- Me qëllim të zgjerimit të shitjeve të veta,
- Të gjejnë burime shtesë,
- Të diversifikojnë burimet për shitje dhe furnizim.

Shitjet e një kompanie varen nga dy faktorë: a) interesi i konsumatorëve për produktin e saj dhe b) gatishmëria e aftësia e tyre për t'i blerë ato produkte.

Numri i njerëzve dhe fuqia e tyre blerëse janë më të mëdha në disa vende se sa në një vend të vetëm, prandaj kompanitë mund të zgjerojnë shitjet e tyre duke kërkuar tregje më të mëdha në vende tjera. Si rregull në ekonomi, më shumë shitje do të thotë më shumë fitim duke supozuar për çdo njësi të shitur të ketë të njëjtin përfitim, madje fitimi për çdo njësi të shitur mund të rritet me rritjen e shitjeve.

Zgjerimi i shitjeve është një motiv madhor për shtrirjen e çdo kompanie në biznesin ndërkombëtar. Tani në ditët tona të shekullit XXI e dimë faktin se shumë nga kompanitë më të mëdha në botë përfitojnë më shumë se gjysmën e mallit të tyre të shitur jashtë vendit të tyre amë.

³¹ Prof. Dr. Musa Limani- Integrimet Ekonomike Europiane, Prishtinë 2008 , f 16-21.
Sqarim: Nëpër tekst ka nderhyrje nga autori i temes.

Kompanitë e tilla janë si p.sh, kompania “ Basf” (Gjermani), “Elektrolux” (Suedi), “Gillete” (SHBA),”Michelin” (Francë), “Nestle” (Zvicër), “ Philips “ (Hollandë) dhe “Sony “ (Japoni).

Prodhuesit dhe shpërndarësit jo vetëm që nxjerrin jashtë vendit produktet, shërbimet dhe komponentet e prodhuara, por këto firma kërkojnë jashtë kapital dhe teknologji për ta përdorur në vendin e tyre. Në disa raste këtë e bëjnë sepse është se ka leverdi ekonomike, pra ka kosto më të ulët se sa në vend, e në disa raste mund të mos e ketë atë burim në vendin mëmë të kompanisë. Hulumtim dhe gjetje të burimeve bëjnë edhe kompanitë më të vogla në krahasim me kompanitë e apostrofuara më lartë, dhe në shumë raste kompanitë më të vogla prodhojnë për kompanitë e mëdha pjesë të ndryshme, ku pastaj si produkt i kompletuar eksportohet jashtë.

Diversifikimi i shitjeve dhe furnizimeve u shërben bizneseve në disa raste edhe për t’i shmangur luhatjet e mëdha në shitjet dhe fitimin e kompanisë.

Kemi shumë raste kur kompanitë përfitojnë nga përparësitë që ofron fakti që stadet apo etapat e ciklit të zhvillimit të biznesit ndryshojnë nga një vend në tjetrin, humbjet që mund t’i ketë një kompani nga shitjet në një vend që ndodhet në fazën e rënies mund t’i mbulojë apo kompensojë me fitimet të cilat i ka në një vend tjetër i cili gjendet në fazën e gjallërimit dhe rritjes së ekonomisë.

Në fazën në të cilën jemi në kohën e sotme (shek XXI) është vështirë të përcaktohet vëllimi i biznesit ndërkombëtar në baza afatgjata historike, sepse nuk kemi të dhëna të krahasueshme për periudhat e mëhershme, dhe për shkak se tani tregu është shumë i madh, konkurrenca është shumë e madhe dhe si e tillë çfarë është, krijon vështirësi të lartë menaxhuese po aq sa krijon edhe përparësi për zhvillim të shpejtë dhe rritje të mundësive shtesë për përfitime. Duke e parë këtë zhvillim të hovshëm të teknologjisë dhe këtë konkurrencë mund të konkludojmë se “rreziku” dhe “suksesi” qëndrojnë shumë afër njëri me tjetrin.

Arsyet e zgjerimit të tregut, të shitjeve, të gjetjes së burimeve dhe diversifikimit të përmendur më lartë duket të kenë vepruar edhe më herët, por faktorët të cilët kanë sjellë këtë rritje të biznesit ndërkombëtar në kohën e sotme janë;

a) Rritja dhe zgjerimi i shpejtë i teknologjisë.- Në teknologji ka pasur një përparim aq të hovshëm sa që ndonjëherë mund të duken si të pabesueshme marramendëse p.sh, deri në vitin 1970 nuk ka pasur udhëtime tregtare transatlantike supersonik, nuk kishte as faks apo shërbim telefonik të drejtpërdrejtë midis kontinenteve. Kurse sot situata është krejt ma ndryshe një njeri mund të udhëtojë nga Nju Jorku në Londër vetëm për tri orë e gjysmë, ndërsa faksi dhe telefoni janë çështje sekondash apo minuti, teknologjia si komunikimi satelitor përmes faksit, telefonit,

email-it shpejton ndërveprimin dhe rrit efektshmërinë e menaxherëve për të kontrolluar operacionet e huaja, pra teknologjia mund të themi se zë vendin më të rëndësishëm në zhvillimet e sotme ndërkombëtare ekonomike, politike, shoqërore etj.

b) Liberalizimi i politikave qeveritare për lëvizjen midis vendeve të produkteve dhe burimeve.- Si rregull sot qeveritë imponojnë më pak kufizime për lëvizjet ndërkufitare se sa një dhjetëvjeçar më parë, duke u ofruar mundësinë qytetarëve të tyre të zgjedhin më shumë produkte dhe sasi më të mëdha, ku si pasojë edhe çmime më të ulëta. Kjo lëvizje i detyroi prodhuesit vendas që të jenë më eficient për shkak të konkurrencës së huaj nga jashtë, por njëkohësisht i detyroi prodhuesit vendas që ta rrisin cilësinë e produkteve të veta e krejt kjo si pasojë e konkurrencës nga jashtë. Kufizimet e lëvizjeve sa më të vogla, kanë treguar se japin rezultat në aftësimin e kompanive për të përfituar përparësitë e mundësive që krijon tregu i lirë ndërkombëtar. Por te disa biznese vendore kjo konkurrencë ka ndikuar pozitivisht, sepse kanë mundur të jenë në hap me kohën, kurse për ato biznese që nuk kanë mundur ta zënë hapin ka qenë shkatërrimtare.

c) Zhvillimi i institucioneve të nevojshme.-Për të mbështetur dhe lehtësuar tregtinë ndërkombëtare, për të arritur deri këtu ku jemi sot shumë gjëra të cilat i gëzojmë ne sot falas e që janë si rezultat i zhvillimit teknologjik duhet t'u jemi mirënjohës edhe qeverive të cilat na mundësojnë këtë përmes marrëveshjeve të cilat krijojnë lehtësi dhe na mundësojnë trajnime të ndryshme që të aftësohemi me qëllim që të mund ta shfrytëzojmë këtë zhvillim teknologjik dhe të mirat e tregut të lirë global.

d) Rritja e konkurrencës globale.- Konkurrenca e huaj gjithnjë në rritje mundet, dhe në një formë po obligon bizneset që ta zgjerojnë biznesin duke hapur filiale edhe jashtë vendit amë. Kjo tani është më e lehtë për shkak të zhvillimeve teknologjike, marrëveshjeve qeveritare për tregti të lirë. Sot kompanitë munden shumë më shpejt të zhvendosin prodhimin nga një vend në tjetrin për shkak të eksperiencës së tyre në tregjet e huaja dhe se produktet e tyre mund të transportohen me efektivitet nga shumica e vendeve për shkak të rregullimit të infrastrukturës rrugore.³²

³² Prof.Dr. Ilia Kristo-Biznesi Ndërkombëtar, Tiranë 2004 f,5-9
Sqarim –Nëpër tekst ka nderhyrje nga autori për qëllime të pershtatjes së temës.

KAPITULLI VII

7.1 Konkluzioni

Ndërhyrja e shtetit në rrjedha ekonomike përmes menaxhimit të politikave fiskale arsyetohet me rregullimet e bëra në drejtim të mënjanimi të dukurive që bëhen pengesë për ruajtjen e mirëqenies së përgjithshme të shoqërisë dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Por duhet pasur kujdes gjatë ndërtimit të politikave fiskale si të shkallët tatimore, shkallët doganore etj., sepse tatimet paraqesin mundësi por edhe rreziqe. Tatimet më të ulëta mund të stimulojnë biznesin dhe, kur kushtet janë të përshtatshme, mund të rrisin të ardhurat buxhetore. Megjithatë, nëse ulen shumë, ato mund të jenë të dëmshme ndaj të ardhurave të buxhetit dhe mund të rrezikojnë të mirat publike, të tilla si infrastruktura, arsimi dhe kujdesi shëndetësor, etj. Disa argumente kanë treguar se përpjekjet për të bërë ndryshime të gjëra në sistemin tatimor janë treguar më të suksesshme se sa ato që kanë modifikuar dispozita specifike.

Duke i parë këto teori si dhe shumë teori të mendimtarëve të ndryshëm mund të konkludojmë se çdo reformë tatimore duhet të llogariten mirë e mirë përparësitë dhe të metat, vështëritë të cilat i bartë në vete çdo reformë tatimore dhe kërkohet vendosmëri në zbatueshmërinë e ligjit.

Për t'u zhvilluar me sukses procesi i privatizimit, duhet të sigurohet: zhvillimi i tij publik (transparent), me çka mundësohet evitimi i keqpërdorimeve, shitja e pasurisë sipas çmimeve të tregut me çka mund të neutralizohen efektet negative; ku mendoj se privatizimi në Kosovë është dashur të zhvillohet në bazë të programeve konkurruese (prodhuese apo tregtare) dhe vlerës së hapur të tregut, rol të rëndësishëm luan edhe informimi, i cili krijon kushtet për pjesëmarrje masive të subjekteve në procesin e privatizimit dhe zvogëlon mundësitë e standardeve të dyfishta; maksimalizimi i çmimit është parim shumë i rëndësishëm, sepse nënkupton eliminimin e privilegjeve të blerësve nga strukturat burokratike, mundëson shitjen publike dhe provokimin e interesit të sa më shumë blerësve. Kjo nënkupton zgjedhjen e ofertuesit më të mirë.

Privatizimi i ndërmarrjeve në pronësi shoqërore-shtetërore nuk është nisur nga fakti i verifikuar në ekonominë perëndimore, se të ardhurat e shtetit a janë më të mëdha nga tatimet që paguajnë ndërmarrjet e privatizuara, apo profiti nga shitja e këtyre ndërmarrjeve (Robert Devlin - 1996). Kjo analizë nuk është bërë në Kosovë, dhe ajo çka është më brengosëse është se

nuk kanë kërkuar program zhvillimor prej këtyre ndërmarrjeve, por është vrapuar pas çmimit më të lartë, si dhe transparenca nuk ka qenë në nivelin e duhur.

Qeveria duhet ta ndryshojë ligjin e tatimit në fitim, dhe nga e drejta ligjore e humbjes së bartur për shtatë (7) vite, ta ul në 2 apo 3 vite, sepse mendoj se do të japë rezultate të drejtpërdrejta në të hyra. Si rekomandime mund të themi se drejtuesit vendimarrës në Kosovë duhet të fillojnë ta bëjnë përshkallëzimin e TVSH-së për gjëra ushqimore siç janë: vaji, buka, mielli, sheqeri, kripa, etj, pra shporta e përditshme familjare.

Qeveria duhet të ndryshojë edhe politikën doganore me qëllim që bizneset mos ta paguajnë TVSH-n (Tatimin e Vlerës së Shtuar) në doganë, por kjo pjesë e tatimit të paguhet pasi të shitet produkti.

Ndërhyrja e shtetit në rrjedha ekonomike përmes politikës fiskale arsyetohet me rregullimet e bëra në drejtim të mënjanimin të dukurive që bëhen pengesë për ruajtjen e mirëqenies së përgjithshme të shoqërisë.

Duke i parë përvojat e vendeve të ndryshme mund të vijmë në përfundim se shteti me politikat e veta fiskale mund ta orientojë zhvillimin ekonomik të një vendi dhe të bëhet promotor i zhvillimit të një vendi. Kosova duhet të zhvillojë politika fiskale të menduara mirë e mirë me qëllim që të tërheq investimet e huaja nga jashtë, sidomos në zhvillimin e bujqësisë, sepse ka tokë shumë të plleshme në fushat e dukagjinit. Dhe duhet ta zhvillojë turizmin malor, sepse ka një klimë të mesme kontinentale dhe ka pjesën e Prevallës dhe Brezovicën (në territorin e Prizrenit) dhe Bogën (në territorin e Pejës) me një mundësi të zhvillimit të turizmit malor dhe karakteristikën e klimës shëruese që ofrojnë Malet e Sharrit, por për ta zhvilluar këtë politikë duhet të ketë politika fiskale të koordinuara në mes të pushtetit lokal me atë qendror, siç kanë bërë shtetet tjera duke bërë edhe periodha të pushimit tatimor.

Bazuar në pyetësin e bërë në teren por dhe në literaturën e përdorur, vërejmë pakënaqësitë në menaxhimin e politikave fiskale, pakënaqësi në menaxhimin e doganave, pakënaqësi në menaxhimin e privatizimit përmes AKP-s (Agjencionit Kosovarë të Privatizimit), pakënaqësi në luftimin e ekonomisë informale, pakënaqësi në fushën e sigurisë etj., mund të konkludojmë se Kosova ka nevojë të ngutshme për ndryshim në menaxhimin e politikave fiskale.

7.2 Kontributi në dije

Ky hulumtim jep një pasqyrë orientuese mbi gjendjen e menaxhimit të politikave fiskale në Kosovë, si një vend i cili është në një fazë të zhvillimit të ngadalshëm.

Si rezultat i këtij hulumtimi evidentohen lloje të ndryshme të ngecjeve zhvillimore të cilat janë identifikuar përmes pyetësorëve të zhvilluar në teren dhe organizimin e debateve zhvillimore të cilat lidhen kryesisht me menaxhimin e politikave fiskale si dhe krijimin e sigurisë në investime. Politika e vendit duhet të ketë parasysh këto pengesa në zhvillim dhe secilën fushë zhvillimore ta trajtojë si karakteristikë në vete si p.sh, Agjensionin e Privatizimit, mineralet, tatimet, doganat etj.

Këto këshilla apo rekomandime janë kategorizuar në një menaxhim më të mirë të politikave fiskale, të cilat do të kontribonin në zhvillimin e bizneseve vendore si dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Kushtëzimet e vendeve të zhvilluara të cilat kanë hulumtuar në Kosovë me qëllim të investimeve kanë ngritur si shqetësim të vazhdueshëm, energjetiken, byrokracinë, sigurinë për investime, (zbatim të drejtë dhe efikas të ligjeve në fuqi) si dhe korrupsionin. Këto arsye shumë shpesh kanë bërë që investorët potencialë të largohen nga Kosova.

Organizimi në sektorët publik duhet të bëjë ndryshime në qasje ndaj zhvillimit të biznesit privat në ofrimin e kushteve sa më të mira për të bërë biznes si dhe të jetë shumë më i kujdesshëm në menaxhim të politikave fiskale.

Kështu, mënyra më e mirë është që të kemi njohuri rreth zhvillimit ekonomik, në fazën e tranzicionit në të cilën gjendemi duhet të nisemi prej praktikave të vendeve të cilat e kanë kaluar këtë fazë siç janë: Sllovenia, Kroacia, Hungaria, Polonia, Çekia etj., për t'i integruar ato modele duke ua përshtatur karakteristikat vendore në procesin e planifikimit të mëtejshëm në projekte zhvillimore të politikave fiskale.

Hulumtimi gjithashtu mund të jetë i dobishëm në zhvillimin e standardeve Evropiane për menaxhimin e politikave fiskale.

7.3 Kufizimet e Punimit

Kufizimet lidhur me këtë punim doktoral jepen më poshtë:

- Hulumtimi është i kufizuar vetëm në menaxhimin e politikave fiskale në Kosovë dhe ndikimin e tyre në zhvillim ekonomik në periudhën 2008-2013, pra në një vend të vetëm.
- Krahasoni i praktikave të menaxhimit të politikave fiskale në Kosovë si vend më pak i zhvilluar në krahasim me vendet e rajonit.
- Ndikimi apo impakti i politikave fiskale në zhvillimin e bizneseve.
- Ndikimi i sigurisë në zbatim të ligjeve dhe politikave fiskale, në tërheqjen e investimeve nga jashtë etj.

7.4 Rekomandimet

Punimi e këtij disertacioni (teme) doktoral ndikon shumë si shtytje në nisma të mëtejme kërkimore, sepse është njëri ndër hulumtimet e pakta apo ndoshta ndër të parat në vend, dhe ngre çështje të cilat janë të rëndësishme për vendin dhe zhvillimin ekonomik si:

- Hulumtimi mund të hapë dyer për studiuesit për të eksploruar praktikën më të mirë të menaxhimit të politikave publike të vendeve tjera më të zhvilluara apo vendeve në zhvillim.
- Studiuesit në të ardhmen gjithashtu mund të hulumtojnë praktikën më të mirë të menaxhimit të politikave fiskale të vendeve në rajon dhe Bashkim Evropian me qëllim të marrjes së praktikave më të mira të një vendi tjetër të zhvilluar për të pasur një pasqyrë të përgjithshme të praktikave të menaxhimit të politikave fiskale.
- Studiuesit e ardhshëm mund të studiojnë në lidhje me strategjinë dhe organizimin e politikave fiskale dhe menaxhimin e tërheqjes dhe nxitjes së investimeve si nga brenda ashtu dhe nga jashtë, duke u krijuar politika fiskale të favorshme dhe afatgjate, sidomos në nxitjen e prodhimeve vendore, ku si rezultat i këtyre politikave do të kemi një zhvillim të tregut të lirë dhe një rritje të punësimit.

Shtojca

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Kosovës Për vitet 2008, 2009, 2010

		2010		2009		2008	
		Menaxhuar nga	Pagesat	Menaxhuar nga	Pagesat	Menaxhuar nga	Pagesat
		Qeveria e	nga palët e	nga Qeveria e	nga palët e	nga Qeveria e	nga palët e
		Kosovës	treta	Kosovës	treta	e Kosovës	treta
	Shënim	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €
PRANIMET							
Tatimi							
Doganat	2	699,385	-	634,146	-	604,196	-
Administrata Tatimore	3	194,218	-	181,659	-	200,834	-
		893,603	-	815,805	-	805,030	-
Të hyrat vetanake							
Komunat	4	52,028	-	48,293	-	42,784	-
Organizatrat qendrore buxhetore	5	48,451	-	29,657	-	29,066	-
		100,480		77,950	-	71,850	-
Grantet dhe ndihmat							
Grantet e përcaktuara të donatorëve	6	15,342	4,394	13,880	5,012	12,832	4,854
Grantet për përkrahje të buxhetit	7	30,000		0		13	-
		45,342	4,394	13,880	5,012	12,845	4,854
Pranimet tjera							
Fondi i depozitave	8	577	-	996	-	3,009	-
Gjobat dhe tarifrat	9	33,337	-	43,209	-	42,541	-
Interesi bankar	10	11,718	-	5,432	-	17,268	-
Dividentat	11	85,000	-	200,000	-	30,761	-
		130,632		249,637		93,578	
Huazimet	12	22,093	-	0	-	0	-
Tjera	13	2,358	-	3,425	-	5,823	-
Gjithsej Pranimet		1,194,508	4,394	1,160,697	5,012	989,126	4,854
PAGESAT							
Operacionet							
Rrogat dhe pagat	14	316,200	-	268,925	-	228,059	-
Mallërat dhe shërbimet	15	167,156	4,394	154,739	5,012	144,583	4,854
Shërbimet komunale	16	19,527	-	19,234	-	18,489	-
		502,884	4,394	442,898	5,012	391,131	
Transferet							
Subvencionet dhe transferet	17	253,484	-	257,767	-	210,006	-
Shpenzimet kapitale	18						
Prona, impiantet, pajisjet, transferet		459,272	-	406,382	-	351,651	-
Pagesat tjera							

Pagesa e Borgjit	19	10,083	-	43,815	-	-	-
Huazimet për ndërmarrjet publike	20	60,000	-	78,829	-	8,711	-
Pagesa për anëtarësim në IFN	21	169	-	17,030	-	-	-
Kthimet nga fondet e depozitave	22	1,632	-	5,627	-	1,885	-
Gjithsej Pagesat		1,287,523	4,394	1,252,348	5,012	963,384	4,854
Rritje/(Zbritje) në para të gatshme		-93,015	-	-91,652	-	25,743	
Para të gatshme në fillim të vitit	23	383,853		475,505		449,762	
Para të gatshme në fund të vitit	23	290,838	-	383,853	-	475,505	

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Kosovës
Për vitet 2008, 2009, 2010, Buxheti i miratuar në bazë të parave të gatshme (Klasifikimi i pagesave sipas klasifikimit ekonomik)

	2010				2009	2008
	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Realizimi	Ndryshimet buxhetore	Realizimi	Realizimi
	A	B	C	D=C-B		
Shënim	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €
RRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME						
Tatimi	891,600	890,000	893,603	3,603	815,805	805,030
Të hyrat vetanake	80,500	78,900	100,480	21,580	77,950	71,850
Dividentat	-	85,000	85,000	-	200,000	-
Të tjera	127,100	176,500	99,506	-76,994	53,062	65,645
Gjithsej Pranimet *	1,099,200	1,230,400	1,178,589	-51,811	1,146,817	942,525
RRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME						
Rrogat dhe pagat	282,722	315,902	311,417	-4,485	264,396	227,091
Mallërat dhe shërbimet	166,363	180,534	162,635	-17,899	151,763	139,371
Shërbimet komunale	22,235	22,311	19,516	-2,795	19,225	18,481
Subvencionet dhe transferet	237,480	257,526	252,679	-4,847	256,901	209,769
Shpenzimet kapitale	413,943	503,010	455,344	-47,666	400,380	347,103
Rezervat	6,767	682	-	-682	-	-
Të tjera	85,000	70,252	70,252	-	139,674	8,711
Gjithsej Pagesat 24	1,214,510	1,350,217	1,271,842	-78,374	1,232,339	950,526
Shënim: (*) Në totalin e pranimeve nuk janë përfshirë pranimet nga GPD në shumë 15,342,000 Euro dhe pranimet e depozitave në shumë 577,000 Euro.						
(**) Në totalin e pagesave nuk janë përfshirë pagesat nga GPD në shumë 14,049,000 Euro dhe kthimet nga fondet e depozitave në shumë 1,632,000 Euro.						

Pasqyra e konsoliduar e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve për Qeverinë e Kosovës

Për vitet 2008, 2009, 2010

		2010	2009	2008
		Menaxhuar	Menaxhuar	Menaxhuar
		nga Qeveria	nga Qeveria	nga Qeveria
		e Kosovës	e Kosovës	e Kosovës
	Shënim	'000 €	'000 €	'000 €
Pasuritë financiare në para të gatshme				
Banka Qendrore e Kosovës	25	48,796	88,311	202,603
Letrat me vlerë për Qeverinë	25.1	84,586	-	266,477
Depozitat e afatizuara në BQK	25.2	140,000	125,000	-
Depozitat e afatizuara në bankat komerciale	26	11,000	163,922	-
Fondet në bankën komerciale - NLB Prishtina	27	767	-	-
Paratë e gatshme në tranzit	28	4,278	5,793	5,812
Llogaritë e ambasadave të Republikës së Kosovës	29	526	557	
Paratë e gatshme në dorë (arka)	30	885	270	613
Gjithsej pasuritë në para të gatshme		290,838	383,853	475,505
Bilancet e fondeve				
Qëllimet specifike				
Të përcaktuara nga donatorët	31	9,741	8,561	12,798
Të hyrat vetanake të bartura	32	29,691	25,128	35,690
Të tjera	33	7,295	8,233	12,956
		46,727	41,922	61,444
Të pashpëmdara		244,112	341,930	414,061
Gjithsej Bilanci i Fondeve	23	290,838	383,853	475,505

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Kosovës

Për vitet 2011, 2012, 2013

		2013		2012		2011	
		Menaxhuar nga	Pagesat nga palët	Menaxhuar nga	Pagesat nga palët	Menaxhuar nga	Pagesat nga
		Qeveria e Kosovës	e treta	Qeveria e Kosovës	e treta	Qeveria e Kosovës	palët e treta
	Shënim	'000 e	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 e
PRANIMET							
Tatimet							
Dogana	2	834,080		842,787	-	826,592	-
Administrata Tatimore	3	270,763		251,151		231,360	-
		1,104,843		1,093,939	-	1,057,952	-
Të hyrat vetanake							
Komunat	4	55,850		59,448	-	55,621	-
Organizatat qendrore buxhetore	5	39,103		44,835	-	59,912	-
		94,953		104,283	-	115,534	
Të hyrat e dedikuara							
Të hyrat e dedikuara të AKP-së	6	-		16,248	-	-	-
		-		16,248			
Grantet dhe ndihmat							
Grantet e përcaktuara të donatorëve	7	12,588	4,354	11,322	5,493	8,968	4,642
Grantet për përkrahje të buxhetit	8	-	-	37,417	-	19,240	
		12,588	4,354	48,738	5,493	28,208	4,642
Huamarrja							
Huamarrja e jashtme	9	4,634		93,677	-	5,076	-
Huamarrja e brendshme	10	79,200		73,313	-	-	-
		83,835		166,990		5,076	
Pranimet tjera							
Fondi i depozitave	11	3,873		1,338	-	957	-
Gjobat dhe tarifat	12	42,875		39,845	-	43,393	-
Interesi bankar	13	-		0	-	1,631	-
Taksat koncesionare	14	2,000		-	-	-	-
Tantiemat	15	24,693		-	-	-	-
Dividentat	16	43,000		45,000	-	60,000	-
		116,442		86,183	-	105,981	
Financimi i njehershëm i AKP-së	17	-		28,934	-	-	-
Financimi i njehershëm - Privatizimi	18	26,300		-			
Kthimi i huazimene nga NP	19	6,000		4,000	-	-	-
Tjera	20	205		1,300	-	502	-
Gjithsej Pranimet		1,445,165	4,354	1,550,615	5,493	1,313,252	4,642
PAGESAT							
Operacionet							
Rrogat dhe pagat	21	418,546		409,245	-	388,303	-

Mallërat dhe shërbimet	22	195,365	4,354	172,482	5,493	161,591	4,642
Shërbimet komunale	23	21,664		21,560	-	20,388	-
		635,574		603,287		570,282	
Transferet							
Subvencionet dhe transferet	24	315,619		280,317	-	256,476	-
Shpenzimet kapitale	25	534,690					
Prona, impiantet, pajisjet, transferet				554,813	-	531,290	-
Pagesat tjera							
Pagesa e Borgjit	26	25,472		21,416	-	11,491	-
Huazimet për ndërmarrjet publike	27	-		15,000	-	30,000	-
Pagesa për anëtarësim në IFN	28	-		1,050	-	-	-
Kthimet nga fondet e depozitave	29	203		190	-	922	-
Gjithsej Pagesat		1,511,558		1,476,072	-	1,400,462	-
Rritje/(Zbritje) në para të gatshme		-66,393	4,354	74,543	5,493	-87,209	4,642
Para të gatshme në fillim të vitit	30	278,171		203,629		290,838	
Para të gatshme në fund të vitit	30	211,778	4,354	278,171	5,493	203,629	4,642

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Kosovës
Për vitet 2011, 2012, 2013

		2013			2012	2011
	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Realizimi	Ndryshimet buxhetore	Realizimi	Realizimi
	A	B	C	D=C-B		
Shënim	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €
RRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME						
Tatimet	1,182,000	1,181,114	1,104,843	-76,271	1,093,939	1,057,952
Të hyrat vetanake	136,000	135,555	94,953	-40,602	104,283	115,534
Dividentat	30,000	43,000	43,000	-	45,000	60,000
Të hyrat nga huamarrjet	104,000	111,621	83,835	-27,786		
Të tjera*	75,000	104,648	102,073	-2,575	294,734	69,842
Gjithsej Pranimet**	1,527,000	1,575,939	1,428,704	-147,234	1,537,955	1,303,328
RRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME						
Rrogat dhe pagat	439,061	437,696	417,093	-20,603	407,706	385,033
Mallërat dhe shërbimet	204,476	215,641	193,857	-21,784	169,362	156,559
Shërbimet komunale	24,248	24,098	21,662	-2,436	21,558	20,376
Subvencionet dhe transferet	298,306	320,981	312,916	-8,065	280,120	256,166
Shpenzimet kapitale	621,864	627,457	529,176	-98,281	550,245	528,186
Rezervat	3,164	115	-	-115	-	-
Të tjera***	32,713	32,713	25,472	-7,241	37,466	41,491
Gjithsej Pagesat**** 31	1,623,831	1,658,702	1,500,176	-158,526	1,466,457	1,387,810
Shënim:						

(*) Përfshihen: Gjobat dhe tarifat (42,875,000 €), Financimi i njëhershëm-Privatizimi (26,300,000), Taksa koncesionare (2,000,000), Tantiema (24,693,000), Kthimi i huadhënies nga NP (6,000,000 €) dhe Tjera (205,000 €).

(**) Në totalin e pranimeve nuk janë përfshirë pranimet nga GPD në shumë 12,588,000 Euro dhe pranimet e depozitave në shumë 3,873,000 Euro.

(***) Përfshihen: Pagesat e borxhit (25,471,000 €).

(****) Në totalin e pagesave nuk janë përfshirë pagesat nga GPD në shumë 11,179,000 Euro dhe kthimet nga fondet e depozitave në shumë 203,000 Euro.

Pasqyra e konsoliduar e pasurive në para të gatshme dhe balanceve të fondeve për Qeverinë e Kosovës Për vitet 2011, 2012, 2013				
		2013	2012	2011
		Menaxhuar	Menaxhuar	Menaxhuar
		nga	nga	nga
		Qeveria e	Qeveria e	Qeveria e
		Kosovës	Kosovës	Kosovës
	Shënim	'000 €	'000 €	'000 €
Pasuritë financiare në para të gatshme				
Banka Qendrore e Kosovës	32	12,888	73,697	89,326
Letrat me vlerë për Qeverinë	32.1	80,955	45,996	-
Depozitat e afatizuara	32.2	113,008	152,007	105,042
Fondet në banka komerciale	33	-	-	41
Paratë e gatshme në tranzit	34	3,039	5,115	7,074
Llogaritë e ambasadave të Republikës së Kosovës	35	406	448	961
Paratë e gatshme në dorë (arka)	36	1,482	907	1,184
Gjithsej pasuritë në para të gatshme		211,778	278,171	203,629
Bilancet e fondeve				
Qëllimet specifike				
Të përcaktuara nga donatorët	37	9,619	8,301	6,423
Të hyrat vetanake të bartura	38	25,111	33,832	29,284
Të hyrat e dedikuara të AKP-së	39	4,919	10,676	-
Të tjera	40	12,842	9,215	7,924
		52,490	62,024	43,631
Të pashpërndara		159,288	216,147	159,998
Gjithsej Bilanci i Fondeve	30	211,778	278,171	203,629

Forma e intervistes dhe pyetesorit.

Intervista

Qëllimi i kësaj interviste është matja e qëndrimeve të opinionit publik rreth temës së ***Menaxhimit të Politikave Fiskale dhe Ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të Kosovës***, dhe të gjitha të dhënat e fituara do të shërbejnë për hulumtimin gjatë punimit të doktoratës. Të dhënat e secilit prej jush do të jenë të ruajtura dhe do të respektojmë kodin e besueshmërisë. Ju falenderoj paraprakisht për bashkëpunim dhe sinqeritet.

Intervistuesi _____ **Profesioni** _____ **Mosha** _____
Data e intervistës _____

1. Nëse do të krahasojmë periudhën para dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në cilën periudhë(nga viti 2008-2012) besoni se ka pasur menaxhim më të mirë të politikave fiskale në Kosovë ?

Shëno vitin _____

2. A mendoni se Kosova ka një menaxhim adekuat të duhur të politikave fiskale, nëse po pse nëse jo pse ?
3. Sa kanë luajtur dhe po luajnë rol pozitiv apo negativ misionet e BE-së në Kosovë në ofrimin e ndihmës së menaxhimit të politikave fiskale?
4. Ku e shihni të domosdoshme ndryshimin e politikave fiskale në tatime (ulje, ngritje apo shkallëzime të mëtejshme të shkallëve aktuale tatimore të TVSH-s Tatimit në Fitim, dhe të tjera, apo edhe duke lejuar periudha të pushimit tatimor në rastet e investimeve të mëdha) apo në doganë (ulje apo ngritje të bazës doganore, shkallëzim) në Kosovë tani dhe në të ardhmen?
5. A mendoni se duhet të shtrihet baza tatimore, dhe sa mendoni se është momentalisht shtrirja e bazës tatimore në nivel të Kosovës (të përfshihen të gjithë në pagesën e tatimeve)?

6.Sa besoni se brenda këtyre viteve 2008-2012 është luftuar ekonomia informale në Kosovë ?

7.A mendoni se politikat fiskale të Kosovës po reformohen sipas standardeve Evropiane?

8.Sa besoni se një menaxhim i mirë i resurseve njerëzore, politikave fiskale ndikon në zhvillimin ekonomik?

9. A mendoni se një menaxhim i mirë i politikave fiskale e ndihmon luftimin i ekonomisë informale, evazionit, ndikon në stabilitet ekonomik të Kosovës dhe njëkohësisht ndikon në liberalizim të vizave me BE?

10.Si i shihni investimet e huaja në Kosovë, si një mundësi , rrezik, apo konkurrencë pozitive për ekonominë vendore?

11.A mendoni se duhet ndryshuar menaxhimi i politikave fiskale dhe orientimi i tyre në zhvillimin e ekonomisë së mesme dhe rritje të punësimit në vitet e ardhshme?

12.Sa besoni se po shpenzohen drejt të hyrat publike ?

13. Sa besoni se Kosova është e gatshme për Globalizimin (tregun e lirë) ?

Pyetësori

Qëllimi i këtij pyetësori hulumtues është matja e qëndrimeve të opinionit publik rreth **Menaxhimit të Politikave Fiskale dhe Ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të Kosovës**, dhe të gjitha të dhënat e fituara do të shërbejnë për hulumtim gjatë punimit tim të doktoratës.

Të dhënat e secilit prej jush do të jenë të ruajtura dhe do të respektojmë kodin e besueshmërisë. Ju falenderoj paraprakisht për bashkëpunimin tuaj.

Mosha _____

Profesioni _____

Vendbanimi (përcakto vetëm njërin opcion: rural apo urban) _____

Nacionaliteti: a. vendor, b. ndërkombëtar.

Arsimi: -a. Universitar b. Pasuniversitar.

1. Çka mendoni a menaxhohen mirë në Kosovë të hyrat publike (periudha 2008-2012):

1. Shumë mirë ;
2. Mesatarisht;
3. Pak ;
4. Aspak;

2. Sa mendoni se kanë ndihmuar në menaxhimin e të hyrave publike misionet ndërkombetare si BE, (Roli i OSBE-së; Roli i Misionit EULEX;) në ndërtimin e Kosovës pas Pavarësisë?

- 1) Shumë; 2) Pak; 3) Mesatarisht; 4) Aspak

3. A mendoni se në Kosovë duhet të ndryshojnë politikat fiskale, duke ju përshtatur komplet vendeve të BE-së ?

- 1.Po-tërësisht
- 2.Jo-tërësisht
- 3.Pjesërisht me përshatatje vendore

4. Sa e vlerësoni zhvillimin ekonomik të Kosovës pas Pavarësisë?

- 1) Shumë; 2) Pak; 3) Aspak;

5. Në cilat fusha mendoni se duhet të korrigjohen Politikat Fiskale në Kosovë:

1. Në fushën e tatimeve;
2. Dogana;
3. Investime;
4. Privatizim.
5. Tjetër(shkruaj)_____

6. Njerëz të ndryshëm kanë mendime të ndryshme për ritmet me të cilat po ecën procesi i zhvillimit ekonomik të Kosovës. Sipas mendimit tuaj si po ecën ky proces?

1. Po ecën shpejt,
2. Ngadalë,
3. Shumë ngadalë,
4. S'po ecën fare.

7.Sa kohë mendoni se i duhet Kosovës për t'i arritur standartet ekonomike të vendeve si Sllovenia dhe Kroacia kundrejt BE-së (me të cilat në një kohë jo shumë të largët kanë qenë në një shtet të përbashkët ish-Jugosllavia)?

1. Do t'i duhen 5 vjet;
2. 7 vjet;
3. 10 vjet;
4. Më shumë se 10 vjet;
5. Nuk e di.

8.Për të ecur rrugës së vendeve të cilat e kanë kaluar tranzicionin, cilat veprime duhet ndërmarrë me shpejtësi?

1. Forcim të shtetit ligjor ;
2. Menaxhim më i mirë dhe me përgjegjësi i politikave publike;
3. Zhvillimi i ekonomisë së vogël dhe të mesme ;

9.Vendet perëndimore (BE-ja) tani e sa kohë më parë kanë eliminuar kontrollet e mallrave nëpër pika doganore, pra kanë një treg të lirë global, duke e rritur konkurrencën në treg dhe

njëkohësisht cilësinë e produkteve, a mendoni se ekonomia e Kosovës mund ta përballojë këtë sfidë nëse brenda 2 viteve e bëjmë edhe në eliminimin e kontrollave doganore si vendet e BE-së?

1. Po;
2. Jo;
3. Është e domosdoshme;
4. Nuk e di.
5. Pse? tregoni,_____

10.Cilat nga veprimet e mëposhtme mendoni se do të ndikonte në rritjen e punësimit në Kosovë, duke u nisur nga gjendja ekonomike e cila është tani për tani?

1. Rritja e efikasitetit për mbledhjen e të hyrave;
2. Luftimi i ekonomisë informate, korrupsionit, krimit etj;
3. Krijimi i lehtësirave tatimore për investitorë të huaj;
4. Rritja e kontrollit nëpër pika doganore;
5. Tjetër, specifikoni_____

11.A jeni pro apo kundër globalizimit të ekonomisë në Kosovë ?

6. Po;
7. Jo;
8. Është e domosdoshme;
9. Nuk e di.

12.A mendoni se Kosova do të bëhet pjesë e liberalizimit të vizave deri në fund të vitit 2014, dhe sa mendoni se do të ketë efekt pozitiv në zhvillimin ekonomik të Kosovës liberalizimi i vizave ?

1. Po;
2. Jo;
3. Pas përmbushjes së standardeve;
4. Nuk e di _____

13. A mendoni se Kosova ka burime njerëzore me përgatitje shkollore adekuate dhe sa mendoni se po shfrytëzohen këto burime?

- 1.Shumë;
- 2.Pak:

3. Aspak;
4. Tjetër, specifiko _____

14. Duke u nisur nga qëllimi për tërheqje të investimeve të huaja në Kosovë e të cilat ndikojnë në zhvillim ekonomik dhe punësim, cilat mendoni se janë përparësitë që duhet t'i potencojmë para faktorit ndërkombëtar?

1. Mosha e popullsisë e cila është e re, ku mesatarja është 28 vjeç;
2. Mosha dhe përgatitja profesionale;
3. Kompensimi për punën i lirë (paga);
4. Tjetër, specifiko _____

15. Sa besoni që nëse një ndërmarrje ndërkombëtare vjen për të investuar në Kosovë, (p.sh: Kompania "LG" e cila mirret me prodhim të televizioneve, radiove, aparateve të ndryshme etj) do të gjejë menaxher vendor të gatshëm për udhëheqje profesionale si dhe punëtorë me përgatitje adekuate?

1. Aspak;
2. Pak;
3. Mesatarisht;
4. Shumë.

16. Duke u nisur nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë përmes AKM tani AKP, a mendoni se ka pasur politika fiskale të ndërtuara dhe të menaxhuara mirë, a kanë ndikuar në zhvillim ekonomik dhe punësim të qytetarëve vendorë, ju personalisht si e vlerësoni ?

1. Pozitiv;
2. Negativ
3. Relativisht të suksesshem;
4. Tjetër specifiko _____

17. Sipas raportit të BQK-së (Banka Qendrore e Kosovës), marrë nga gazeta Koha Ditore e datës 19 Korrik 2013, ku thuhet se në vitin 2012 kemi rënie të investimeve të brendshme dhe të jashtme në total rreth 60%. Pse mendoni se e kemi këtë rënie?

1. Politika Fiskale jo të favorshme për biznesin;
2. Menaxhim jo i mirë dhe jo transparent;
3. Pasiguria ligjore për investime;
4. Reflektim i krizës në Evropë;
5. Të tjera specifiko _____

Referencat – Bibliografia

1. Robbins&DeCenzo. "Bazat e Menaxhimit Koncepte dhe aplikime themelore" ,Tiranë 2011, përkthyer nga Rezarta Perri
2. Ilia Kristo; "Biznesi Ndërkombëtar",Tiranë, 2004.
3. Bardhyl Çeku, Arjan Abazi, Semiha Loca; "Bazat e marketingut" , Tiranë ,2010.
4. Liliana Elmazi(Billa) dhe Vjollca Hysi; "Bazat e Marketingut" ,Tiranë ,2008.
5. Adrian Civici. "Globalizimi ante portas" , Tiranë,2009
6. Bedri Selmani. "Globalizimi tranzicioni dhe integrimet".Lubjanë-Prishtinë ,2006.
7. Adrian Civici. "Kriza Financiare apo globale" ,Tiranë, 2009.
8. Musa Limani . "Integrimet Ekonomike Evropiane" ,Prishtinë 2008.
9. Bexhet Brajshori. "Menaxhimi i shpenzimeve publike dhe i proceseve buxhetore".Prishtinë 2010.
10. Bo Sodersten . "International Economics" , London
11. Dennis R.Appleyard Alfred J.Field . "Internacional economics" , New York
12. Bardhyl Çeku. "Kërkim Marketingu" Tiranë; SHBLU,2004
13. Zana Koli dhe Shyqyri Llaci. "Menaxhimi i burimeve njerëzore të autorëve" Tiranë,2005
14. Andri Koxhaj&Florian Tomini. "Menaxhimi i Komunikimit", Tiranë,2011
15. Suzana Panariti "Manaxhimi i operacioneve koncepte, metoda, strategji" , Tiranë,2008
16. Suzana Panariti "Menaxhim Projekti",Tiranë, 2002
17. Vasilika Kume "Menaxhimi Strategjik teori, koncepte, zbatime" , Tiranë , 2000
18. Hal R. varian W.W.Norton &Company-New "Microekonomik Analysis"(3-d Edition).
19. Harry G. Johnson London; George allen & Unwin Ltd. "Money, trade and economic growth";survey lectures in economic theory,
20. Murray C. Kemp Englewood Cliffs; New Jersey; Prentice."Pure theory of international trade" ; a systematic and selective account
21. Shyqyri Llaci, Jorida Tabaku. "Qeverisja e korporatave" , . Tiranë, 2010
22. George Allen&Unwin. Ltd,"Readings in international economics committee of the American Economic" London
23. Safet Merovci. "Tregu Finaciar" , Prishtinë 2004
24. Mimoza Kasimati . "Sjellje Organizative" ,.Tiranë, 2010

25. Batteman & Snell. "Menaxhimi". Mc Grow Hill. 2007.
26. Adrian Civici. "Dilemat e zhvillimit; modelet e zhvillimit ekonomik dhe socialë perballë globalizimit", Tiranë, 2007.
27. Adrian Civici. "Shteti apo tregu-cilin model të zhvillimit të zgjedhim", Tiranë 2013.
28. Sabahudin Komoni. "Finacat publike", Prishtinë, 2008
29. Selman Selmanaj. "Globalizimi dhe tranzicioni", Prishtinë 2006.
30. Harvy Rosen. "Finacat Publike", Mc Graw Hill Irvin, Tiranë 2003.
31. Niko Ketri. "Ekonomia Politike", Tiranë, 2008.
32. Pierre Calame. "Ekonomia në shekullin XXI pikëpamje, analiza, reflektim", përkthyer nga frëngjishtja Blerta Hyska.
33. Gazmend Luboteni. "Menaxhmenti bankar", Prishtinë 2008.
34. Adrian Civici. "Iluzionet monetare mashtrimet e mëdha", Tiranë 2011.
35. B. Musabelliu, D. Kërçini, A. Bejko. "Menaxhimi Strategjik", Tiranë 2012
36. Vasilika Kume. "Marrja e vendimeve menaxheriale", Tiranë 2009.
37. Isa Mustafa. "Menaxhmenti Financiar", Prishtinë 2008.
38. Paul Banfield –Rebecca Kay. "Hyrje në menaxhimin e burimeve njerëzore", Tiranë 2011 përkthyer nga Jonida Bregu.
39. N. Gregory dhe Mark P. Taylor. "Ekonomiksi makroekonomia", Tiranë 2012, përkthyer nga Artan Meçi & Jorgji Qirjako.
40. Muhamet Mustafa. "Menaxhim i Investimeve", Prishtinë 2009.
41. International trade a new approach to the teaching of, I.F. Pearce London
42. "A general introduction to the design of questionnaires for survey research" AUTHOR: Dr Thomas F Burgess May 2001 EDITION: 1.1
43. "A Step-by-Step Guide to Developing Effective Questionnaires and Survey Procedures for Program Evaluation & Research" Rutgers Cooperative Research & Extension, NJAES, Rutgers, The State University of New Jersey.
44. "Structured Methods: Interviews, Questionnaires And Observation" Constantinos N. Phellas, Alice Bloch and Clive Seal
45. "Questionnaire design" Maria Teresa Siniscalco and Nadia Auriat
46. "Surveys and Questionnaires" Authors Nigel Mathers Nick Fox Amanda Hunn
47. "Fundamentals of Survey Research Methodology" Priscilla A. Glasow

48. *“Survey Research Methodology In Management Information Systems: An Assessment”* Alain Pinsonneault and Kenneth L. Kraemer
49. Malush Krasniqi, *“Corporate Albania the past, the present and the future”* Konferencë ndërkombëtare shkencore 9-10 Nëntor, Tiranë 2012.
50. Malush Krasniqi. *“ICHSS2013”(international Conference on Human and Social sciences)* Konferencë ndërkombëtare shkencore 20-22 Shtator, Romë Itali, 2013.
51. Malush Krasniqi. *“The state, society and Law :Human Rights Challenges in Albania”* Konferencë ndërkombëtare shkencore “16-16 Mars, Tiranë 2013.
52. Malush Krasniqi . *“IT Applications in economics, Business and Society”* Konferencë shkencore ndërkombëtare 28 Qershor Tiranë, 2013.
53. Malush Krasniqi. *“Identity, Image & social cohesion in the Era of Integration and Globalization”* Konferencë shkencore ndërkombëtare 26-28 Nëntor, Vlorë, 2012.
54. Malush Krasniqi. *“Globalization, development, Public Policy & Management A business development Perspective”* Konferencë shkencore ndërkombëtare 29 Shtator Prishtinë 2012.
55. Malush Krasniqi. *“Activate the Sources of economic Growth in Kosovo”* Konferencë shkencore ndërkombëtare 18 Maj Prishtinë 2012.
56. Malush Krasniqi. *“Investimet në funksion të zhvillimit ekonomik dhe proceset integruese”* Konferencë shkencore ndërkombëtare 05. Prill, Ulqin Mali i zi 2013.
57. Arkivi BQK-së (Banka Qendrore e Kosovës) Prishtinë Pasqyrat Finaciare 2008-2013.
58. Arkivi ATK-së (Administrata Tatimore e Kosovës) Të hyrat 2008-2013.
59. Arkivi i Doganave të Kosovës të hyrat 2008-2013.
60. Legjislacioni Tatimor i Kosovës –botues ATK-Prishtinë 2010.
61. Ligji Nr 2004/48 Mbi administratën tatimore dhe procedurat miratuar nga Kuvendi i Kosovës në fuqi nga 27/09/2004.
62. Udhëzimi Administrativ Nr 05/2005 Datë: 29.04.2005 për implementimin e ligjit 2004/48.
63. Ligji Nr 03/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 2004/48 në fuqi nga 04/12/2008.
64. Udhëzimi Administrativ Nr 16/2009 për zbatimin e ligjit 2004/48 dhe 03/L-071 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.
65. Ligji 03/L-113 për tatimin në të ardhura të korporatave në fuqi nga 01.01.2009 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr 03/L-162.
66. Ligji Nr 03/L-146 Tatimi i Vlerës së Shtuar ky ligj është në fuqi nga data 01.07.2010 duke e plotësuar ligjin 03/L-114.

67.Udhëzimi administrativ Nr 01/2004 i datës 01.Shtator 2004.

68.Rregullorja e Tatimi të Vlerës së Shtuar 2001/11. rreg.2001/17

69.Rreg.2002/17. rreg.2004/35 etj.etj

Publikimet nga Buletini i ATK-së

[http://www.cochrane.es/files/Recursos/How to design a questionnaire.pdf](http://www.cochrane.es/files/Recursos/How_to_design_a_questionnaire.pdf)

[http://www.cochrane.es/files/Recursos/How to design a questionnaire.pdf](http://www.cochrane.es/files/Recursos/How_to_design_a_questionnaire.pdf)

[www.politika](http://www.politika.fiskale.com) fiskale.com

[www.politika](http://www.politika.fiskale.com) fiskale në tranzicion.com

[www.buxheti](http://www.buxheti.queveritar.com) qeveritar dhe politikat fiskale pjesa I dhe II.com

[www.politika](http://www.politika.fiskale.com) fiskale dhe reduktimi i varfërisë.

www.kosova.com

Si dhe, web faqet e ndryshme të internetit të cilat kanë material për këtë problematikë etj.